



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies

Studim për Proceset Zgjedhore dhe Udhëzues për Monitorimin nga Shoqëria Civile

“Pjesëmarrja e OSbC-ve në proceset zgjedhore për një demokraci më të fortë dhe përsheptimin e integritetit në BE”, i cili zbatohet nga konsorciumi i dy partnerëve:

Qendra Burimore Kombëtare Shqiptare të Trajnimit dhe Asistencës Teknike dhe Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të “NDCI NEAR/2023/451-516”.

Studim për proceset zgjedhore dhe udhëzues për monitorimin nga shoqëria civile

Copyright © Autorët

Autorë

Prof.Dr. Andon Kume

Av. Franc Terihati

Av: Besa Ombashi

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështesëve financiar të tij, Bashkimi Europian, ANTTRAC dhe IPLS

Tiranë, 2024

PERMBAJTJA

<u>PËRMBLEDHJE</u>	7
<u>HYRJE</u>	9
<u>QËLLIMI I STUDIMIT</u>	10
<u>OBJEKTIVAT</u>	11
<u>OBJEKTI</u>	11
<u>METODOLOGJIA</u>	12
<u>KREU I PARË</u>	13
<u>KREU I DYTË</u>	17
<u>KREU I TRETË</u>	28
<u>KREU I KATËRT</u>	32
<u>KREU I PESTË</u>	36
<u>KREU I GJASHTË</u>	52
<u>KREU I SHTATË</u>	77
<u>PËRFUNDIME</u>	90

KREU I PARË

Njohuri bazë standardet dhe parimet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike pasqyrimi i tyre në kuadrin kushtetues shqiptar

- 1.1 Dokumentat ndërkombëtar kryesorë që trajtojnë të drejtën politike të njeriut për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur 13
- 1.2 Kuadri legjislativ kushtetues shqiptar për të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur 15

KREU I DYTË

Kodi i praktikave të mira në çështjet zgjedhore (Komisioni i Venecies) dhe përafrimi i legjislacionin shqiptar me të.

- 2.1 Parime bazë të trashëgimisë zgjedhore Europiane – pasqyrim i tyre në Kodin zgjedhor 18
- I. Votimi universal (Univesal suffrage)
- II. Votim i barabartë
- III. Votim i lirë
- IV. Votim i fshehtë
- V. Votim i drejperdrejtë
- VI. Periodiciteti i zgjedhjeve
- 2.2 Trashëgimia zgjedhore europiane – Domosdoshmëria për zbatim në praktikën zgjedhore 25

KREU I TRETË

Njohuri të vëzhguesit vendor për

vlerësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së legjislacion zgjedhor

- 3.1 Sistemi zgjedhor 29
- 3.2 Harta e njësive zgjedhore 29
- 3.3 Administrata zgjedhore 30
- 3.4 Lista e zgjedhesve 31
- 3.5 Rregjistrimi i partive dhe kandidatëve 31
- 3.6 Fushata zgjedhore 31
- 3.7 Financimi i fushatës zgjedhore 32
- 3.8 Votimi & numrimi i votave 32
- 3.9 Shqyrtimi i ankimeve 32

KREU I KATËRT

Njohuri

mbi aspekte legjislative të financimit të fushatës elektorale dhe monitorimit të shpenzime për fushatën zgjedhore

- 4.1 Një ligj për financimin e partive politike 33
- 4.2 Monitorimi dhe vlerësimi i transparencës së financimit të partive politike 34

KREU I PESTË

Zgjidhet legjislativë për trajtimin e mosmarrveshjeve dhe ankime për çështje zgjedhore

5.1 Transparenca në procedurat zgjedhore administrative dhe gjyqësore	36
5.2 E drejta e ankimit administrativ ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore	37
5.3 E drejta e ankimit në juridiksionin gjyqësor	45
5.4 Legjitimiteti i subjekteve në GJK	49
5.5 Shqyrtimi i denoncimeve dhe vendimet që merren në përfundim të tyre	51

KREU I GJASHTË

Përmbledhje për gjetjet dhe rekomandimet kryesore të misioneve të vëzhguesve ndërkombëtar dhe opinioneve të Komisionit të Venecias

6.1 Rekomandime dhe reagim i partive politike dhe ligjvënësve ndër vite	53
6.2 Rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR- Zgjedhjet parlamentare, 2021, Zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, 2023 – reagime ndaj tyre.	55
6.3 Përmbledhje e Rekomandimeve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet 2021 dhe 2023 dhe statusi i implementimit të tyre.	62

KREU I SHTATË

Monitorimi dhe vëzhgimi i proceseve zgjedhore nga vëzhguesit vendor

7.1 Vështrim i shkurtër historik i procesit të zhvillimit të kapaciteteve të shoqërisë civile për monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve	
7.2 Qasje metodike e shoqërisë civile për monitorimin/vëzhgimin e zgjedhjeve dhe reformave në legjislacionin zgjedhor	
7.2.1 Monitorimi/vëzhgimi i zgjedhjeve	
7.2.2 Vlerësimi i integritetit të zgjedhjeve	
7.3 Indikatorët për vlerësimin e integritetit të zgjedhjeve	

SHKURTIME

EU	Bashkimi European
GNV	Grupi i Numerimit te Votave
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
KAS	Komisionit te Ankimeve dhe Sanksioneve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KiE	Keshilli i Europës
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
KPC	Kodi i Procedurave Civile
KZ	Kodi Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal per Administrimin e Zgjedhjeve
KQV	Komisioni Qendres se Votimit
OJF	Organizate Jofitim Prurese
OSBE	Organizata Europiane per Siguri dhe Bashkpunim
ODIHR	Zyra per te Drejtat e Njeriut
PS	Partia Socialiste
PD	Partia Demokratike
RGJC	Regjistrat Kombetar te Gjendjes Civile
RSH	Republika e Shqipërisë

PËRMBLEDHJE

Ndryshimet politike, ekonomike e sociale në Shqipëri, të ndodhura në fillim të viteve '90 dhe të zhvilluara si një proces i gjatë dhe kompleks tranzicioni gati 30 vjeçar, kanë patur dhe kanë në qendër, si gjenerator kryesor të tyre, proceset zgjedhore demokratike. Dinamikat e zhvillimit të këtyre proceseve, problemet, sfidat me të cilat janë ballafaquar, rezultate dhe dështimet që i kanë shoqëruar janë ndër treguesit e rëndësishëm që mund të shërbejnë dhe të përdoren për të analizuar dhe për të gjykuar proceset për zhvillimin e demokracisë në Shqipëri. Analiza e tyre krijon mundësi për të kuptuar dhe për të vlerësuar edhe rolin e shoqërisë civile dhe të qytetarëve në ecurinë e mbarë të këtyre proceseve.

Në një shoqëri demokratike në të cilën proceset zgjedhore dhe vota e lirë, e drejtpërdrejt dhe e fshehtë, janë guri i themelit për ndërtimin dhe zhvillimin e të gjithë institucionet drejtuese dhe qeverisëse të saj, hartimi i një legjislacioni zgjedhor në të cilin duhet të pasqyrohet parimet dhe standardet e përcaktuara në konventat dhe dokumentet ndërkombëtar që trajtojnë çështje të drejtave themelore të njeriut është detyrë themelore.

Shqipëria si vend anëtar i OSBE ka firmosur Kartën e Stambollit, në të cilën shprehet dakordësia që proceset zgjedhore që zhvillohen në Shqipëri të vëzhgohen dhe të vlerësohen prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR. Si vend anëtar i KiE dhe OSBE ka pranuar Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, angazhimet e OSBE për standardet që duhet të plotësojnë proceset zgjedhore dhe pesë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore Evropiane.

Hartimi i Legjislacionit shqiptar për zgjedhje, në veçanti pas miratimit të Kushtetutës me referendum të përgjithshëm në Nëntor, 1998 ka qënë një proces kompleks dhe i ndikuar, në mënyrë të dukshme nga faktorët politik, partitë politike parlamentare, në veçanti dy partitë kryesore, PS e PD. Reformat zgjedhore janë zhvilluar përherë si procese bipartizane, PS e PD, në të cilët, roli dhe efektet e partive të tjera politike dhe i shoqërisë civile kanë qënë pothuajse të papërfillshëm. Karakteri gjithëpërfshirës i këtyre reformave, i kërkuar në mënyrë të përsëritur edhe prej OSBE/ODIHR, eksperteve, organizmave dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare akoma nuk ka arritur të jetë formësuar.

Legjislacioni zgjedhor shqiptar dhe gjithë kuadri tjetër ligjor, në të cilin trajtohen çështje që lidhen me zgjedhjet, në linjat kryesore janë të përafuar me standardet dhe kërkesat e konventave dhe me dokumentat ndërkombëtar. Analiza krahasuese e Kodit zgjedhor me Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore dhe referencat tek vlerësimet dhe konsideratat e shprehura në Raportet e vëzhguesve ndërkombëtar dhe në opinionet e Komisionit të Venecias, evidentojnë faktin se Kodi zgjedhor shqiptar është një produkt legjislativ i cili garanton kushtet e nevojshme për zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike.

Analiza e vlerësimeve dhe rekomandimeve të shprehura në raportet për zgjedhjet, të hartuara prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR tregojnë se efekti i sjelljeve politike në procesin ligjbërës është një ndër faktorët me efekt negativ të ndjeshëm në zhvillimin e kapaciteteve legjislative, të nevojshme për procese zgjedhore demokratike. Kjo analizë eidenton raste të shpeshta të ndërhyrjeve dhe ndryshimeve të bëra në legjislacion, deri në Kushtetutën e Republikës, të nxituar vetëm prej interesit politik dhe dukshëm të shmangura nga interesi qytetar.

Proceset që targetojnë përpjekjet e shoqërisë shqiptare për t'u zhvilluar si një shoqëri demokratike kanë si bashkëshoqërues të tyre përpjekjet e shoqërisë civile për t'u angazhuar dhe për të marrë pjesë në proceset zgjedhore, në hartimin dhe rregullimet që duhet të bëhen në legjislacion, në veçanti në Kodin zgjedhor dhe në ligjin për partitë politike, si dhe në vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve. Zhvillimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për pjesëmarrje në proceset ligjbërëse për zgjedhjet dhe për vëzhgimin e monitorimin e zgjedhjeve, ka si produkt kryesor të tij ndihmesën e ndjeshme në zhvillimin e kapaciteteve organizative të shoqërisë civile dhe në përgatitjen profesionale të vëzhguesve e monitoruesve që angazhojnë OSHC-të.

Në përpjekjet e vazhdueshme që bëhen në vendin tonë për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale dhe organizative të shoqërisë civile për të monitoruar, vëzhguar dhe vlerësuar proceset zgjedhore, hartimi i materialeve që i shërbejnë standardizimit të metodologjisë sipas së cilës duhet të zhvillohen këto përpjekje është një moment shumë i rëndësishëm. Analiza e përvojave të realizuara deri sot në këtë angazhim të shoqërisë civile tregon se, aktualisht procesi që synon rritjen dhe forcimin e rolit dhe të efekteve që duhet të realizojë shoqëria civile në proceset zgjedhore, ballafaqohet me sfida që lidhen me nevojën për të kaluar në një nivel të ri, cilësisht më të lartë, të qasjes dhe sjelljes së kesaj shoqërie ndaj detyrës dhe përgjegjësisë që ajo ka si pjesëtare në përpjekjet e shoqërisë shqiptare për zhvillimin e demokracisë përfaqësuese dhe me pjesëmarrje të qytetarëve.

Hartimi i një Studimi teoriko-metodik që mund të përdoret nga organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri

në përpjekjet e tyre për të rritur kapacitetet për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve është një ndihmesë e vlefshme për suksesin në punën e tyre. Ky Udhëzues mund të shërbejë për të orientuar punën dhe përpjekjet e këtyre organizatave për hartimin dhe implementimin e një Platforme të përbashkët për bashkëpunim. Studimi mund të jetë një pikë referimi që duhet të mbahet parasysh në përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes qytetare në procesin për vlerësimin e integritetit të zgjedhjeve. Nëpërmjet tij synohet që organizatave të shoqërisë civile t'ju jepet një material në të cilin janë bërë përpjekje për të trajtuar në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme dhe shtrënguese çështjet që duhet të mbahen parasysh për realizimin me sukses të monitorimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të zgjedhjeve. Formulimi i indikatorëve, të detajuar për fazat e ndryshme të një procesi zgjedhor është një nga trajtimet kryesore që përmbahen në këtë Udhëzues. Përshkrimi i detajuar i këtyre indikatorëve dhe sqarimi i përmbajtjes së çdo treguesi përbërës të tyre, duke ju referuar standardeve dhe udhëzuesve të OSBE/ODIHR për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit vendor, krijon mundësitë reale për një angazhim të sukseshëm të shoqërisë civile në proceset zgjedhore.

Monitorimi, vëzhgimi dhe vlerësimi i proceseve zgjedhore që do të zhvillohet në Shqipëri, duke përdorur Metodologjinë e cila nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve të përshkruar në këtë Udhëzues, arrin të vlerësojë Indeksin e Integritetit të Zgjedhjeve, si një matës sasior, në bazën e të cilit qëndrojnë vlerësimet cilësore për fazat dhe procedurat sipas të cilave zhvillohen zgjedhjet dhe analizat cilësore për nivelin e zbatimit të legjislacionit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij prej administratës zgjedhore, partive politike, institucioneve të qeverisjes qëndore e vendore, institucioneve ligjzbatuese dhe qytetarëve është një ndër objektivat kryesore që synohet të realizohet nëpërmjet hartimit të këtij Studimi.

Studimi do të jetë dokumenti bazë mbi të cilin do të mbështetet, ndërtohet dhe zbatohet i gjithë procesi që synon angazhimin efektiv të shoqërisë civile shqiptare për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, që do të zhvillohen në vitin 2025. Realizimi i sukseshëm i kësaj të drejte dhe detyrimi që ka shoqëria civile në kuadër të përpjekjeve që bëhen për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe që plotësojnë standardet ndërkombëtare, parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane dhe angazhimet e OSBE-së është objektiva themelore që synohet të arrihet nëpërmjet hartimit të dokumentave udhëzues, metodologjisë dhe platëformës gjithëpërfshirëse, të cilat, të gjitha sëbashku do të shërbejnë për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe organizative të shoqërisë civile shqiptare për pjesëmarrje dhe për monitorim e zgjedhjeve në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Zgjedhje, Legjislacion, Reformë elektorale, Parime, Standarde ndërkombëtare, Shoqëri civile, Vëzhgim i zgjedhjeve.

HYRJE

Proceset për ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike, objektiv i të cilave ishte dhe vazhdon të mbetet ndërtimi i një shoqërie demokratike që mbështetet në pronën private, tregun dhe iniciativën e lire, ndërtimin e shtetit ligjor dhe shtetit të të drejtës, janë rezultat i veprimit dhe bashkëveprimit të faktorëve të ndryshëm social, ekonomik, historik, të kulturës, traditës e sjelljes të shoqërisë dhe qytetarit shqiptar. Në dallim nga vende të tjera që në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar u përfshinë në procese të tilla transformuese, në Shqipëri këto procese janë shoqëruar dhe janë ndikuar në mënyrë thelbësore nga:

- mungesa pothuajse e plotë e kulturës shoqërore dhe politike, mbi bazën e të cilës zhvillohet pluralizmi politik,

- përvojat shumë të vogla dhe gati të papërfillshme në ushtrimin e demokracisë, ndërtimin e shtetit ligjor dhe të të drejtës si dhe funksionimi i tij dhe të shoqërisë sipas dhe në përputhje me kërkesat e sistemit demokratik të qeverisjes,

- trashëgimia dhe terreni jo miqësor dhe, jo në pak raste refraktar, ndaj përpjekjeve për zhvillimin e pluralizmit, sistemit partiak dhe shoqërisë vetëvepruese, sipas parimeve dhe duke respektuar e zbatuar standardet demokratike.

Shoqëria shqiptare sapo hyri në procesin e ndryshimeve në sistemin politik e ekonomik në vitin 1990-1991, kuptoi dhe pranoi se ky proces mund të realizohej vetëm nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve demokratike. Ndaj dhe një ndër angazhimet e para të saj në këtë periudhë ishte hartimi dhe miratimi i ligji për zgjedhjet, si përpjekja e parë legjislative për ndërtimin e një korpusi legjislativ të nevojshëm dhe nxitës për zhvillimin e synuar demokratik të shoqërisë dhe shtetit shqiptar¹.

Hartimi i legjislacionit zgjedhor, proces që pas miratimit të Kushtetutës së Republikës, 1998, është emërtuar «Reformë zgjedhore» është një ndër proceset ligjberëse ndër me kompleksitet dhe më të debatuarit. Ndër faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në kompleksitetin dhe sfidat me të cilat përballlet ky proces ligjberës, mund të renditen, si ndër kryesorët, niveli i kuptimit nga shoqëria i konceptit të “demokracisë” dhe i procesit të “konsolidimit” i saj. Sipas Huntington² një sistem politik është demokratik “derisa vendimmarrësit e tij zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve të drejta, të ndershme dhe periodike, në të cilat, kandidatët konkurrojnë të lirë dhe pothuajse e gjithë popullsia, në moshë madhore, ka të drejtën e votës” Me gjithë këtë edhe plotësimi i këtij kushti nuk mjafton. Është e nevojshme që veç zgjedhjeve të lira e të ndershme, për të realizuar procese zgjedhore që bëjnë të mundur zhvillimin në standarde të “demokracinë zgjedhore”, shoqëria duhet të ndërtojë dhe të zhvillojë të gjithë institucionet e tjera, të nevojshme për plotësimin e kushteve minimale të lirisë civile³.

Analiza e procesit të tranzicionit postkomunist në Shqipëri, tregon se në faza të ndryshme të tij, masa e plotësimit të kriterëve të mësipërm është e ndryshme. Me gjithë këtë, në tërësinë e tij, ky proces karakterizohet nga tipare të cilat, duke përdorur një shprehje të dhënë nga Schopflin, mund të përmbledhen në termin “protodemokraci”, me të cilin nënkuptohen sisteme që plotësojnë disa kriterë demokratike, po që janë vetëm pjesërisht demokraci të mirëfillta të zhvilluara. Si thekson Nelson (1993)⁴, ato janë sisteme në të cilët ka parlament, parti politike, bëhen zgjedhje periodike, bëhen përpjekje për qeverisje përfaqësuese nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të drejta, ka proces të rregullt në procedurat gjyqësore, transparencë në diskutimin publik nëpërmjet mediave të pavarura dhe zbatohen edhe parime të tjera të demokracisë. Po në të njëjtën kohë, ato janë sisteme, në të cilët as qëndrimet publike dhe as hartimi i politikave publike, nuk arrijnë të pasqyrojnë dhe as të realizojnë kërkesat për mundësi të barabarta, për tolerancë, pjesëmarrje e transparencë në qeverisje, si dhe llogaridhënie publike.

Tranzicioni postdiktatorial në Shqipëri është një ndër proceset më kompleks dhe me dritëhije të theksuara. Analiza të thelluara të këtij procesi, me target çështje dhe probleme që lidhen me reformat dhe proceset zgjedhore në Shqipëri, aktualisht janë të publikuara nga autorë të ndryshëm⁴.

Për të ndërtuar dhe zhvilluar një demokraci moderne dhe funksionale është e rëndësishme jo vetëm që të hartohen dhe zbatohen rregulla që mundësojnë një qeverisje të kufizuar të shumicës por, mbi të gjitha të bëjnë të mundur zhvillimin e procedurave zgjedhore që respektojnë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane, Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias dhe si të tilla të arrijnë të realizojnë,

¹ Kume, A. 'Legjislacioni zgjedhor dhe zbatimi i tij në vendet në tranzicion-rasti Shqipëria. Monografi, 2015.

² Samuel P. Huntington “The Third wave”, p.7

³ Rober D. “Polyarchy: Participation and Opposition” New Haven Yale University Press, 1071, p.3

⁴ Kume, A. (2015) 'Legjislacioni zgjedhor dhe zbatimi i tij në vendet në tranzicion-rasti Shqipëria. Monografi, 2015 Krasniqi, A. (2009) Zgjedhjet në Shqipëri (1991-2008) - Zgjedhjet parlamentare, lokale dhe referendumet.

në mënyrë më efektive, transferimin e pushtetit me anë të përfaqësimit (Santori, G. 1987)⁵. Për pasojë, duhet të pranohet se procesi i ndërtimit të një shoqërie me demokraci moderne në Shqipëri, do të vazhdojë të përballet me sfida shumëpërmasore përsa kohë që proceset zgjedhore nuk do të arrijnë të plotësojnë tërësisht kërkesat dhe standardet e parashikuara në dokumentet e ndryshëm ndërkombëtare si Karta e Kombeve të Bashkuara, Akti Final i Helsinkit, Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit dhe Karta e Parisit, si dhe nuk do të zhvillohen në përputhje me pesë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane.

Përpyekjet e shoqërisë shqiptare, për të zhvilluar procese zgjedhore në përputhje me standardet e shoqërive të zhvilluara demokratike, mund të arrijnë objektivat e dëshiruara vetëm në rast se ato realizohen si kontribute sinergjike të shumë aktorëve, partive politike, administrata zgjedhore, institucionet publike, qeverisja qendrore e lokale, institucionet ligj zbatuese dhe deri tek zgjedhësit. Bashkëveprimi i të gjithë këtyre aktorëve duhet të konceptohet dhe të realizohet si një proces i vazhdueshëm, jo përjashtues dhe efektivisht gjithëpërfshirës. Pranimi dhe reagimi ndaj vërejtjeve, këshillave, asistencës teknike dhe rekomandimeve që institucionet ndërkombëtare ofrojnë është e nevojshme të bëhet, në çdo kohë, pjesë e metodologjisë së punës që kryhet në kuadër të reformave zgjedhore dhe zgjedhjeve.

Parakusht për realizimin e zgjedhjeve demokratike është hartimi i një legjislacioni zgjedhor që rregullon procedurat, kërkesat, kushtet, të drejtat dhe detyrimet që kanë të gjithë aktoret dhe pjesëmarrësit në proceset zgjedhore. Bashkë me të dhe po kaq i rëndësishëm është edhe hartimi i një kuadri legjislativ efektiv që rregullon detyrimet dhe të drejtat e institucioneve publike, qendrore e lokale, veprimtaria e të cilëve ka prerje me proceset zgjedhore, pjesë e rëndësishme e të cilëve janë institucionet ligj zbatuese, institucionet qeverisëse qendrore e lokale dhe partitë politike. Reformat zgjedhore të realizuara pas miratimit të Kushtetutës, me referendum në Nëntor 1998, kanë synuar që të gjejnë zgjidhjet më të mira dhe sa më efektive, referuar kushteve, veçorive dhe karakteristikave të vendit dhe shoqërisë tonë. Rezultatet e arritura kanë si karakteristikë të përbashkët trendin pozitiv në qasjen e tyre ndaj gjetjes së zgjidhjeve legjislative të cilat kanë ofruar një legjislacion zgjedhor që ka krijuar kushte mbështetëse për zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me kërkesat për zgjedhje demokratike. Praktikën e zbatimit të këtyre zgjidhjeve legjislative në proceset zgjedhore, analiza e rezultateve dhe problemeve me të cilat janë ballafaquar zgjedhjet në Shqipëri kanë qënë, në çdo rast, udhërrëfyese për përpjekjet që janë bërë për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij legjislacioni.

QËLLIMI I STUDIMIT

Studimi synon që në mënyrë gjithëpërfshirëse të analizojë legjislacionin lidhur me proceset zgjedhore, të propozojë praktikën më të mira për përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të tij, si dhe të përbëjë një dokument udhërrëfyës për organizatat e shoqërisë civile që angazhohen në monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore në vendin tonë. Mbështetur në Metodologjinë dhe udhëzuesit praktik për vëzhguesit e zgjedhjeve të përgatitur nga OSBE/ODIHR, hartimi i këtij Studimi dhe pjesë integrale të tij janë trajtimi dhe analiza e problemeve dhe çështjet që janë objekt i reformës zgjedhore, me përqendrim në:

analizën e zgjidhjeve legjislative të realizuara, duke i ballafaquar me kërkesat dhe standardet e parashikuara në dokumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështje të drejtës politike për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

reagimi i ligjbërësit dhe shoqërisë shqiptare ndaj rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, Komisionit të Venecias, OSBE dhe misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR, për mirëregullimin e proceseve zgjedhore dhe zhvillimin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare, trashëgiminë zgjedhore evropiane dhe anagzhimet e OSBE-se për zgjedhjet demokratike

rolin dhe rëndësinë që ka pjesëmarrja e qytetarëve në zhvillimin e suksesshëm të proceseve reformuese legjislative dhe në monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve,

sfidat me të cilat përballet përpjekjet e shoqërisë tonë për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme për realizimin e zgjedhjeve demokratike.

identifikimin e rrugëve dhe instrumentave të duhet të përdorë shoqëria civile për të rritur efektivitetin e anagzhimit të saj në proceset zgjedhore.

Qëllimi i këtij Studimi teoriko-metodik është përgatitja e një dokumenti orientues, shpjegues dhe udhërrëfyës për organizatat e shoqërisë civile, që do t'ju shërbejë për organizimin dhe zhvillimin sa më efektiv të pjesëmarrjes së tyre në reformat zgjedhore, për angazhimin në ndërtimin e institucioneve demokratike, qendrore e lokale, të nevojshëm për funksionimin efektiv të demokracisë përfaqësuese në Shqipëri. Për arritjen e këtij qëllimi në Udhëzues trajtohen dhe analizohen çështje që lidhen me arritjet, sfidat dhe problemet që kanë shoqëruar

⁵ Santori, G. "The theory of democracy revisited" Chatham House Publishers, Inc. Chatham, New Jersey, 1987

reagimin e klasës politike dhe shoqërisë shqiptare në përpjekjet për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.

Në studim i është kushtuar vëmendje identifikimit të rrugëve dhe instrumentave që duhet të përdorë shoqëria civile për të rritur efektivitetin në angazhimet e ardhshme të saj për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore. Pjesë e rëndësishme e këtij trajtimi janë identifikimi dhe analiza e:

sfidat dhe problemet që kanë shoqëruar dhe që mund të vazhdojnë të jenë prezente në reformat zgjedhore dhe qasja ndaj tyre e organizatave të shoqërisë civile,

faktorët që kanë ndikuar në nivelin e arritur në plotësimin e rekomandimeve ndërkombëtare dhe vëzhguesve vendorë për rregullimet që duhet të bëhen në legjislacionin zgjedhor,

sjelljen e aktoreve përgjegjës dhe partive politike në procesin e reformës për legjislacionin zgjedhor,

identifikimi i nevojave, instrumenteve dhe rrugëve që duhet të ndiqen për rritjen e cilësisë në procesin legjislativ që targeton çështje që lidhen me proceset zgjedhore,

përvojave të shoqërisë civile për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore,

identifikimi i instrumentave, rrugëve dhe qasjeve metodike gjithëpërfshirëse që mund të përdorë shoqëria civile për ndërtimin dhe implementimin e Platformës së përbashkët, gjithëpërfshirëse për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve,

indikatorëve që mund dhe duhet të përdoren për vlerësimin metodikisht të unifikuar dhe të përputhur me parimet, standardet dhe Studimet e OSBE/ODIHR për vëzhguesit dhe vlerësuesit e zgjedhjeve

OBJEKTIVAT

Objektiva kryesore

Hartimi i një dokumenti referues për organizatat e shoqërisë civile synon të mbështesë dhe ndihmojë përpjekjet e tyre për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale dhe organizative, të kushtëzuara nga stadi aktual i zhvillimit të të drejtave dhe përgjegjësisë që kjo shoqëri ka për të monitoruar, vëzhguar dhe vlerësuar proceset zgjedhore.

Objektiva mbështetëse

Për të arritur këtë objektiv, Studimi është konceptuar si një dokument që synon realizimin e disa objektivave mbështetës për objektivin kryesor, ndër të cilët renditen:

Shpjegimi i thjeshtëzuar i njohurive teorike të nevojshme për formimin e kapaciteteve profesionale për vëzhguesit dhe organizatat e shoqërisë civile që angazhohen në proceset e monitorimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të zgjedhjeve, si vëzhgues vendorë të pavarur.

Paraqitja me qëllim njohjen me kërkesat, parimet dhe standardet e parashikuara në dokumentet ndërkombëtare, të BE-së dhe OSBE/ODIHR, që trajtojnë çështjet e zgjedhjeve.

Informimi mbi çështjet dhe sfidat që lidhen me nevojën e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit shqiptar me standardet dhe parimet ndërkombëtare, si dhe qasjen ndaj kësaj kërke nga partitë politike dhe shoqëria civile.

Reagimi ndaj rekomandimeve të misionëve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR.


Identifikimi dhe formulimi i rregullave metodike që do të shërbejnë për ndërtimin e një platforme të përbashkët dhe gjithëpërfshirëse për organizatat e shoqërisë civile që angazhohen në monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve.

OBJEKTI

Në Studimin “Reporting on Elections,” të hartuar nga KiE, theksohet se suksesi i procesit të monitorimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të zgjedhjeve nga vëzhguesit vendorë të pavarur kushtëzohet në mënyrë thelbësore nga niveli i përgatitjes profesionale dhe pavarësia e tyre politike. Theksohet se është e domosdoshme që vëzhguesit, të cilët organizatat e shoqërisë civile angazhojnë në këtë proces, të kenë njohuri të mjaftueshme mbi objektin dhe objektivat e vëzhgimit që do të kryejnë.

Monitorimi, vëzhgimi dhe vlerësimi profesional dhe i pavarur i zgjedhjeve mund të realizohet vetëm në rastet kur vëzhguesit kanë të qartë se çfarë duhet të kuptohet me një proces zgjedhor dhe kur zotërojnë njohuritë bazë të nevojshme për procedurat dhe rregullat sipas të cilave zhvillohen fazat e ndryshme të këtij procesi.

Pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve që zhvillohen, zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë apo zgjedhje për organet e vetëqeverisjes vendore, procesi zgjedhor realizohet si një tërësi fazash dhe procedurash, që në mënyrë skematike paraqiten në Figurën 1.



Vëzhguesi i pavarur vendor dhe organizatat e shoqërisë civile duhet që, në çdo rast, të organizohen dhe të realizojnë monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore duke pasur parasysh të gjithë ciklin zgjedhor. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u theksuar, sepse, në jo pak raste, disa organizata që angazhohen si vëzhgues të pavarur të zgjedhjeve e konsiderojnë detyrën të përmbushur kur vëzhgojnë procesin vetëm gjatë fazës që fillon me shpalljen e dekretit të Presidentit të Republikës për datën e zgjedhjeve dhe përfundon me shpalljen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për rezultatet e zgjedhjeve të zhvilluara.

Natyrisht, vëzhgimi i kësaj periudhe të ciklit zgjedhor është i rëndësishëm. Vëzhgimi gjatë kësaj periudhe prodhon informacionin më të vlefshëm për të gjykuar lidhur me nivelin e plotësimin të standardeve për zgjedhje demokratike, si dhe për të identifikuar çështjet dhe problemet që duhet të trajtohen nga trupa legislative, institucionet publike qendrore e lokale, institucionet ligjzbatuese dhe shoqëria civile.

Ndërkohë, është po aq e rëndësishme të theksohet se shoqëria civile dhe organizatat e saj, që kanë si fokus të punës të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat politike, duhet të jenë gjithmonë të angazhuara për të qenë pjesë e proceseve që lidhen me reformën zgjedhore dhe me nismat që synojnë rritjen e kapaciteteve të shoqërisë sonë për pjesëmarrje në politikë dhe ligjëbërje.

Referuar paraqitjes skematike të mësipërme, Studimi përmban dhe vë në dispozicion të gjithë të interesuarve, veçanërisht organizatave të shoqërisë civile, informacione, këshilla, rrugë, instrumente dhe metodologji që mund të përdoren prej tyre për të monitoruar, vëzhguar dhe vlerësuar, në mënyrë objektive dhe të suksesshme, të gjithë ciklin zgjedhor.

METODOLOGJIA

Hartimi i Studimit është mbështetur dhe ka ndjekur rregullat e përcaktuara nga OSBE/ODIHR në dokumentet që trajtojnë çështje të monitorimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të zgjedhjeve për vëzhguesit dhe organizatat jopolitike. Për hartimin e tij, dhe si pjesë e këtij Studimi, janë përfshirë rezultatet e analizave dhe analizave krahasuese të realizuara sipas rregullave të parashikuara në metodologjinë e studimeve të emërtuar “Desk Study.”

Të dhënat e përdorura për hartimin e këtij Studimi teoriko-metodik klasifikohen si të dhëna dytësore. Në këto të dhëna përfshihen:

- Konventat dhe dokumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështje të së drejtës për të zgjedhur dhe për

t'u zgjedhur, si dhe parimet, rregullat dhe standardet që kushtëzojnë ushtrimin funksional dhe efektiv të sistemit demokratik të qeverisjes.

- **Legjislacioni shqiptar** që rregullon zhvillimin e proceseve zgjedhore.
- **Rezultatet e analizave për vlerësimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar** me kërkesat e dokumenteve, konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit të BE-së që trajtojnë çështje të lidhura me të drejtën e votës dhe zgjedhjet.
- **Gjykimet dhe vlerësimet mbi rezultatet e reformës zgjedhore** dhe mbi zbatimin e këtij legjislacioni në zgjedhjet në Shqipëri.

Arsyetimi induktiv/deduktiv dhe analiza krahasuese janë përdorur për të arritur në formulimin e përfundimeve që paraqesin një tablo të sintetizuar të zhvillimit të reformës zgjedhore në Shqipëri. Mbështetur në këtë tablo, dhe duke përdorur instrumentet dhe mënyrën e arsyetimit deduktiv, është synuar formulimi i konsideratave për arritjet si dhe identifikimi i problemeve dhe çështjeve legjislative që duhet të trajtohen në të ardhmen. Qasja dhe roli që qytetari duhet të luajë në këtë proces janë formuluar duke ndjekur këtë metodologji dhe mënyrë arsyetimi.

Për të realizuar objektivin dhe qëllimin kryesor të këtij Studimi teoriko-metodik, pjesë integrale e tij është trajtimi i metodologjisë së hartuar nga Pippa, N. et al. (2013) për vlerësimin e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve (PEI), e përshtatur sipas kushteve dhe specifikave të proceseve zgjedhore dhe qasjes së shoqërisë shqiptare ndaj tyre.

KREU I PARË

NJOHURI BAZË

STANDARDET DHE PARIMET NDËRKOMBËTARE PËR

ZGJEDHJE DEMOKRATIKE

PASQYRIMI I TYRE NË KUADRIN KUSHTETUES SHQIPTAR

Në një shoqëri demokratike proceset zgjedhore demokratike dhe vota e lirë, e drejtpërdrejtë dhe e fshehtë, janë guri i themelit për të gjithë institucionet e tjera. Si pjesë e të drejtave politike, ato janë mundësia, rruga dhe instrumenti kryesor që mund të përdoren për të realizuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Për pasojë, në çdo shoqëri demokratike është e domosdoshme të hartohet një legjislacionin zgjedhor sa më i plotë dhe efektiv, në të cilin duhet të parashikohen rregulla dhe procedura që duhet të bëjnë të mundur realizimin e kësaj të drejte, në përputhje me kërkesat dhe standardet e parashikuara në të gjithë dokumentet ndërkombëtare që trajtojnë të drejta universale të njeriut.

1.1 Dokumentet ndërkombëtare kryesorë që trajtojnë të drejtën politike të njeriut për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

Ndër këto dokumente, si më kryesoret mund të renditen: *Deklarata e të Drejtave Universale të Njeriut*, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948⁶, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike*⁷, *Karta e të Drejtave Themelore të EU-së*⁸, *Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut*⁹, *Dokumenti i Copenhagës (1990) i OSCE-së*¹⁰ etj.

Këto dokumente ndërkombëtare janë firmosur dhe janë ratifikuar nga Shqipëria. Ndërkohë theksojmë se në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcaktohet se:

“Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik..... Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetë zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.... Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”¹¹

⁶ <http://www.un.org/Overview/rights.html>

⁷ http://www.un.org/Depts/Treaty/final/ts2/newfiles/part_boo/iv_boo/iv_4.html

⁸ http://www.europa.eu.int/comm/justice_home/unit/hartë/index_en.html

⁹ <http://www.cidh.oas.org/Basicos/basic3.html>

¹⁰ <http://www.osce.org/docs/english/1990-1999/hd/cope90.htm>

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 122 (1), (2)

Në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut theksohet vlera, rëndësia dhe roli që kanë zgjedhjet e lira, transparente dhe demokratike, për garantimin e të drejtave themelore e universale të qytetarëve për të marrë pjesë ose për t'u përfaqësuar në qeverisjen demokratike të vendit, në nivel qëndror dhe lokal. Neni 21 i kësaj Deklarate e përcakton në mënyrë shterruese domosdoshmërinë për organizimin dhe realizimin e zgjedhjeve të lira, periodike dhe të ndershme, si rruga e vetme që në një shoqëri demokratike arrihet të realizohen, në mënyrë efektive, të drejtat politike të qytetarëve.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Neni 21

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e tij.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike e zhvillon më tej këtë standard. Në këtë dokument zgjedhjet identifikohen si një ndër komponentët kryesorë, që duhet të zhvillojnë shoqëritë demokratike, për të bërë realisht të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje, nëpërmjet ushtrimit prej tyre të të drejtës së votës. Në nenin 25 të Paktit theksohet e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje, pa asnjë kufizim, direkt ose nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur lirisht prej tyre. Zgjedhjet e lira, të ndershme e periodike, përcaktohen si parime bazë për plotësimin e kësaj të drejte të njeriut.

Për të bërë të mundur ushtrimin, në mënyrë reale dhe efektive, të të drejtës së votës, në këtë dokument ndërkombëtar përcaktohen një numër i rëndësishëm standardesh që duhet të plotësohen. Ndër ta renditen:

- liria e shprehjes,
- liria e organizimit në shoqata e parti politike,
- pjesëmarrja e lirë në mbledhje, etj..

Pa plotësimin e këtyre standardeve zgjedhjet nuk mund të jenë demokratike dhe e drejta e votës e humbet vlerën e saj. Ajo kthehet në një instrument që, në raste të tilla, më së shumti i shërben vetëm propagandës së zotëruesve të pushtetit.

Neni 3 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përcakton se:

"Çdokush ka të drejtë të marrë pjesë me votim të fshehtë në zgjedhjen e organit ligjvënës (pra, parlamentin shtetëror) dhe në zgjedhjen e Parlamentit Evropian. E drejta për zgjedhje të lira"

Në Dokumentin e Kopenhagës, OSBE, 1990, theksohet se shtetet anëtare në këtë organizatë duhet të angazhohen për të organizuar dhe realizuar:

".. zgjedhje të lira që duhet të mbahen në intervale të arsyeshme, me votim të fshehtë ose me procedurë ekuivalente të votimit të lirë, në kushte që sigurojnë në praktikë shprehjen e lirë të mendimit të zgjedhësve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre;"

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Neni 25

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) Të votojë dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Në Aktin Final të Helsinkit, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së ranë dakord që:

*“në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, [shtetet] do të veprojnë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, ato do të përmbushin detyrimet e tyre siç përcaktohet në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë, duke përfshirë ndër të tjera, Marrëveshjet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut që mund të kenë detyrimin të zbatojnë.”*¹²¹³

1.2 Kuadri legjislativ kushtetues shqiptar për të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

Kuvendi i Shqipërisë i dal nga zgjedhjet që u zhvilluan në datë 29.04.1991, miratoi ligjin nr. 7491 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në nenin 3 të kësaj dispozitive përcaktohet:

“Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si dhe me referendum. Organet përfaqësuese zgjidhen me votim të lirë, të përgjithshëm të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë”.

Në Kushtetutën e miratuar me referendum popullor, Nëntor 1998, ky përcaktim është pjesë e dispozitave që trajtojnë parimet themelore kushtetuese të sistemit qeverisës të vendit¹³¹⁴.

Në Kreun III në të cilin trajtohen liritë dhe të drejtat politike të shtetasve shqiptarë, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur përcaktohet si e drejtë që e gëzon çdo qytetar që ka shtetësinë shqiptare dhe që ditën e zgjedhjeve ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Kushtetuta aktuale, në ndryshim nga të gjithë dokumentet e tjerë themelore të shteti shqiptar dhe ligjet për zgjedhje, nuk parashikon asnjë kufizim për të drejtën e votës, përveç rastit kur shtetasi, për arsye shëndetësore, të verifikuara prej autoriteteve, të provuara dhe të pranuar në seancë gjyqësore, shpallet mendërisht i paafte ta ushtrojë këtë të drejtë (Pika,2 nenin 45). Ky është një përjashtim që parashikohet edhe në dokumentet ndërkombëtar dhe në legjislacionin e BE-se

Përjashtimi nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, i shprehur në piken 3 të këtij neni, është një zgjidhje kushtetuese e cila është kushtëzuar nga realiteti shqiptar. Kjo dispozite është dashur të shtohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për të bërë të mundur zbatimin e ligjit 138/2015, që njihet si ligji për dekriminalizimin, në të cilin janë

¹² Akti Final i Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, “Deklarata për parimet që udhëheqin marrëdhëniet ndërmjet Shteteve pjesëmarrëse”, Helsinki, 1 gusht 1975, parimi X (paragrafët 1-3), parimi VII (paragrafi 8), (Akti Final i Helsinkit); Dokumenti Përmbyllës i Takimit të Madridit, “Çështje lidhur me sigurinë në Evropë”, Madrid, 6 shtator 1983, paragrafi 19.

¹³ Dispozitat kryesore Kushtetuese

Parime themelore

Neni 1

1. Shqipëria është Republikë parlamentare.
2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.
3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

KREU III

Liritë dhe të drejtat Politike

Neni 45

1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.
2. Përfshihen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.
3. Përfshihen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.
4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë

parashikuar rastet kur për shtetas shqiptar mund të kufizohet e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur¹⁴⁵.

Për përjashtimin nga e drejta për t'u zgjedhur dhe përjashtimin nga e drejta e votës, dispozita kushtetuese, neni 45, pika 3, nuk shprehet në të njëjtën mënyrë. Sipas kësaj dispozite, përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, i cili bën pjesë ndër krimet e përcaktuara në ligjin 138/2015, ligji për dekriminalizimin. Ndërkohë për kufizimin e të drejtës së votës, dispozita kushtetuese thekson se, vetëm në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të kësaj të drejte për shtetas që vuajnë dënimin me heqje lirie. Veç kësaj Kushtetuta parashikon që kufizimi në të drejtën për t'u zgjedhur, në raste përjashtimore dhe të justifikuara, mund të zbatohet edhe për shtetasit që janë në proces gjykim, përpara dhënies të një vendimi përfundimtar në një shtet tjetër ose kur janë të dëbuar për një krim ose cenim të rëndë dhe serioz të sigurisë publike. Për të drejtën e votës ky rast nuk parashikohet në kushtetutë.

Analiza e zgjidhjes kushtetuese dhe legjislacionit përkatës nëpërmjet zbatimit të të cilave synohet të ngushtohen hapësirat për interferimin e botës së krimit dhe personave me të kaluar jo të pastër e kriminale, në organet e zgjedhura dhe drejtuese të vendit, në nivel qendror e lokal dhe ballafaqimi i tyre me mënyrat se si trajtohet ky problem në legjislacionin e vendeve të tjera dhe në atë ndërkombëtar, evidenton qartë faktin se, zgjidhja shqiptare është afër trajtimit *inextremis* të këtij problem. Kjo është justifikuar me nivelin e lartë të mundësive për shfaqjen e një fenomeni të tillë në shoqërinë shqiptare. Këtë e ka mbështetur edhe praktika e zbatimit të këtij legjislacioni ¹⁵¹⁶.

¹⁴ Komiteti Shqiptar i Helsinkit i kërkoi Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetuese të neneve të ligjit 138/2015 që lidhen me kufizimin e të drejtës së votës për të dënuar që citohen në nenet e ligjit të dekriminalizimit. Në prill 2017 Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës së Komitetit të Helsinkit. Në vendimin e kësaj Gjykate, ndër të tjera, thuhet: "Gjykata vlerëson se parashikimi i bërë në nenin 2, pika 4, të ligjit nr.138/2015 për kufizimin e së drejtës për të zgjedhur të personave që vuajnë dënimin me heqje lirie respekton parimin e proporcionalitetit të kufizimit. Pra, Gjykata arrin në përfundimin se masa kufizuese e parashikuar në ligj i shërben një interesi publik dhe është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë...Analiza dhe qëndrimi i mësipërm i kësaj Gjykate gjejnë mbështetje edhe në jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendim nr. 43 datë 05.06.2017 (V-43/17).

¹⁵ Raport i KQZ-së në Kuvendin e Shqipërisë., 2019. <https://kqz.gov.al/document/raport-per-veprimtarine-e-kqz-se-per-vitin-2019/>

Raport i KQZ-së në Kuvendin e Shqipërisë , 2024 <https://kqz.gov.al/document/raporti-i-kqz-per-kuvendin-2023/>

KREU I DYTË

KODI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË ÇËSHTJET ZGJEDHORE (Komisioni i Venecias) dhe PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME TË.

Më 8 nëntor 2001, Komiteti i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në emër të Asamblesë, miratoi Rezolutën 1264 (2001), e cila i kërkoi Komisionit të Venecias:

1. **Të ngrejë një grup pune** të përbërë nga përfaqësues të Asamblesë Parlamentare, Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (CLRAE) dhe, mundësisht, organizatave të tjera me përvojë në këtë fushë, me qëllim diskutimin e rregullt të çështjeve që lidhen me zgjedhjet.

Të hartojë një Kod të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore, i cili duhet të mbështetet, ndër të tjera Në këtë dokument jepen udhëzimet për tre aspektet kryesore të rezolutës së përmendur, si dhe një raport me shpjegimet e nevojshme për parimet e dhëna në udhëzim.

2. Në udhëzimet e përcaktuara në shtojcën e memorandumit shpjegues të raportit mbi të cilin mbështetet kjo rezolutë (Dok. 9267). Ky Kod duhet të përfshijë rregulla për:
 - Fushatën parazgjedhore;
 - Vetë zgjedhjet;
 - Periudhën menjëherë pas zgjedhjeve.
3. **Në varësi të burimeve, të hartojë një listë të parimeve bazë të sistemeve zgjedhore evropiane**, duke koordinuar, standardizuar dhe zhvilluar studime dhe aktivitete aktuale dhe të planifikuara. Në periudhë afatmesme, të dhënat e grumbulluara për sistemet zgjedhore evropiane duhet të regjistrohen në një bazë të dhënash, të analizohen dhe shpërndahen nga një njësi e specializuar.

Në zbatim të kësaj rezolute, Komisioni i Venecias hartoi **Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore**, i cili u miratua nga Këshilli për Zgjedhjet Demokratike më 3 korrik 2002 dhe nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij të 51-të (5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002).

Në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, përmenden pesë parime bazë të trashëgimisë elektorale evropiane:

- Votimi universal;
- Votimi i barabartë;
- Votimi i lirë;
- Votimi i fshehtë;
- Votimi i drejtpërdrejtë.

Gjithashtu, nënvizohet domosdoshmëria për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve periodike. Në Kod renditen udhëzimet për rregullat legjislative që duhet të hartohen, të cilat janë të nevojshme për krijimin e bazës juridike për zgjedhje të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.1 Parime Bazë të Trashëgimisë Zgjedhore Evropiane – Pasqyrimi i tyre në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

I. Votimi Universal (Universal Suffrage)

Votim universal do të thotë, në parim, të gjithë njerëzit kanë të drejtë të votojnë dhe

të zgjidhen. Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore përcakton, në mënyrë të detajuar kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojë legjislacioni kombëtar për të bërë të mundur zbatimin e këtij parimi thelbësor. Kushtet e listuar në këtë Kod janë:

a. Mosha

Legjislacioni duhet të përcaktojë moshën minimale të shtetasit, në të cilën atij duhet t'i lind e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Në legjislacionin shqiptar është përcaktuar mosha 18 vjeç, plotësimi i të cilës i jep të drejtë shtetasit shqiptar të zgjedh ose të zgjidhet.

b. Kombësia

Legjislacioni shqiptar njeh të drejtën e ekzistencës së minoriteteve etnike/pakicave kombëtare. Për ta legjislacioni parashihet të njëjtat të drejta dhe detyra si dhe shtetasit me kombësi shqiptare. Rrjedhimisht përkatësia etnike nuk është faktor kufizues në të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre

c. Vendbanimi.

E drejta për të zgjedhur nuk kushtëzohet nga vendbanimi i shtetasit. Këtë të drejtë legjislacioni shqiptar ja u njeh të gjithë shtetasve, pavarësisht nga fakti nëse banojnë në Shqipëri ose në vende të tjera të botës.

Lidhur me këtë kërkesë, në legjislacionin zgjedhor shqiptar, ka patur kushtëzime të ndryshme ligjore, të cilat kanë ndryshuar me kohë. Mungesa e një Regjistri Kombëtar Themelor të shtetasve, lëvizjet e mëdha demografike të popullatës brenda dhe jashtë vendit, të cilat, në përgjithësi, nuk janë shoqëruar me pasqyrimin e tyre në Regjistrat e gjendjes civile, mungesat në dokumentat e identifikimit etj., kanë qënë faktorë me efekte të mëdha në procesin e hartimit dhe në cilësinë dhe plotshmërinë e Listës së Zgjedhësve. Nga ana tjetër, legjislacioni zgjedhor shqiptar e ka kushtëzuar gjithmonë ushtrimin e të drejtës për të votuar me kërkesën që shtetasi të jetë i regjistruar në Listën e zgjedhësve. Në **Kuadrin ligjor sipas të cilit është hartuar Lista e Zgjedhësve**

Nocioni **vendbanimi i shtetasit** ka qënë ndër çështjet më të debatueshme në hartimin e listës së zgjedhësve. Janë përdorur terma të ndryshëm si **vendbanim i përhershëm, vendbanim i përkohshëm, regjistër themelor i gjendjes civile, regjistër i përkohshëm i gjendjes civile**, etj., të cilët shpesh kanë gjeneruar debate të nxehta politike.

Për shtetasit emigrantë, aktualisht legjislacioni zgjedhor shqiptar nuk parashikon asnjë kufizim në të drejtën e votës. Shtetasi me vendbanim jashtë territorit të vendit mund të ushtrojë këtë të drejtë vetëm nëse paraqitet fizikisht në qendrën e votimit që ndodhet në njësinë zgjedhore përkatëse, sipas Listës së Zgjedhësve ku është regjistruar emri i tij.

Ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në kuadër të reformës zgjedhore të qershorit 2020, parashikuan mundësinë e votimit nga jashtë territorit të vendit. Megjithatë, ky ndryshim ligjor nuk u zbatua në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2021, për shkak të boshllëqeve ligjore që e shoqëruan dhe mungesës së vullnetit

politik për t'i plotësuar ato. Aktualisht, këto boshllëqe ende nuk janë adresuar, edhe pse Gjykata Kushtetuese ka ngarkuar Kuvendin e Shqipërisë me detyrën për të përfunduar këtë proces legjislativ.

Privimet nga e Drejta për të Zgjedhur dhe për t'u Zgjedhur

Privimet nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur duhet të jenë të përcaktuara qartë në legjislacionin zgjedhor. Në përputhje me përcaktimet kushtetuese, Kodi Zgjedhor, në nenin 3, shpreh qartë të drejtën e shtetasve shqiptarë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Neni 3

Parime të përgjithshme

3. Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

Në Kod janë përcaktuar në mënyrë të qartë rastet kur shtetasi privohet nga e drejta për të votuar ose e drejta për të kandiduar në zgjedhjet parlamentare ose në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Kufizimi në Kodin zgjedhor i të drejtës për të votuar është pasqyrim i kufizimeve kushtetuese, Neni 45 , pika 2,3 e drejta për të kandiduar në Kodin zgjedhor kushtëzohet nga vendbanim (zgjedhjet vendor), papajtueshmëria që rrjedh nga detyra ose profesione të caktuara që ushtron kandidati (zgjedhje politike dhe vendore) dhe nga kufizimet që lidhen me pastërtinë e figurës së kandidatit (kërkesa të ligjit për dekriminalizimin).

e. Lista e zgjedhësve

Në vendet ku legjislacioni zgjedhor e kushtëzon të drejtën për të votuar me pasjen e emrit të votuesit në listën e zgjedhësve, është e domosdoshme që në to të përcaktohen, në mënyrë të qartë, procedurat për hartimin e kësaj liste si dhe kërkesat që ajo duhet të plotësojë. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore kërkon që:

(i) Lista e zgjedhësve të jetë e përbërshme

Lista e zgjedhësve në Shqipëri gjenerohet prej Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RGJC) të shtetasve. Procesi për hartimin e kësaj liste ka qënë dhe mbetet si një ndër më të gjatët dhe me kompleksitet, me të cilët janë ballafaquar përpjekjet për të zhvilluar zgjedhje në përputhje me kërkesat dhe standardet demokratike. Hartimi i Listës së zgjedhësve, në jo pak raste është trajtuar si një mundësi e mazhorancave qeverisëse për të manipuluar procesin zgjedhor.

(ii) Lista e zgjedhësve duhet të përditësohet rregullisht, të paktën një herë në vit.

Kjo kërkesë nuk është pasqyruar në legjislacion zgjedhor shqiptar.

(iii) Listat e zgjedhësve duhet të botohen

Neni 56 i Kodit zgjedhor i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, parashikon publikimin e Listës përfundimtare të zgjedhësve jo më vonë se 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve

(iv) Duhet të ekzistojë mundësia për zbatimin e një procedure administrative, e cila t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor ose një procedure gjyqësore për regjistrimin e zgjedhësve që nuk janë regjistruar.

Neni 57 i Kodit Zgjedhor parashikon procedura të tilla administrative e gjyqësore të cilat i japin mundësi zgjedhësve të regjistrohen në listën përfundimtare të zgjedhësve

(v) Duhet të jetë e parashikuar një procedure që t'ju jap mundësi zgjedhësve të bëjnë korrigjime në Listë, në rast se konstatojnë pasaktësi

Kodi Zgjedhor shqiptar e garanton këtë të drejtë nëpërmjet dispozitave të shprehura në Nenin 57.

Neni 57

Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve

(Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012)

1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësive të qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqes kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri

24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.

2. Në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit. Në rastin kur vendimi gjyqësor bën korrigjimin e përbërësve zgjedhorë, përcaktohet qartë përbërësi zgjedhor që ndryshohet.

Kur saktësohet qendra e votimit ose zgjedhësi shtohet në listë, vendimi gjyqësor përcakton qendrën e votimit ku zgjedhësi do të votojë dhe numrin e dokumentit të identifikimit.

4. Emri i zgjedhësit që paraqitet për të votuar me vendim gjykate shënohet nga KQV-ja në një regjister të posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi i gjykatës. Në këtë regjister shënohet edhe numri i dokumentit të identifikimit që përdoret për votim. E njëjta procedurë zbatohet edhe për rastet kur vendimi është marrë në përputhje me nenin 55, por vendimi nuk është pasqyruar në listën e zgjedhësve.

f. Paraqitja e kandidaturave të pavarura

Paraqitja e kandidaturave mund të kushtëzohet me mbledhjen e një numri të caktuar firmash. Ligji nuk duhet të kërkojë mbledhjen e firmave të jo më tepër se 1 përqind të votuesve në zonën zgjedhore përkatëse. Verifikimi i firmave duhet t'ju nënshtrohet rregullave të qarta dhe vlefshmëria e tyre duhet të përfundojë përpara fillimit të fushatës.

Për plotësimin e këtyre kërkesave në Kodin Zgjedhor aktual, miratuar me Ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012, janë vendosur dispozitat përkatëse në nenet 69-71. Kodi kërkon që kandidati i pavarur të depozitojë një listë mbështetëse me firmat e jo më pak se 1 përqind të zgjedhësve të zonës zgjedhore përkatëse por, në çdo rast jo më shumë se 3,000 zgjedhës. Kodi kërkon që zgjedhësit të depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 përqind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.

II. Votim i barabartë

a. Çdo votues ka, në parim, një votë. Në rastet kur sistemi zgjedhor i akordon votuesit më tepër se një votë, të gjithë votuesit duhet të kenë të njëjtin numër votash.

Në përputhje me sistemin proporcional rajonal që aplikohet në Shqipëri, për zgjedhjet parlamentare, Neni 97, pika 1, i Kodit zgjedhor përcakton se çdo zgjedhës voton me një fletë votimi. Në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal, zgjedhësi voton me dy fletë votimi (Neni 97, pika 2).

b. Fuqia e votës është e barabartë.

Plotësimi i kësaj kërkesë kushtëzon përcaktimin e numrit që mandateve në zonat zgjedhore në mënyrë të balancuar, proporcionale, duke marr parasysh një prej kriterëve: numrin e popullatës (përfshirë edhe minoritetin), numrin e zgjedhësve të regjistruar, numrit e votuesve faktik ose kombinime të këtyre numrave.

Në Kushtetutën e Shqipërisë (Neni 64) përcaktohet se Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional, me zona zgjedhore shumë emërorë, përcaktimi i të cilave behet në Kodin zgjedhor. Në Kodin zgjedhor janë të përcaktuara dhe kriteret e procedurat që duhen të ndiqen¹⁶¹⁸. Analiza e dispozitës tregon se, kriteri i përdorur për ndarjen e numrit të mandateve, megjithëse është një ndër kriteret e rekomanduar prej Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, duke ju referuar karakteristikave demografike të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë, sjell shmangie nga parimi i barazisë së votës. Në zonat zgjedhore në rajonet veri lindore të Shqipërisë, ku numri i zgjedhësve është relativisht i vogël dhe raporti- numër i përgjithshëm i shtetasve me vend banim në zonën përkatëse zgjedhore / numër zgjedhësish është relativisht i madh, fuqia e votës në këto zona ndryshon dukshëm nga ajo e votave në zonat e tjera të vendit. Devijimi i lejueshëm nga normat duhet të mos jetë më shumë se 10 përqind dhe natyrisht nuk duhet të jetë më i lartë se 15 përqind, me përjashtim të rasteve të rralla (mbrojtja e një minoriteti të përqëndruar, njësi administrative me popullsi shumë të rralluar)

Rregullat e përcaktuara për caktimin e numrit të mandateve në zonat zgjedhore (neni 75) e kanë anashkaluar këtë kërkesë.

a. Shance të barabarta

Ligji zgjedhor duhet t'ju sigurojë shance të barabarta si partive politike edhe kandidatëve. Kjo kërkon që autoritet shtetërore të mbajnë një qëndrim asnjansës veçanërisht lidhur me (i) fushatën zgjedhore, (ii) mbulimin nga media, veçanërisht nga media publike dhe (iii) financimet publike të partive dhe fushatave.

Në Kodin zgjedhor plotësimi të këtyre kërkesave i janë kushtuar një numër i konsiderueshëm dispozitash. Fushata zgjedhore parashikohet të fillojë 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Dita përpara ditës së zgjedhjeve, deri në mbylljen e votimit, është periudha e heshtjes zgjedhore (Neni 77). Gjatë fushatës zgjedhore radiotelevizioni publik vë minutash falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në KQZ. (Neni 80,81). Ndarja e këtij minutazhi bëhet në bazë të parimit të “fuqisë” elektorale të partive, e cila vlerësohet me përqindjen e vendeve në Kuvend që ka secila parti. Neni 84 përcakton rregullat për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në radiot dhe televizionet private. Monitorim i fushatës zgjedhore në media trajtohet në nenin 85 të këtij Kodi. Kodi ngarkon me këtë detyrë Entin rregullator të mediave audiovizive. Enti raporton në mënyrë periodike, çdo jave, në KQZ për gjetjet e procesit të monitorimit dhe propozon edhe masat ndëshkuese për shkelësit e ligjit.

Parimi mbi të cilin mbështetet shpërndarja e fondeve publike për fushatën zgjedhore (neni 88) është në përputhje me udhëzimet e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.

¹⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar)

Neni 75

Kriteret dhe procedura për caktimin e numrit të mandateve

1. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish.

2. Numri total i shtetasve, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, pjestohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit.

3. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar, të përfutur sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Çdo zone zgjedhore i caktohet fillimisht një numër mandatesh i barabartë me numrin e plotë të përfutur nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se në përfundim të veprimit të kryer, sipas pikës 4 të këtij neni, një apo më shumë mandate mbeten pa u shpërndarë, ato u shpërndahen zonave mbi bazën e presjes dhjetore me të madhe të përfutur nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni. Shpërndarja e mandateve të mbetura kryhet në rend zbritës, duke filluar nga zona me presjen dhjetore më të madhe.

6. Në rast se edhe pas zbatimit të pikës 5 të këtij neni presja dhjetore e dy apo më shumë zonave është e njëjtë, mandati i fundit i caktohet asaj zone që, pas përlogaritjes sipas pikës 3 të këtij neni, ka numrin më të madh të mbetur të shtetasve që nuk kanë prodhuar mandat të plotë.

7. Në rast se dy apo më shumë zona zgjedhore, edhe pas zbatimit të pikës 6 të këtij neni, kanë numër të njëjtë shtetasish, të cilët nuk kanë prodhuar mandat të plotë, mandatet ndahen me short

nga KQZ-ja. Hedhja e shortit bëhet kurdoherë publike dhe në prani të subjekteve që kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ

Kodi ndalon përdorimin e burimeve publike në shërbim të fushatës zgjedhore subjekteve zgjedhore, si dhe rregullon zhvillimin e veprimtarive të institucioneve publike gjatë fushatës zgjedhore (neni 91, 92).

Për financimin e subjekteve zgjedhore nga fonde jo publike në Kodin Zgjedhor shprehen dispozitat e dhëna në nenin 92/1,2,3. Këto dispozita synojnë që të parandalojnë financimin me fonde të dyshimta, si dhe të ngushtojnë efektet e këtij financimi në sjelljen pas zgjedhore të partive politike.

Dispozitat ligjore për auditimin e fondeve dhe shpenzimeve për fushatat zgjedhore (neni 92/6, 7) janë të rëndësishme. Ato synojnë të ndikojnë në rritjen e transparencës së këtyre financimeve.

Siç shihet, në përgjithësi kuadri ligjor i ka zgjidhur problemet që lidhen me parimin-shance të barabarta-në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me udhëzimet e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.

Është për tu theksuar se, në proceset zgjedhore të zhvilluara në Shqipëri, diferencat midis këtyre kërkesave legislative dhe masës së respektimit të tyre prej autoriteteve shtetërore, partive politike dhe aktorëve të tjerë që marrin pjesë në një proces zgjedhor, janë të mëdha.

d. Barazia dhe pakicat kombëtare

Legjislacioni duhet të krijojë mundësi për partitë politike që përfaqësojnë pakica kombëtare. Rekomandohet që për këto pakica të parashikohet rezervimi i një numri të caktuar mandatesh dhe / ose rregulla përjashtimore në kriteret normale të ndarjes së mandateve.

Në legjislacion shqiptar lejohet krijimi i partive politike që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Aktualisht në Shqipëri veprojnë disa parti të tilla si Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)-përfaqësuese e minoritetit grek, Partia Maqedonase për Integrimin Evropian, etj. të cilat kanë marrë pjesë në procese të ndryshme zgjedhore. Legjislacioni zgjedhor nuk parashikon asnjë rrethanë mbështetëse ekstra për to. Këto parti trajtohen në të njëjtën mënyrë si edhe të gjithë partitë e tjera politike.

Legjislacioni zgjedhor nuk detyron asnjë votues të tregojë përkatësinë e tij në një pakicë kombëtare. Në kuadrin nënligjor, udhëzime të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, parashikohen detyrime për organizimin dhe zhvillimin e fushatave informuese, edukuese dhe sensibilizuese për komunitetet e pakicave kombëtare për pjesëmarrjen në proceset zgjedhore në gjuhën e tyre amtare

e. Përfaqësimi i barabartë midis gjinive

Konsiderohet se vendosja e rregullave ligjore të cilat kërkojnë sigurimin e një përqindje minimale të personave të secilit seks, në numrin e përgjithshëm të kandidatëve, nuk është shkelje e parimit për votim të barabartë. Një kushtëzim i tillë ligjor nxitet të jetë i përfshirë në legjislacionin zgjedhor. Ai mund të shërbejë si indikator për vlerësimin e nivelit të zhvillimit demokratik të shoqërisë

Në Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përfaqësimi gjinor është një çështje që trajtohet në mënyrë të veçantë. Neni 4 i këtij Kodi shprehet në mënyrë të qartë dhe shteruese për këtë çështje¹⁷.

¹⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar)

Neni 4

Ligji zgjedhor dhe barazia gjinore

(ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)

1. Ky ligj garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nën përfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.

2. Detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë mbi tagrat që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij ligji, të kërkojë nga subjektet zgjedhore pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.

3. Ligji zgjedhor nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën zgjedhore përmes:

a) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nën përfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njëjësive bazë të qeverisjes vendore;

Neni 67, pika 6 e Kodit zgjedhor përcakton se :

”Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë gjinisë së nën përfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t’i përkasë së njëjtës gjini”.

Kodi ka rregulluar edhe procedurat dhe rregullin që duhet të zbatohet në rastin e plotësimit të vakancave në Kuvendin e Shqipërisë ose në Këshillat bashkiak, me synim garantimin e plotësimit të parimit të përfaqësimit të barabartë midis gjinive.

III. Votim i lirë

Plotësimi i këtij parimi kërkon që:

a. Zgjedhësit të jenë të lirë për të formuar opinionin e tyre

Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore vlerëson se për plotësimin e këtij parimi është e domosdoshme që autoritetet shtetërore të respektojnë detyrën e tyre për të qenë të paanshëm. Sipas këtij Kodi në legjislacionin zgjedhor duhet të parashikohen dispozitat të cilat të mundësojnë përdorimin jo abuziv të mediave, të drejtën e barabartë për të manifestuar, financimin e partive dhe kandidatëve. Autoritetet publike duhet t’ju krijojnë kushte zgjedhëse për t’u informuar për listat e zgjedhëseve, subjektet politike duhet të informojnë zgjedhësit për kandidaturat e regjistruara. Legjislacioni zgjedhor duhet të parashikojë masa ndëshkuese për rastet e shkeljes së paanshmërisë dhe lirisë së zgjedhëseve.

Analiza e legjislacionit zgjedhor aktual tregon se ligjvënësi shqiptar është kujdesur që në këtë legjislacion të përmbahen dispozitat të cilat të bëjnë të mundur respektimin e këtyre kërkesave. Në plotësim të tyre veprojnë edhe dispozitat të ndryshme, të shprehura në pjesën tjetër të legjislacionin shqiptar, si në Kodin Civil, Kodin Penal, Paketën e ligjeve për Gjendjen Civile dhe Regjistrin Themelor të Shtetasve, Udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve etj.

Kodi zgjedhor parashikon të drejtën e çdo subjekti zgjedhor për të bërë fushatë, propagandë zgjedhore (Neni 78, pika 1). Për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në median publike por edhe në atë private, dispozitat e Kodit zgjedhor janë në përputhje me standardet e kërkuara në Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore.

Dispozita sipas të cilave duhet të hartohet lista e zgjedhëseve janë të përshkruara në Pjesën III, Kreu I, neni 44 – neni 57. Ndër të tjera, në këto dispozita parashikohet detyrimi i organeve që kanë përgjegjësinë për hartimin e tyre, për të informuar zgjedhësit¹⁸²⁰ si dhe subjektet zgjedhore¹⁹²¹.

Kodi zgjedhor ka parashikuar penalitet në rastet e mosrespektimit të dispozitave që kushtëzojnë barazinë e subjekteve zgjedhore për fushatë elektorale, paanshmërinë në pasqyrimin mediatik të kësaj fushate, financimin e partive politike etj.

b. Zgjedhësi duhet të jetë i lirë për të shprehur vullnetin e tij

Procedurat e votimit duhet të jenë të thjeshta. Mund të trajtohet mundësia e votimit me postë e cila mund të aplikohet në rastet e votuesve që janë në spital, në burg, janë votues me aftësi të kufizuara fizike ose jetojnë jashtë shtetit. Votimi elektronik mund të përdoret vetëm në rast se është i sigurt dhe i besueshëm. Në rastet e votimit për të tretë duhet të këtë rregulla shumë të sakta. Kutia e lëvizshme mund të përdoret vetëm në raste shumë të

b) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nën përfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së të gjitha niveleve të administratës zgjedhore;

c) marrjes së masave në reduktimin dhe eliminimin e votimit për të tretët, votimit familjar, ruajtjen dhe garantimin e fshehtësisë së votimit. ç) hartimit dhe publikimit të statistikave operative për pjesëmarrjen e gjinisë së nën përfaqësuar në ditën e zgjedhjeve, me qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të duhura për të nxitur më tej këtë pjesëmarrje

¹⁸ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar)

Neni 52

Njoftimi me shkrim i zgjedhëseve

1. Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhëseve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Lajmërimi me shkrim përmban qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhëseve të qendrës së tij të votimit

¹⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar)

Neni 60

Vënia e listave të zgjedhëseve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut

1. Listat e zgjedhëseve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

domosdoshme.

Në plotësim të kësaj kërkesë Kodi zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve parashikojnë procedura ligjore përkatëse. Në përgjithësi procesi i votimit është i thjeshtë, fleta e votimit konceptohet në një format të kuptueshëm për zgjedhësit (mënyra se si votohet me të, në çdo proces zgjedhor ka qënë pjesë e fushatës informuese të zhvilluar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve). Për votuesit në spitale, në burg, në reparte ushtarake, Kodi zgjedhor parashikon ngritjen e qendrave të posaçme të votimit (Neni 62,pika 2) pranë institucionit përkatës edhe kur në to ndodhen jo me pak se 15 zgjedhës.

Në Nenin 108, për *zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë*, Kodi ka të përcaktuara rregulla strikte të cilat synojnë të garantojnë ushtrimin e të drejtës së votës nga kjo kategori votuesish por pa krijuar hapësira për përdorim abuziv të kësaj mënyrë votimi. Në këtë dispozite theksohet se:

“Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë, Personi që ndihmon zgjedhësin me aftësi të kufizuara fizike paraprakisht duhet të bëjë një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit. Anëtarë i komisionit të qendrës së votimit dhe sekretari nuk kanë të drejtë të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë”.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon votimin me kuti të lëvizshme, votimin me postë dhe votimin elektronik.

c. Duhet të sigurohen kushte për të luftuar mashtrimin zgjedhor

Procedurat e votimit, vlerësimit dhe numërimit të votave duhet të jenë transparente, ato duhet të bëhen në qendra të caktuara me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të një numri partish dhe vëzhguesve të caktuar nga kandidatët, të cilët duhet të kenë të drejtën të marrin procesverbalet përkatëse, rezultatet e zgjedhjeve duhet të përcillen në nivel më të lartë nëpërmjet një procedure të hapur. Shteti duhet të ndëshkojë çdo lloj mashtrimi zgjedhor.

Ligjvënësi shqiptar i ndodhur në kushtet e mungesës së madhe të besimit reciprok midis partive politike është investuar shumë për të hartuar procedura ligjore të cilat synojnë të ngushtojnë në maksimum, hapësirat që mund të përdoren për të realizuar mashtrim zgjedhor. Historia e hartimit të legjislacionit zgjedhor është e tejnigopur me zgjidhje legjislative të cilat, si synim kryesor të tyre kanë patur zvogëlimin e hapësirave për interpretime dhe mashtrim zgjedhor, sesa kujdesin për të hartuar “rregulla loje” të cilat do të mundësonin, sa më mirë të ishte e mundur, një proces zgjedhor në përputhje me standardet. Me këtë argument mund të shpjegohet edhe këmbëngulja e të gjithë partive politike për prezencë sa më të madhe të përfaqësuesve të tyre, në të gjitha hallkat e administratës zgjedhore. Në funksion të kësaj kërkesë, në jo pak raste partitë politike, në veçanti dy partitë e mëdha PD e PS, nuk kanë nguruar që të realizojnë zgjidhje ligjore që kanë qënë vetëm pasojë e kompromisit politik, arritja e të cilit ka kërkuar edhe anashkalimin dhe/ose mosrespektimin e kërkesave kushtetuese. I tillë ka qënë p.sh.

-Ndryshimi i bërë në Kushtetutën e Shqipërisë me Ligji nr. 9675, datë 13 Janar 2007, “Mbi disa ndryshime në Ligjin №. 8417, datë 21 Tetor 1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i cili ndryshoi numrin dhe përbërjen e anëtarëve të KQZ, duke rritur numrin e tyre në 9 anëtarë, katër prej të cilëve duhet të zgjidheshin ndërmjet kandidatëve që propozonin partitë politike të mazhorancës dhe opozitës.

-Ndryshimi në Kodin zgjedhor me Ligji Nr. 9676, datë 13.01.2007 sipas të cilit komisionet e nivelit të dytë e të tretë u vendos të përbëheshin me nga 13 anëtarë, ndryshim që rezultoi se e vështirësonte në mënyrë të dukshme, administrimin e procesit zgjedhor.

Kodi aktual, i miratuar me Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012 , nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020 parashikon prezencën e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në të gjitha hallkat e administratës zgjedhore ose si anëtarë me të drejtë vote ose si vëzhgues. Sipas këtij Kodi, e gjithë administrata zgjedhore ngrihet në bazë të parimit të përfaqësimit dhe balancimit politik.

Për të rritur transparencën në procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave, i cili bëhet në mënyrë të përqëndruar, në një vend numërimi për çdo zonë të administrimit zgjedhor, Kodi zgjedhor parashikon edhe përdorimin e teknikës elektronike mbështetëse. Rezultatet e numërimit dhe të tabelimit transmetohen *online*, në kohë reale, në KQZ. Numërimi i votave bëhet nga përfaqësues të partive politike. Grupet e numërimit ngrihen mbi bazën e përfaqësimit dhe balancimit politik. Subjektet zgjedhore që nuk kanë anëtarë në këto grupe, kanë të drejtën të kenë vëzhgues.

Kodi zgjedhor parashikon penalitete për të gjithë ata që ndërhyjnë në procesin e administrimit të votës dhe ndëshkon anëtarët e administratës zgjedhore, në rast të shkeljes së procedurave ligjore të parashikuara në të.

Zgjidhje ligjore të parashikuara në Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë janë të përputhura kërkesat e

Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, megjithëse, në ndonjë rast ato janë të sforcuara ose edhe të mbingarkuara.

IV. Votim i fshehtë

Fshehtësia e votës nuk është vetëm një e drejtë por edhe detyrë. Votimi duhet të bëhet individualisht. Votimi në familje dhe çdo lloj tjetër kontrolli i votës nuk duhet të lejohet. Shkelja e fshehtësisë së votës duhet të ndëshkohet.

Në legjislacionin shqiptar është përcaktuar: “Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë... Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës” (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, Kodi Zgjedhor i R. Shqipërisë, neni 3, pika 2). Për të garantuar këtë në Kod janë parashikuar procedura të detajuara, sipas të cilave duhet të votojë zgjedhësi (Neni 105, Neni 106). Këto procedura janë garanci ligjore për plotësimin e kërkesave të shprehura në dispozitën e mësipërme ligjore (Neni 3, pika 2).

Votimi familjar dhe kontrolli i votës janë të ndaluara. Për këtë Kodi përcakton qartë se: “...zgjedhësi kontrollohet në të dy duart nëse është i timbruar ose jo me lëndën e posaçme, në rast se po, nuk lejohet që të vazhdojë procedurën e mëtejshme..... një zgjedhës mund të marrë vetëm një fletë votimi dhe vetëm një herë,...pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë... zgjedhësi bën shënimin në fletën e votimit vetëm kur ndodhet në dhomën e fshehtë... e palos fletën e votimit në mënyrë që të mos jetë e dukshme ... dhe pasi e hedh në kutinë e votimit largohet nga qendra e votimit...” (Neni 105, Neni 106)

Siç shihet legjislacioni është i përputhur me kërkesat e standardeve të parashikuara në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Gjithsesi, duhet të theksohet se midis këtij legjislacioni dhe praktikës së zbatimit të tij ka diferenca të ndjeshme. Në të shumtën e tyre këto diferenca janë rrjedhojë e një tërësie komplekse faktorësh me natyrë sociale, historike, të kulturës, traditës, psikologjisë shoqërore, ekonomike dhe të zhvillimit demokratik të shoqërisë. Veprimi i këtyre faktorëve dhe jo legjislacioni është shkaku që fenomenet e votimit familjar, votimit në grup etj.. janë të shpeshta në proceset zgjedhore në Shqipëri, në veçanti në zonat rurale dhe sub urbane.

V. Votim i drejtpërdrejtë

Legjislacioni shqiptar parashikon vetëm votim të drejtpërdrejtë si për Kuvendin e Shqipërisë, ashtu dhe për organet e pushtetit lokal.

VI. Periodiciteti i zgjedhjeve

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton që zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, si rregull të zhvillohen një herë në katër vjet. Pas ndryshimeve të bëra në Kushtetutë, me ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007 edhe zgjedhjet për organet e pushtetit lokal zhvillohen, si rregull, një herë në katër vjet²⁰.

2.2 Trashëgimia zgjedhore evropiane – Domosdoshmëria për zbatim në praktikën zgjedhore në Shqipëri

Për të bërë të mundur zbatimin e parimeve të trashëgimisë zgjedhore evropiane, në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, janë renditur një varg kushtesh që duhet të plotësohen. Ndër këto kushte, bëjnë pjesë kushtet që lidhen me respektimin e të drejtave themelore të njeriut si liria e shprehjes dhe e shtypit, liria e qarkullimit brenda vendit, liria e grumbullimit dhe liria e bashkimit ose organizimit për qëllime politik, duke përfshirë krijimin e partive politike. Kushtetuta e Shqipërisë i garanton të gjitha këto liri. Në përputhje me këtë Kushtetutë, trupa legjislative shqiptare ka miratuar një numër të konsiderueshëm kodesh e ligjesh dhe, ekzekutivi shqiptar ka miratuar tërësinë e akteve nënligjore, të nevojshme për zbatim praktik të tyre. Ky është një proces i vazhdueshëm.

Për hartimin e rregullave dhe të ligjit zgjedhor, Kuvendi i Shqipërisë është investuar në vazhdimësi për të hartuar legjislacionin e nevojshëm. Si praktikë legjislative është ndjekur ajo e krijimit të një komisioni parlamentar ad hoc për Reformën zgjedhore. Ky Komision ka trajtuar dhe zgjidhur, në nivelin e një draft dokumenti, problemet legjislative që lidhen me elementët themelor të ligjit zgjedhor dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, hartimit të kufijve të zonave zgjedhore etj.. Karakteristikë dalluese në punën e këtij Komisioni dhe,

²⁰ Ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007

Neni 1

Pika 1 e nenit 109 ndryshohet si më poshtë:

“1. Organet përfaqësuese të njëjësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë”.

për rrjedhojë edhe në punën e të gjithë legjislativit shqiptar është fakti se, pavarësisht rekomandimeve, ndryshimet në kuadrin ligjor zgjedhor kanë qënë të shpeshta. Edhe në rastet kur, për të siguruar qëndrueshmëri në zgjidhjet legislative, dispozita të veçanta që lidhen me këtë legjislacion janë vendosur në Kushtetutën e vendit, si ka qënë rasti i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ose i Sistemit zgjedhor shqiptar, klasa politike shqiptare nuk ka hezituuar për të ndërhyrë dhe për t'i ndryshuar, pa marrë në konsideratë kohën e shkurtër gjatë të cilave kanë vepruar këto dispozita kushtetuese.

Për të bërë të mundur respektimin e parimeve të trashëgimisë zgjedhore evropiane janë të nevojshme ndryshime legislative, të cilat duhet të mundësojnë realizimin e garancive procedurale. Për këtë, në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore rekomandohet që:

(i) Zgjedhjet të organizohen nga një organ i paanshëm

Për të mundësuar këtë, në Kushtetutën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, miratuar me referendum më 22.11.1998 dhe shpallur me dekretin nr.2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Pjesa e dymbëdhjetë, Neni 154, 155, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve përcaktohej si një institucion kushtetues, pa përfaqësim politik. Kjo zgjidhje legislative, e cila në themel të saj kishte institucionalizimin e një organi të paanshëm për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, rezultoi e paqëndrueshme. Amendimet e Kushtetutës me Ligj Nr.9904, datë 21.4.2008 e kthyen këtë institucion në objekt të Ligjit Zgjedhor, sipas të cilit, ai duhet të ndërtohej mbi parimin e përfaqësimit dhe balancimit politik. Në kontekstin legjislativ, në parim një zgjidhje e tillë nuk i kundërvihet kërkesës për të patur një institucion të paanshëm por, në praktikën zgjedhore nuk ishin të rralla vendimmarrjet e këtij institucioni mbi bazën e përkatësive politike të anëtarëve të tij.

Në kuadër të reformës zgjedhore që u krye në vitin 2020, Këshilli Politik dhe pas tij Kuvendi i Shqipërisë, mbështetur në marrëveshjen e 6 Qershorit 2020, vendosi që KQZ të ndërtohet si një institucion me një komponente autokratike-Komisioneri shtetëror i zgjedhjeve dhe dy organe kolegjiale-Rregullatori dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve. Megjithatë dispozitat që trajtojnë problemin e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ kanë si objektiv kryesor të tyre ndërtimin e një institucioni, anëtarësia e të cilit të mos varet nga partitë politike, vendosja në këtë Kod e dispozitave kalimtare, Neni 183, e pamundësoi arritjen e këtij synimi. Anëtarët e KQZ u zgjedhën në baze të vullnetit dhe dakordësisë midis partive kryesore politike, duke i anashkaluar, në mënyrë të dukshme, kërkesat që përcaktohen në nenet 13, 15 dhe 16 të Kodit zgjedhor në lidhje me cilësitë që duhet të zotërojnë anëtarët e KQZ.

Edhe administrata zgjedhore e nivelit të dytë, të tretë dhe grupet e numrit të votave formohen sipas parimit të përfaqësimit dhe balancimit politik.

(ii) Administrata zgjedhore duhet të jetë e qëndrueshme

Komisioni i Venecies rekomandon që subjektet që caktojnë anëtarët në komisionet zgjedhore nuk duhet të kenë dorë të lirë për t'i shkarkuar ata sipas dëshirës.

Këtë rekomandim, klasa politike shqiptare nuk e ka marrë në asnjë rast në konsideratë²¹

(iii) vendimmarrja në komisionet zgjedhore duhet të bëhet me shumicë të cilësuar ose konsensus.

Kodi zgjedhor për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve përcakton dy mënyra për vendimmarrje. Kërkohet vendimmarrje me shumicë të cilësuar, votojnë “pro” jo më pak se 4 anëtarë të Komisionit Rregullator përveç vendimet për:

(b) numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend;

(d) rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me këtë ligj, të cilët miratohen me shumicën e thjeshtë

Komisionet e nivelit të dytë dhe të tretë i marrin vendimet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tyre. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

Siç shihet legjislacioni zgjedhor shqiptar nuk është i përputhur me rekomandimin që jep Komisioni i Venecies për mënyrën e vendimmarrjes në komisionet zgjedhore. Praktika zgjedhore ka treguar se kjo është edhe zgjidhja më e mirë, në kushtet e Shqipërisë, zgjidhje e cila zvogëlon mundësitë për veprimin e pakicave bllokuese, të cilat mund të aktivizohen politikisht edhe në raste të papërligjura.

²¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar)

Neni 32.

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast.

(iv) Zgjedhjet duhet të vëzhgohen

Legjislacioni duhet të parashikojë lehtësi procedurale për vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtar.

Në plotësim të këtij rekomandimi Kodi zgjedhor shqiptar, në Kreun II, “Vëzhguesit” Neni 6 dhe Neni 7, përcaktojnë se kush ka të drejtë të këtë vëzhgues si dhe të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve. Në zbatim të këtyre dispozitave organizata të shoqërisë civile dhe mediat shqiptare ashtu sikurse institucione dhe organizatat ndërkombëtare kanë të drejtë të vëzhgojnë procesin zgjedhor, pa u kufizuar në kohë. Vëzhgimi është i lejuar të organizohet për të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe për të gjithë administratën zgjedhore.

(v) Legjislacioni duhet të garantojë një sistem të efektshëm apelimi

Apelimet mund të bëhen në komisionet zgjedhore të nivelit të dytë (KZAZ/KZQV) si dhe në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Vendimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Komisionerit shtetëror dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) mund të ankimohen në rrugë gjyqësore në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Kodi zgjedhor përmban dispozita të qarta dhe të thjeshta për tu zbatuar, veçanërisht sa i përket pranimin të kërkesës. Procedurat e ankimit, kompetencat e organeve të ndryshme që ju drejtohen këto ankime, çështjet që mund të jenë objekt apelimi, afatet kohore për paraqitjen e ankimit dhe shqyrtimin e tij nga organi përkatës, e drejta e kërkuarit për të marrë pjesë në seancën dëgjuese etj.. janë zgjidhje legjislative në përputhje me standardet e kërkuara prej Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.

Për të gjykuar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat dhe parimet e Kodit të Praktikave të Mira për çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, vëzhguesi i pavarur mund të përdorë treguesit e mëposhtem:

Treguesit për vlerësimin e përafrimit	Po	Jo
Legjilacioni shqiptar parashikon që votimi të jetë universal?		
Procedurat e parashikuara në Kodin zgjedhor e respektojnë parimin për votim të barabartë?		
Procedurat e parashikuara në Kodin zgjedhor e respektojnë parimin për votim të lirë?		
Procedurat e parashikuara në Kodin zgjedhor e respektojnë parimin për votim të fshehtë?		
Procedurat e parashikuara në Kodin zgjedhor e respektojnë parimin për votim të drejtpërdrejtë?		
Legjislacioni shqiptar përcakton zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin ose organet e vetëqeverisjes vendore në mënyrë periodike ?		

Vlerësimin për nivelin e plotësimit të kërkesave që lidhen me parimet e trashëgimisë zgjedhore europiane, vëzhguesi i pavarur mund ta mbështesë në përgjigjet që duhet t’ju japë pyetjeve që lidhen me treguesit e paraqitur në vijim:

Treguesit për vlerësimin e plotësimit të parimeve të trashëgimisë zgjedhore europiane	Po	Jo
Zgjedhjet organizohen dhe administrohen nga një organ i paanshëm?		
Administrata zgjedhore është e qëndrueshme dhe e pakërcënuar nga vullneti i partive politike ?		
Vendimmarrja në komisionet zgjedhore bëhet me shumicë të cilësuar ose me konsensus.		
Legjislacioni jep mundësi për vëzhgimin e zgjedhjeve prej vëzhgues të pavarur vendorë ose ndërkombëtarë ?		
Legjislacioni garanton një sistem të efektshëm apelimi ?		

KREU I TRETË

NJOHURI TË VËZHGESIT VENDOR PËR VLERËSIMIN E EFEKTIVITETIT DHE QËNDRUESHMËRISË SË LEGJSLACION ZGJEDHOR

Hartimi i një legjislacioni efektiv në të cilin gjejmë pasqyrim kërkesat dhe standardet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, karakteristikat dhe veçoritë e shoqërisë dhe të vendit ku ai zbatohet është kusht i domosdoshëm për të bërë të mundur zhvillim e zgjedhjeve demokratike. Ndërkohë është rëndësishme të theksohet se për të realizuar një legjislacion të tillë, procesi legjislativ duhet të realizohet si një proces dinamik që duhet të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. Nevoja për përditësime të këtij legjislacioni është e lidhur me nevojën për ndryshime të cilat kushtëzohen nga problemet që vëritohen gjatë zbatimit të tij. Ato janë dhe pasojë e ndryshimeve të vazhdueshme në kulturën e ushtrimit të demokracisë në shoqërinë dhe vendin përkatës. Ky proces reformues legjislativ, ndryshe i emërtuar Reformë zgjedhore, është një ndër përgjegjësitë dhe detyrimet që ka trupa legjislative e vendit për realizimin e të cilës, standardet dhe dokumentat shpjegues ndërkombëtar rekomandojnë që të zhvillohet si një proces gjithëpërfshirës.

Për të mbështetur procesin legjislativ, objekt i të cilit është ligji për zgjedhjet, Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR kanë hartuar një numër të konsiderueshëm dokumentash në trajtën e opinionëve ose të udhëzuesve²². Sipas tyre, autoritetet shtetërore të çdo vendi janë ato që duhet të përcaktojnë strukturën e legjislacionit për zgjedhjet, në bazë të traditave ligjore të vendit, përvojës dhe kapaciteteve të shoqërisë përkatëse për të ushtruar demokracinë në përputhje me parimet dhe standardet e gjithë pranuar për t'u realizuar zgjedhje demokratike. Legjislacioni zgjedhor duhet të hartohet i tillë që, të bëjë të mundur realizimin e një procesi zgjedhor të barabartë, të sigurt, lehtësisht të monitorueshëm dhe transparent. Legjislacioni duhet të garantojë qëndrueshmëri por, njëherazi duhet të mundësojë edhe rishikimin juridik, duke qënë i hapur për kundërshti nga shtetasit dhe institucione ose aktorë të tjerë të interesuar.

Duke ju referuar praktikave më të mira ligjbërëse dhe “Udhëzuesit për rishikimin e një kuadri ligjor për zgjedhjet”²³ mund të pohohet se procesi për hartimin dhe përditësimin e legjislacionit zgjedhor duhet të realizohet duke mbajtur përherë në konsideratë faktin se, ky legjislacion është një korpus ligjor në të cilin shprehen parimet, kërkesat dhe standardet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, si dhe tërësia e procedurave, zbatimi i të cilave mundëson zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike. Në mënyrë të skematizuar problemet dhe çështjet që, të marra së bashku përbëjnë këtë korpus ligjor janë paraqitur në Figurë 2. Është e rëndësishme të theksohet se suksesi në procesin ligjbërës, me objekt ligjin zgjedhor, mund të arrihet vetëm nëse ligjbërësi i trajton, me të njëjtin standard dhe me të njëjtin kujdes, të gjitha çështjet dhe problematikat që përbëjnë aspekte e ndryshme të tij.




Figura 2 Komponentët përbërës që kushtëzojnë hartimin e një legjislacioni zgjedhor efektiv dhe të qëndrueshëm

²² [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)036-alb](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)036-alb)
<https://www.osce.org/files/f/documents/e/9/384798.pdf>

²³ OSBE/ODIHR (2018) "Udhëzuesit për rishikim e një kuadri ligjor për zgjedhjet" Botimi i dytë. <https://www.osce.org/files/f/documents/e/9/384798.pdf>

Gjykimi dhe vlerësimi objektiv i rezultateve të arritura në procesin legjislativ që targeton çështje të zgjedhjeve dhe i efekteve të legjislacionit zgjedhor në suksesin e përpjekjeve për implementimin e demokracisë përfaqësues, rekomandohet të kryhet nëpërmjet:

(i) analizës së zgjidhjeve ligjore e procedurale që legjislacioni ofron për aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor dhe

(ii) analizës së gjetjeve nga procesi i vëzhgimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij legjislacioni në zgjedhjet për Kuvendin ose për organet e vetëqeverisjes vendore.

Mbështetur në përvojën e realizuar në përpjekjet e bëra në vendin tonë për vlerësimin e legjislacionit zgjedhor, të bëra me synimin formulimin e propozimeve për përmirësim të mëtejshme të tij dhe duke mbajtur parasysh këshillimet udhëzuese të Komisionit të Venecies dhe OSBE/ODIHR, angazhimi për vlerësimin e legjislacionit aktual, këshillohet të bëhet duke ju referuar paraqitjes strukturore skematike të mësipërme.

3.1 Sistemi zgjedhor

Për të siguruar qëndrueshmërinë në proceset zgjedhore, në Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore rekomandohet edhe mundësia që Sistemi zgjedhor sipas të cilit zhvillohen zgjedhjet për organin kryesor legjislativ, Kuvendin në rastin e Shqipërisë, të përcaktohet në Kushtetutën e vendit. Këtë zgjidhje ka zbatuar edhe Shqipëria. Sipas Kushtetutës të miratuar me referendum të përgjithshëm kushtetues, Nëntor 1998, zgjedhjet për Kuvendin duhet të zhvilloheshin sipas një sistemi proporcional të korrigjuar me mazhoritar. Në 100 njësi zgjedhore do të garonin, në mazhoritar, kandidatët. Koalicionet ose partitë politike, do të garonin me listë kombëtare me 40 kandidatë. Shpërndarjen e mandateve të listës proporcionale Kushtetuta dhe Kodi zgjedhor e kushtëzonte me rezultatin që subjekti përkatës arrinte në garën mazhoritare. Ky sistem u zbatua në zgjedhjet për Kuvendin që u zhvilluan në vitin 2001.

Ndryshimi i parë i bërë në Kushtetutë në dispozitat që trajtojnë sistemin e zgjedhjeve ishte kalim nga zgjedhje me dy raunde në mazhoritar në zgjedhje vetëm me një raund. Ndryshimet kushtetuese të bëra në prill, 2008 prekën vetë sistemin. Sipas tyre, zgjedhjet për Kuvendin duhet të zhvilloheshin sipas sistemit Proporcional rajonal, ku njësitë zgjedhore duhet të përcaktoheshin duke ju referuar një prej ndarjeve territoriale administrative të vendit. Në Kodin zgjedhor u përcaktuan 12 njësi zgjedhore korresponduese të 12 qarqeve të vendit.

Si shihet, ligjvënësit shqiptar, partitë politike, megjithëse pranuën që sistemi zgjedhor të përcaktohej në Kushtetutë, duke mundur në këtë mënyrë, si rekomandohet edhe nga Komisioni i Venecies, qëndrueshmërinë e tij, nuk kanë nguruar dhe e kanë ndryshuar atë sa here që i është dashur interesit të tyre, në veçanti dy të mëdhajave, PS e PD.

Ndryshimet e shpeshta të bëra në sistemin zgjedhor kanë krijuar hapësirë të mjaftueshme për ta bërë vulnerabël këtë sistemin. Shtuar kësaj edhe faktin, tashmë të provuar, në lidhje me efektin negativ që ka prodhuar mënyra e zbatimit të këtij sistemi në fuqinë votës për t'u shndërruar në mandat deputeti, rezultat i ndarjes së vendit në 12 njësi zgjedhore, diskutimi për ndryshimin e sistemit të zgjedhjeve për Kuvendin është aktualisht një ndër me frekuentët.

3.2 Harta e njësive zgjedhore

Aktualisht, për efekt të zgjedhjeve parlamentare, Kodi zgjedhor duke ju referuar përcaktimit kushtetues që ishte në fuqi deri përpara ndryshimeve të fundit që janë bërë në Kushtetutën e Republikës, Korrik 2020, e ndan vendin në 12 njësi zgjedhore, me shtrirje në territor që i korrespondon ndarjes territoriale administrative-qark.

Ndryshimet kushtetuese të korrik 2020 e abroguan këtë përcaktim kushtetues. Ndarja e vendit në njësi zgjedhore tashmë është çështje që duhet të zgjidhet në Kodin zgjedhor pa patur asnjë kushtëzim kufizues paraprak.

Duke ju referuar argumentimit të Komisionit të Venecies në lidhje me përfshirjen e sistemit të zgjedhjeve në Kushtetutë dhe duke përdorur mundësinë që krijon abrogimi, me ndryshimet kushtetuese, Korrik 2020, të dispozitës që detyronte ndarjen e vendit në njësi zgjedhore sipas një prej ndarjeve territoriale administrative, pa e ndryshuar sistemin në Kushtetute-Sistem proporcional rajonal, efektet negative të tij në pabarazinë e fuqisë së votës për t'u shndërruar në mandat deputeti, mund të zvogëlohen, deri në nivel të papërfillshëm, në rast se në Kodin zgjedhor përcaktohet ndarja e vendit, për efekt të zgjedhjeve parlamentare, në 4 (katër) rajone zgjedhore. Ky ndryshim në ligjin zgjedhor krijon mundësi për të patur një legjislacion me efektiv dhe më të qëndrueshëm.

3.3 Administrata zgjedhore

Komisioni i Venecies në Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet zgjedhore i kushton vend të veçantë trajtimit të parimeve dhe rregullave sipas të cilit duhet të ngrihet dhe të funksionojë administrata zgjedhore.

Në reformat zgjedhore të kryera në Shqipëri, çështje që lidhen me parimin dhe rregullat sipas të cilave duhet të ngrihet dhe të funksionojë administrata zgjedhore kanë qënë ndër më të debatuarat. Pavarësisht nga ndryshimet dhe diferencat që mund të vërehen në vendimmarrjet e ndryshme për këtë çështje, e përbashkëta e tyre është – ndërtimi administratës zgjedhore mbi bazën e parimit të përfaqësimit politik. Shpesh janë bërë përpjekje edhe për balancim politik. Në asnjë rast partitë politike nuk kanë pranuar të heqin dorë nga e drejta për të patur në komisionet zgjedhore dhe grupet e numërimit të votave anëtarë të propozuar prej tyre. Pavarësisht nga rekomandimet e përsëritura të Misioneve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR, asnjëherë partitë politike nuk kanë hequr dorë nga e drejta për të zëvendësuar anëtarët në komisionet zgjedhore të nivelit të dytë e të tretë sa herë të duan dhe pa dhënë asnjë shpjegim.

Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore

3. Garancitë procedurale

3.1 Organizimi i zgjedhjeve nga një organ i paanshëm

68. Vetëm transparenca, paanshmëria, dhe pavarësia ndaj manipulimeve politike mund të sigurojnë administrimin e rregullt të procesit elektoral, nga periudha para-zgjedhore deri në fund të përpunimit të rezultateve.

70. në vendet me përvojë të paket në organizimin e zgjedhjeve pluraliste, ekziston rreziku që qeveria të detyrojë autoritetet administrative të bëjnë çfarë dëshiron qeveria. Kjo ka të bëjë si për qeverinë qendrore ashtu dhe atë vendore-edhe nëqoftëse pushteti vendor kontrollohet nga opozita e vendit.

71. duhet të ngrihen komisione zgjedhore të pavarura, të paanshme nga niveli kombëtar deri në nivelin e qendrës së votimit në mënyrë që zgjedhjet të zhvillohen siç duhet, ose, të paktën, për të eliminuar dyshime serioze për çrregullime.

Përpjekjet e bëra për të ndërtuar një administratë zgjedhore që nuk përfaqëson partitë politike dështuan edhe në reformën e fundit zgjedhore, Qershor, 2020. Edhe ndryshimet e bëra në strukturën e KQZ dhe rregullat e reja për zgjedhjen e anëtarëve të këtij institucioni rezultuan të pa suksesshme. KQZ, duke patur në përbërjen e saj dy organe kolegjinale anëtarë të të cilëve, sipas dispozitave kalimtare u zgjodhën në bazë të vendimit paraprak të partive politike, nuk arriti të ndërtohej si një organ që nuk ndikohet nga presioni i partive politike që i kanë përzgjedhur këta anëtarë.

Rekomandimet e përsëritura të OSBE/ODIHR për ndërtimin e një administrate zgjedhore jo partiake dhe zgjidhjet e dështuara të derisotme, nxitin mendimin për realizimin e procesit të departizimit të administratës zgjedhore, si një proces me zhvillim gradual në kohë.

Referuar pritshmerive, funksionimi i KQZ me strukturë të kombinuar, monokratike dhe kolegjinale, nuk rezultoi efektiv. Përkundrazi krijoi situata të cilat kanë ndikuar negativisht në kredibilitetin e këtij institucioni. Është koha që të rishikohet kjo zgjidhje. Një KQZ monokratike, e drejtuar nga një Komisioner që nuk duhet të jetë nën presionin e ndërprerjes së detyrës dhe kohëzgjatjes së mandatit, zgjedhja e të cilit duhet të realizohet si një proces gjithëpërfshirës është një opsion që duhet të konsiderohet. Caktimi prej KQZ në komisionet e nivelit të dytë e të tretë i një komisioneri të trajnuar e të certifikuar prej KQZ, i cili të ketë edhe detyrën dhe përgjegjësinë për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës në komisionin përkatës, krahas dhe bashkë me dy komisionerë të propozuar nga dy partitë kryesore politike, mund të jetë një fillim premtues për departizimin e administratës zgjedhore.

3.4 Lista e zgjedhësve

Në vende si Shqipëri ku ushtrimi i të drejtës së votës mund të behet vetëm nëse shtetasi është i regjistruar në listën e zgjedhësve, Kodi zgjedhor i kushton një vend të veçantë procesit të hartimit të listës së zgjedhësve. Për kryerjen e këtij procesi, legjislatiori ngarkon organet e vetëqeverisjes vendore dhe Zyrat e gjendjes civile. Procesi parashikon pjesëmarrjen aktive të zgjedhësve në hartimin e kësaj liste. KQZ është organ që mbikëqyr këtë proces dhe partitë politike kanë të drejtën për të marrë informacion për produktet e këtij procesi në çdo fazë të tij.

Lista e zgjedhësve hartohet si produkt i Regjistrimit kombëtar të Gjendjes civile të shtetasve. Rezultatet e marra nga ky proces kanë treguar se në Shqipëri është bërë progres i ndjeshëm në cilësinë, saktësinë dhe plotshmërinë e Listës së zgjedhësve. Për pasojë Lista e zgjedhësve nuk bën pjesë më ndër shkaqet që ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit zgjedhor. Ndërkohë, duhet të theksohet se puna për rregullimin e mëtejshëm të Listës së zgjedhësve është e nevojshme. Ndër zhvillimet e pritshme të këtij procesi duhet të jetë plotësimi ligjor sipas të cilit organet e vetëqeverisjes vendore duhet të ngarkohen me detyrën për të përditësuar dhe publikuar në mënyrë të përvitshme Listën e zgjedhësve, si rekomandohet edhe në Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore.

3.5 Regjistrimi i partive dhe kandidatëve

Në linjat kryesore, legjislatiori zgjedhor e trajton këtë çështje në përputhje me kërkesat e standardeve dhe praktikave me të mira zgjedhore. Në opinionet e Komisionit të Venecias dhe në vlerësimet e misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar OSBE/ODIHR për këtë çështje, kritikën, vërejtjet dhe rekomandimet e tyre përqëndrohet kryesisht në problemet dhe tek vështirësitë që përballen në procesin e regjistrimit të partive dhe kandidatëve të pavarur. Reflektimi në Kodin zgjedhor i rekomandimeve që janë dhënë për rregullimet që duhet të bëhen është një ndër çështjet që duhet të trajtohet dhe t'i jepet zgjidhje si pjesë e punëve në reformën zgjedhore.

Kushtetuta përcakton partitë politike dhe qytetarët si subjektet e vetëm që kanë të drejtën të propozojnë kandidatë për zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet vendore. Në Kushtetutë nuk shprehet asnjë dallim midis këtyre dy subjekteve në mundësinë dhe rregullin e ushtrimit të kësaj të drejte. Mundësia dhe rregullimin i ushtrimit të kësaj të drejte është objekt i Kodit zgjedhor. Duke ju referuar zgjidhjes legjislative që përcaktohet në Kodin zgjedhor evidentohet diferenca në ushtrimin e kësaj të drejte prej partive politike dhe qytetarëve. Partitë politike kanë të drejtë të regjistrojnë listë me kandidatë për deputetë ose për anëtarë të këshillave bashkiak, ndërkohë që qytetarëve kjo e drejtë ju kufizohet në kandidimin e vetëm një kandidati të pavarur. Duke ju referuar sistemit sipas të cilit zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet për këshillat bashkiak, një kufizim i tillë e ka bërë praktikisht me efekt zero të drejtën kushtetuese të qytetarëve për t'u përfaqësuar në parlament ose në këshilla bashkiak me kandidatë që propozohen prej tyre. Një rregullim i mundshëm i kësaj situate është ndryshimi në Kodin zgjedhor nëpërmjet të cilit qytetarëve t'u jepet e drejta për të garuar në zgjedhje me *Listë me kandidatë të pavarur*.

3.6 Fushata zgjedhore

Kodi zgjedhor i trajton çështjet që lidhen me fushatën zgjedhore, periudhën e fushatës zgjedhore, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës, përdorimin e radiotelevizion publik dhe mediave audiovizive private për qëllime të fushatës zgjedhore, etj., në përgjithësi në përputhje me kërkesat për barazinë proporcionale që duhet t'ju garantojë legjislatiori të gjithë subjekteve zgjedhore. Në ndryshime ligjore të bëra në prag të zgjedhjeve parlamentare, 2021 ju kushtua vëmendje e veçantë rregullimit të çështjeve që lidhen me përdorimin e aseteve publike dhe veprimtarive të institucioneve publike për të zvogëluar mundësitë e përdorimit të tyre për fushatën zgjedhore. Zbatimi i këtyre ndryshimeve në zgjedhjet parlamentare, 2021 dhe zgjedhjet vendore, 2023 evidentoi nevojën për rregullime të mëtejshme. Në veçanti vëmendje duhet t'i kushtohet rregullimeve që duhen për të zvogëluar hapësirat për interpretim të dispozitës dhe për të rritur hapësirat për organet e zbatimit të ligjit për të hetuar pretendimet për shkeljet zgjedhore. Janë të nevojshme rregullimet për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese.

3.7 Financimi i fushatës zgjedhore

Financimi i fushatës zgjedhore është një ndër çështjet me të debatuar në kuadër të diskutimeve për përmirësimin e legjislacionit zgjedhor dhe kuadrit ligjor që trajton çështje që kanë prerje me financimin e partive politike dhe fushatave të tyre zgjedhore. Duke ju referuar rëndësisë së këtij problemi, trajtimi i tij në këtë studim është bërë në një kapitull me vehte (Kreu i katër)

3.8 Votimi & numërimi i votave

Tendenca aktuale e procesit legjislativ është përpjekja për përdorimin përherë e më të madh të teknologjisë së informacionit. Aktualisht në Kodin zgjedhor parashikohet identifikimi biometrik i zgjedhësve, monitorimin *on line* i të gjithë procesit të votimit, vlerësimit dhe numërimit të votave, përcjellja online, në kohë reale, e rezultateve të numërimit të votave. Për procesin e votimit janë realizuar edhe dy projekte pilot. E përbashkëta e arsyeve për përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje është mosbesimi në administrimin e procesit të votimit dhe numërimit të votave nga komisionerët.

Zgjidhet legjislative për këto dy procese të rëndësishme të zgjedhjeve janë vlerësuar si zgjidhje efektive. Ato krijojnë kushte për të zhvilluar procesin e votimit dhe numërimit të votave të përafuar në mënyrë të dukshme me standardet. Ky vlerësim është deklaruar edhe prej misioneve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR²⁴.

3.9 Shqyrtimi i ankimeve

Reforma zgjedhore, 2020 i kushtoi vëmendje të veçantë problemit të të drejtës për ankim dhe shqyrtimit të ankimeve në rrugë administrative dhe gjyqësore. Sipas këtyre ndryshimeve shqyrtimi administrativ i ankesa është detyrë e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që shqyrtimi gjyqësor i tyre bëhet prej Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor që përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Trajtimi i detajuar i këtij komponenti është objekt i Kreu pestë.

KREU I KATËRT

NJOHURI MBI ASPEKTE LEGJISLATIVE TË FINANCIMIT TË FUSHATËS ELEKTORALE DHE MONITORIMIT TË SHPENZIME PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

Si u theksua me sipër, çështjeve që lidhen me financimin e fushatës zgjedhore në legjislacion shqiptar i kushtohet vëmendje e veçantë. Pothuajse në të gjithë raportet e misioneve të vëzhguesve ndërkombëtar, në opinionet e Komisionit të Venecies dhe raportet e vëzhguesve vendas, çështjet e financimit të fushatës zgjedhore trajtohen me kujdes të shtuar.

Në legjislacionin shqiptar çështjet e financimit të partive politike dhe të fushatave të tyre zgjedhore trajtohen në Ligjin “Për Partitë Politike” dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë legjislacion përcaktohen se cilat janë burimet e financimit të partive politike, çfarë kushte dhe kërkesa duhet të plotësojnë këto parti për t’ju përgjigjur detyrimit kushtetues i cili kërkon që çdo financim që përfitojnë partitë politike duhet të jetë transparent, me burim të deklaruar dhe lehtësisht të verifikueshëm dhe për mënyrën e përdorimit të tij²⁵.

²⁴ Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021: Raporti Përfundimtar

<https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Vendore, 14 maj 2023: Raporti Përfundimtar

<https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi zgjedhor dhe ligji për partitë politike ngarkojnë KQZ me detyrën për kontrollin, auditimin e financave të partive politike. Në këtë legjislacion janë të përcaktuara rregullat e auditimit, rregullat për përgatitjen e raporteve financiare, sanksione për shkeljet dhe mos deklarimin e dhuruesve, mos deklarimin e burimeve të financimit privat apo shumave të dhurimit.

Praktikat e zbatimit të këtij legjislacionit kanë evidentuar probleme që në pjesën kryesore të tyre, janë të lidhura me transparencën e burimeve të financimeve jopublike që përfitojnë partitë politike dhe vështirësinë për kontrollin dhe vlerësimin e nivelit të kësaj transparence. Shtrengimet dhe kushtëzimet ligjore që përmbahen në legjislacion, të cilat kërkojnë që partitë politike të bëjnë publikimin real të financimit privat të tyre, në para dhe natyrë, nuk kanë arritur të kenë efekte si janë pritshmërit për to.

Studime e kryera për të vlerësuar efektshmërinë e zgjidhjeve legjislative për financimin e partive politike kanë treguar se, ndër rrugët kryesore që duhet të ndiqen për të rritur nivelin e transparencës në financimin e partive politike janë ndërhyrjet dhe rregullimet e mëtejshme në legjislacion, të lidhura me:

- (i) publikimin në kohë dhe transparent të informacionit për financimet jo publike, që përfitojnë partitë politike,
- (ii) mirë rregullimin e instrumenteve që mund të përdoren për parandalimin e marrjes dhe përdorimit të fondeve private me burime të paidentifikuara,
- (iii) forcimin cilësor të kapaciteteve për mbikëqyrjen e financimeve për partitë politike dhe fushatës zgjedhore nga institucione shtetërore dhe jo shtetërore, OJF,
- (iv) rregullimin e sanksionet duke synuar targetimin e përgjegjësve reale dhe rastet kur shkeljet ligjore mund të klasifikohen në vepra penale.

4.1 Një ligj për financimin e partive politike

Ndër opsionet e propozuar nga përfaqësues të shoqërisë civile për rregullimin e ardhshëm ligjor të çështjeve që lidhen me financimin e partive politike është propozimi për hartimin e një ligji të veçantë “Për financimin e partive politike në Republikën e Shqipërisë”.

Për të rritur transparencën në financimin e partive politike, në këtë ligj propozohet që krahas detyrimit ligjor për hartimin e raporteve financiare periodike që duhet të paraqesin, partitë politike duhet të kenë edhe:

- detyrimin për rritjen e kapaciteteve për të patur një administratë efektive dhe funksionale për trajtimin e çështjeve të financimit, me shtrirje vertikale, nga qendra në bazën e partisë;
- detyrimin e partive dhe institucioneve që i mbikëqyrin financat e tyre për të publikuar raportet financiare, të shoqëruar edhe me dokumente mbështetës të cilët i shërbejnë rritjes së transparencës për fondet jopublike.

Për të parandaluar interferimin e financimeve nga qeveri të huaja, nga persona fizik dhe/ose juridik të huaj, në ligjin për financimin e partive politike duhet të përmbahen dispozita të veçanta, nëpërmjet të cilave të rregullohen, në mënyrë të qartë detyrimet për Institucionet dhe Agjencitë ligjzbatuese për Gjurmimin, Identifikimin dhe Parandalimin ose Dënimin e Shkeljeve Ligjore të kësaj natyre.

Për monitorimin, kontrollin dhe për auditimin periodik të financave të partive politike, në ligjin për financat e partive politike, duhet të parashikohet ngritja e një *Njësie të specializuar*, si pjesë e organizimit strukturor të administratës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Njësia duhet të ngarkohet edhe me detyrën për hetimin proaktiv të financave të partive politike. Njësia duhet ketë të punësuar punonjës me statusin e punonjësit publik. Për funksionimin e saj duhet të parashikohet buxhet vjetor, si pjesë e buxhetit të KQZ.

Në ligjin për financimin e partive politike duhet të parashikohet përfshirja e dispozitave për të krijuar terrenin ligjor të nevojshëm për ndjekjen, identifikimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare të partive politike nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave dhe nga institucionet e tjera, në bashkëpunim me Njësinë e Specializuar të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve .

Në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në dispozitat për vëzhguesit duhet të përfshihen përcaktime të qarta ligjore për vëzhgues të pavarur të cilët duhet të vëzhgojnë financimet e partive politike dhe fushatat e tyre zgjedhore. Në këto përcaktime duhet të theksohet niveli profesional që duhet të kenë vëzhgues të tillë dhe detyrimin që ata të jenë të çertifikuar nga KQZ-ja për kryerjen e këtij vëzhgimi.

Në dispozitat për sanksionet në ligjin për financimin e partive politike duhet të parashikohet qartë se, në çfarë rastesh sanksionet mund të jenë vetëm administrative dhe në cilat raste shkelja e ligjit përbën veprë penale. Kjo do të kërkojë që të ndërhyhet edhe në Kodin Penal të Republikës, në të cilin aktualisht nuk përmbahen dispozita të dedikuara, eksplicite, për vepra penale që lidhen me financimin e partive politike dhe fushatave të tyre zgjedhore.

Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike

4.2 Monitorimi dhe vlerësimi i transparencës së financimit të partive politike

Çdo propozim për ndryshime dhe rregullime që mund dhe duhet të bëhen në legjislacionin që trajton çështje të financimit të partive politike dhe fushatave elektorale të tyre është e domosdoshme të bëhen mbi baze të analizave dhe gjykrimeve për zgjidhjet legjislative aktuale dhe efektet e tyre në zbatim. Për ta realizuar këtë duhet që të organizohet dhe realizohet një proces kompleks për grumbullimin e informacionit të nevojshëm. Në literaturën e kohës ka të publikuara metodologji të ndryshme sipas të cilave duhet të organizohet dhe zhvillohet puna. Duke ju referuar veçorive, nevojave dhe stadi aktual të zhvillimit të procesit për mirë rregullim legjislativ të financimit të partive politike në Shqipëri, efekteve që ka zbatimi i zgjidhjeve legjislative aktuale si dhe problemeve që apriori përcaktohen si shkaqe që vështirësojnë realizimin e pritshmërive për nivelin e transparencës së burimeve të financimit të partive politike dhe përdorimin e tyre, Metodologjia që propozohet për të monitoruar, vlerësuar dhe gjykuar mbi financimin e partive politike është konceptuar si një kombinim i studimi desk study për legjislacionin aktual, të kombinuar me analizën e perceptimeve dhe vlerësimeve për cilësinë dhe efektet e zbatimit të këtij legjislacioni. Modeli konceptual, sipas të cilit propozohet të kryhet ky proces monitorimi dhe vlerësimi nga ekspertë që mund të angazhojnë OJF është paraqitur në Figurën 3.




Figura 3. Modeli konceptual për monitorimin dhe vlerësimin e transparencës në financimin e partive politike

Kjo Metodologji mund të përdoret për monitorimin dhe vlerësimin e transparencës në financimet e partive politike për fushatën zgjedhore edhe për periudha që nuk i përkasin kësaj fushate. Metodologjia shërben jo vetëm për të identifikuar çështjet dhe problemet që pas kësaj duhet të jenë objekt i ndryshimeve në legjislacion por edhe për të gjykuar në lidhje me dinamikën dhe trendin e efekteve që ka zbatimi i legjislacioni. Metodologjia i ofron aktoreve të shoqërisë civile të interesuar për t'u angazhuar për vlerësimin e transparencës në financimin e partive politike, një rrugë efektive që mundëson një gjykim objektiv për nivelin e kësaj transparence. Metodologjia mundëson realizimin e këtij procesi monitorimi si një proces që mund të shtrihet në kohë dhe jo të kufizuar vetëm për periudhën e zhvillimit të fushatës zgjedhore.

Zbatimi i kësaj Metodologjie për partitë politike shqiptare²⁶ ka evidentuar përparësitë që ajo ka dhe vlerën që kanë rezultatet e marra prej saj, si informacion që mund të përdoret për rregullimet e mëtejshme ligjore dhe

²⁶ Kume, A. (2022) About the legislation and its implementation related to transparency in the election campaigns financing during the last twenty years (2001-2021) in Albania

Hila, I. (2013) Buying influence: Money and political parties in Albania. Transparency International Albania.

https://www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

institucionale, nëpërmjet të cilëve synohet rritja e transparencës në financimin e partive politike.

Duke ju referuar Modelit konceptual të mësipërm, për monitorimin dhe vlerësimin e transparencës në financimin e partive politike, vëzhguesi/organizatat e shoqërisë civile, mund të përdorin indikatorët e paraqitur në listën në vijim.

Indikatori	Pyetje për vlerësimin e indikatorit	Po	Jo
1. Kontabiliteti i brendshëm i partive	<i>Është kontabiliteti i detyrueshëm me ligj?</i>		
	Sa professional është stafi në praktikë?		
2. Raportimi pranë agjensisë mbikqyrëse shtetërore (KQZ)	Sipas ligjit, a raportojnë partitë, donatorët, shitësit dhe media për rolin e tyre në financimin politik?		
	Kur dhe në çfarë formati?		
3. Kuptueshmëria ose qëllimi i raportimit	A përfshijnë raportet burime publike dhe private?		
	A i përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet?		
	A i përfshijnë kontributet monetare, në natyrë, zbritjet etj.?		
4. Detajimi i raportimit	Sipas ligjit, a përfshijnë raportet informacione mbi dhurimet individuale?		
	A identifikojnë qartësisht donatorët për çdo dhurim?		
5. Besueshmëria e raportimit	A i publikojnë aktorët e ndryshëm të gjitha burimet në raportim?		
	Sa të sakta janë raportet, sipas opinionit të ekspertëve?		
6. Publikimi	A është e detyrueshme për agjensitë shtetërore/ partitë publikimi i informacioneve mbi financat politike?		
	Në praktikë, sa i aksesueshëm është ky informacion për ekspertët, gazetarët dhe qytetarët e zakonshëm?		
7. Masat parandaluese	A kryhen dhurimet vetëm përmes llogarisë zyrtare bankare të partive?		
	A ekzistojnë boshllëqe ligjore për dhurimet anonime?		
8. Sanksionet	Çfarë parashikojnë sanksionet ekzistuese – civile, kriminale dhe politike – sipas ligjit?		
	Në praktikë, a janë ligjet ekzistuese të implementuara rigorozisht?		
9. Mbikqyrja shtetërore (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve)	A i vlerësojnë ekspertët institucionet e mbikqyrjes shtetërore si të pavarura?		
	A konsiderohen ato eficiente?		
	Nga perspektiva e vetë-vlerësimit, a u mungojnë atyre burimet njerëzore?		
	Kanë nevojë për trajnime?		
10. Mbikqyrja publike	A ekzistojnë organizata të shoqërisë civile që monitorojnë financimet politike?		
	Në cilat fusha të financimeve politike e zhvillojnë aktivitetin e tyre?		
	A i vlerësojnë ekspertët organizatat monitoruese si të pavarura?		

KREU I PESTË

ZGJIDHJET LEGJISLATIVE PËR TRAJTIMIN E MOSMARRËVESHJEVE PËR ÇËSHTJE ZGJEDHORE

5.1 Transparenca në procedurat zgjedhore administrative dhe gjyqësore

Transparenca është një element thelbësor në veprimtarinë e organeve administrative dhe gjyqësore në kuadër të realizimit të të drejtave zgjedhore, mbrojtjes së tyre, bashkëpunimit me organet publike dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në proceset që lidhen me to. Aspektet procedurale që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor duhet të trajtohen me transparencë dhe subjekteve të Kodit Zgjedhor do duhet t'u ofrohen garanci që lidhen me përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore apo zhvillimin e referendumeve.

Nga analiza ligjore e Kodit Zgjedhor rezulton se dispozitat që lidhen me transparencën e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore nga organet e krijuara sipas këtij ligji janë të pakta. Në nenet 12 dhe 146 të KZ rregullohet mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së organeve në përbërjen e KQZ dhe të Kolegjit Zgjedhor dhe për çështje të tjera ligjvënësi ka referuar te rregullimet e parashikuara në akte normative²⁷ dhe në normat e përgjithshme të KPA²⁸, i cili zbatohet si *lex generalis* dhe në zbatim të cilit rezulton se:

Së pari, organet e krijuara sipas KZ janë të detyruara të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të këtë procedurë^{29,30}.

Së dyti, palëve të përfshira në procese zgjedhore duhet t'u garantohen të drejtat në mënyrë publike dhe në përputhje me parimin e barazisë³⁰.

Së treti, transparenca nuk do duhet të jetë vetëm e kufizuar në përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej legjislacionit për të drejtën e informimit. Informacioni duhet të jetë lehtësisht dhe drejtpërdrejt i aksesueshëm nga të gjitha palët që preken nga veprimet administrative dhe zbatimi i tyre, dhe nga ana tjetër duhet t'i mundësojë organit publik realizimin e takimeve apo konsultimeve me qëllim mbledhjen e sa më shumë të dhënave për të disponuar një vendim sa më të drejtë në procesin administrativ³¹.

Transparenca gjyqësore realizohet nëpërmjet njohjes të të drejtës së ankimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për rastet e parashikuara shprehimisht në KZ. Ajo është e lidhur me karakterin publik të procesit gjyqësor^{32,33}, publikimin e vendimeve gjyqësore, rregullat e njoftimit të akteve^{33,34}, thirrjen e palëve^{34,35}, njoftimin e vendimit³⁵, shortimin e çështjes^{36,37} dhe elementë të tjerë të cilët lidhen ngushtësisht me të drejtat procedurale të palëve në proces.

²⁷ Vendimi nr. 3, datë 06.11.2020, ora 10:00 për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” i Komisionit Rregullator dhe vendimi nr. 1, datë 26.10.2020, ora 11:00 për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator” i Komisionit Rregullator.

²⁸ Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 189, datë 29.12.2008, neni 12, pika 7.

²⁹ Ligji nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28.05.2015, neni 5.

³⁰ Neni 127, pika 1 KPA.

³¹ Çifligu, G. Kalavace, B. “Manual praktik mbi zbatimin e Kodit të Procedurave Administrative”, 2021, aksesuar në linkun <https://www.dap.gov.al/images/udhezimemanuale/Manual%20Pratik%20mbi%20Zbatimin%20e%20Kodit%20t%C3%AB%20Procedurave%20Administrative.pdf>, faqja 21.

³² Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 12.05.1996, neni 26.

³³ Neni 30 KPC.

³⁴ Neni 129 e në vijim KPC.

³⁵ Neni 316 KPC.

³⁶ Ligji nr. 98-2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 209, datë 07.11.2016, neni 25.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Përqindje
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për marrjen e informacionit publik në lidhje me ankesat dhe vendimet e marra?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për qartësinë, publikimin dhe kuptueshmërinë e procedurave të ankimit?	
Në cilën masë janë palët të kënaqura me cilësinë e vendim marrjes së KQZ?	
Në cilën masë janë palët të kënaqura me cilësinë e vendim marrjes së Kolegjit Zgjedhor?	
Cili është niveli i kënaqësisë së përdoruesve për portalin e denoncimeve?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për marrjen e informacionit publik në lidhje me transparencën e procedurave të regjistrimit të subjekteve zgjedhore?	
Cili është niveli i kënaqësisë së avokatëve/gazetarëve për krijimin e aksesit nga KQZ të informacionit për mosmarrëveshjet zgjedhore?	
Cili është niveli i kënaqësisë së avokatëve/gazetarëve për krijimin e aksesit nga gjykata të informacionit për mosmarrëveshjet zgjedhore?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për raportimin e KQZ në mënyrë të rregullt mbi numrin dhe statusin e ankesave të trajtuara?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për kuptueshmërinë e raportimeve mbi numrin dhe llojet e ankesave?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për raportimet e Komisionerit për vendimet e tij dhe procedurën e ndjekur?	
Cili është niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara për reflektimin nga KQZ në veprimtarinë e saj të rekomandimeve të paraqitura nga OJF të bazuara në raporte monitorimi?	

5.2 E drejta e ankimit administrativ ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore

Në parim, çdo shkelje e legjislacionit zgjedhor, qoftë nëpërmjet veprimit apo mosveprimit si dhe prania e ligjeve që çenojnë të drejtat për zgjedhje të lira dhe të ndershme, votimin dhe kandidaturat, duhet të përbëjë bazën për paraqitjen e ankesave. Mosmarrëveshjet zgjedhore mund të lindin në çdo fazë të ciklit zgjedhor³⁷.

Palët e përfshira në një proces zgjedhor janë të rrezikuara në mënyrë të vazhdueshme përsa i përket realizimit të drejtave të tyre të cilat mund të çenohen ose të mos përmbushen si rrjedhojë e veprimtarisë administrative të organeve të krijuara në kuadër të KZ.

Parashikimi i procedurave të ankimit administrativ dhe gjyqësor është një fazë procedurale e rëndësishme për subjektet në kërkimin ose rivendosjen e të drejtave. Palët mund t'i kryejnë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, por pavarësisht këtij parashikimi, organit administrativ i është rezervuar e drejta për të kërkuar kryerjen e një ose disa veprimeve procedurale drejtpërdrejt nga pala, në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji³⁸.

Për të proceduar me ankim administrativ është e rëndësishme që palët të kenë legjitimitet, pra zotësi për të vepruar në procedurën administrative³⁹ dhe kjo konkludohet nga neni 33 e vijues i KPA. Fillimi i procedurës administrative shënon vendosjen e një marrëdhënieje midis organit publik dhe personit fizik ose juridik, i cili fiton statusin ligjor të palës siç përcaktohet në nenin 33 të KPA. Që nga ky moment secila palë ka të drejta dhe detyrime procedurale të

³⁷ Council of Europe “Electoral dispute resolution- Toolkit for strengthening electoral jurisprudence”, aksesuar në linkun <https://rm.coe.int/electoral-dispute-resolution/16809f0007>, 2020, fq. 12.

³⁸ Neni 35 KPA.

³⁹ Neni 34 KPC.

parashikuara në KPA ose në ligje të tjera të posaçme përfshirë të drejtën e palës për t'u njohur me dosjen⁴⁰, e drejta për të paraqitur shpjegime dhe mendime⁴¹, asistimi i palës me ndihmë aktive nga organi në kuadër të procedurës⁴² etj.

a. Subjektet ankimese

E drejta e ankimit ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore i është njohur subjekteve të parashikuara nga neni 124 dhe 124/1 i KZ si mëposhtë:

- Çdo parti politike pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ që çenojnë interesat e tyre të ligjshme⁴³,
- Çdo parti politike pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj të marr sipas nenit 122 të KZ⁴⁴,
- Çdo parti politike pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore sipas nenit 123 të KZ⁴⁵;
- Individët ose partitë politike të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrimin si subjekt zgjedhor⁴⁶;
- Organizatat jofitimprurëse shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve në rastin kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ⁴⁷,
- Organizatat jofitimprurëse shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin e vëzhguesve⁴⁸;
- Palët që provojnë interes të ligjshëm për çështjen objekt ankimi mund të bëjnë ankim kundër akteve të Komisionerit në KAS.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
KQZ ofron akses të lirë dhe të lehtë në informacionin mbi proceset zgjedhore dhe ankesat e lidhura me to?		
Qytetarët dhe palët e interesuara mund të marrin informacion publik në lidhje me ankesat dhe vendimet e marra?		
Subjektet e interesuara janë të informuara për të drejtën për të paraqitur ankim dhe procedurat e nevojshme që duhet të ndiqen?		
KQZ ishte bashkëpunuese me OJF të angazhuar në monitorimin e zgjedhjeve?		
A ka patur raste kur Komisioneri ka qenë organi përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve administrative kur kjo kompetencë nuk i ishte njohur shprehimisht KAS ose Rregullatorit?		
A kanë krijuar ndryshimet e vazhdueshme të KZ paqartësi në lidhje me organin ku duhet të drejtohen ankimet?		
A ka qenë vendimmarrja e Komisionerit më e shpejtë se ajo e një organi koleg-jial?		
A ka patur rrezik më të lartë të paragjykitimit kur vendimet janë marrë nga një organ monokratik?		
A ka raste kur ka KAS ka vlerësuar performancën e komisionerëve dhe numëruesve?		

⁴⁰ Neni 46 KPA.

⁴¹ Neni 47 KPA

⁴² Neni 10 KPA.

⁴³ Neni 124, pika 1 KZ.

⁴⁴ Neni 124, pika 2 KZ.

⁴⁵ Neni 124, pika 3 KZ.

⁴⁶ Neni 124, pika 5 KZ.

⁴⁷ Neni 124, pika 5 KZ.

⁴⁸ Neni 124/1, paragrafi 1 KZ.

b. Organet e ngarkuara me shqyrtimin e ankimit administrativ

KZ në pjesën e dhjetë të tij, nenet 124 e në vijim ka parashikuar organet e ngarkuara me kompetencën e shqyrtimit të ankimit administrativ dhe në analizë të këtyre dispozitave rezulton se:

- KQZ është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve dhe pretendimeve të subjekteve të legjitimuara për paraqitjen e ankimit administrativ⁴⁹.
- KAS-i si njësi përbërëse e organeve drejtuese të KQZ është kompetent në lidhje me çështjet e regjistrimit ose mos regjistrimit të vëzhguesve⁵⁰, ankesat ndaj akteve të Komisionerit⁵¹, ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ⁵².
- KAS shqyrton ankimin kundër vendimit të KQZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas nenit 123 të KZ⁵³;
- Kundër vendimit të KQZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ⁵⁴.

Rezulton se ndryshimet e vazhdueshme që i janë bërë KZ krijojnë paqartësi në lidhje me organin ku duhet të drejtohen ankimet administrative.

Konflikti në interpretimin e normave lind për faktin se KZ referon në dispozitat e ankimit administrativ si organin kompetent për shqyrtimin e tyre KQZ, ndërkohë që KQZ nuk funksionon si një unitet i vetëm, por është e ndarë në organe të tjera. *Cili prej organeve ngarkohet me detyrën e shqyrtimit të ankimit administrativ?* Për të konkluduar mbi kompetencën lëndore të organeve që shqyrtojnë ankimeve administrative duhet të bazohemi në interpretimin sistematik të normave dhe në parimin e *“lex posterior derogat legi priori”*.

Interpretimi sistematik ka të bëjë me caktimin e domethënies së drejtë të normës juridike me anë të lidhjes së normës me të gjitha normat të cilat si tërësi përbëjnë sistemin juridik. Bazë e interpretimit sistematik është fakti se çdo normë juridike është pjesë e një tërësie më të madhe normash me të cilën është e lidhur ngushtë⁵⁵.

Strukturat pjesë përbërëse të KQZ rezulton të jenë Komisioneri, Rregullatori dhe KAS⁵⁶. Kjo përbërje është risi dhe buron prej ndryshimeve ligjore të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 101/2020, datë 23.07.2020. Përpara ndryshimeve të sipërcituara ligjore, KQZ ka funksionuar si një strukturë e vetme e pandarë në organe të tjera drejtuese. Në kushtet kur vendimmarrja nuk ushtrohet bashkërisht me strukturat përbërëse të KQZ, lind nevoja e interpretimit dhe përcaktimit të organeve përgjegjëse për ankimin administrativ. Kompetencat janë të parashikuara në dispozita përkatëse të KZ dhe në interpretim të referencës në organin e KQZ është e nevojshme që të identifikohet kompetenca ligjore të përcaktuara në dispozitat përkatëse.

Referuara kompetencave të parashikuara në KZ për Komisionerin, ai ushtron kryesisht funksione me karakter ekzekutiv, administrativ dhe përfaqësimi të organit te palët e treta dhe përjashtimisht i delegohet detyra e ushtrimit në emër të KQZ të kompetencave që i ngarkohen me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS⁵⁷.

Referuar kësaj dispozite kur parashikohet shqyrtimi i ankimit administrativ nga KQZ dhe kjo kompetencë nuk i është njohur shprehimisht KAS apo Rregullatorit, organi përgjegjës për shqyrtim e tij është Komisioneri, si një organ monokratik.

Përqëndrimi i vendimeve të rëndësishme në një organ monokratik mund të trajtohet në këndvështrime të ndryshme me pasojë efektsh pozitve ose negative sipas rastit. Efektet pozitive të marrjes së vendimeve nga organi monokratik janë:

- **Vendimi mund të merret më shpejtë në krahasim me proceset e shqyrtimit në grup.** Nuk ka nevojë të

⁴⁹ Neni 124 KZ.

⁵⁰ Neni 124/1 KZ.

⁵¹ Neni 21, pika 1, gërma b KZ.

⁵² Neni 21, pika 1, gërma c KZ.

⁵³ Neni 123, pika 4 KZ.

⁵⁴ Neni 124, pika 3 KZ.

⁵⁵ Vokshi, A. Tafaj, F. "Procedurë Civile – pjesa I", Botimi 2, 2018, fq. 39.

⁵⁶ Neni 12, pika 2 KZ.

⁵⁷ Neni 19 KZ.

arrihet për konsensus, të realizohen votime apo debat ndërmjet disa individëve.

- Ka qartësi se cili subjekt është përgjegjës për rezultatet. Kjo mund të thjeshtojë komunikimin dhe ekzekutimin.
- Një subjekt i vetëm mund të përshtatet më shpejtë në kohë me rrethana të caktuar në ndryshim, pa pasur nevojë për diskutime ose negociata të gjata.

Ndërkohë, si pjesë të efekteve negative theksojmë:

- Një organ monokratik mund të ketë një rrezik më të lartë të paragjykitimit të situatës dhe kushteve të saj, pasi nuk ka shumëllojshmëri këndvështrimesh, kontrollësh dhe ekuilibrash për të arsyetuar në dimensione të ndryshme çështjet komplekse që i janë ngarkuar nga KZ;
- Vështirësi të rëndësishme ose këndvështrime alternative mund të anashkalohen duke çuar në rezultate jo optimale.
- Ekziston rreziku që vendimet të merren në mënyrë arbitrare ose për përfitime personale, pa vendosur mekanizma efektivë të llogaridhënies.
- Rrezikshmëria e influencës për të marrë një vendim të caktuar ose për të vepruar në favor të një subjekti të caktuar është më aktuale dhe fuqishme nëse ushtrohet ndaj një personi të vetëm, ndërkohë që nëse bëhet fjalë për organe kolegjiale shumica e votave për të disponuar me vendim mund të jetë më e vështirë për t'u realizuar nëpërmjet mekanizmave të ndikimit të jashtëm.
- Pa kontributin dhe mbështetjen e një grupi më të gjerë, vendimet e marra nga një individ i vetëm mund të përballen me më shumë rezistencë nga ata që preken nga vendimet, duke çuar në sfida zbatimi.

Si konkluzion, gjetja e ekuilibrit të duhur midis marrjes së vendimit në mënyrë të centralizuar dhe përfshirjes së perspektivave të ndryshme, është thelbësore për konkluzione më profesionale, më objektive dhe më të besueshme kundrejt personave të tretë, por referuar të drejtave që lidhen me procesin zgjedhor jemi të mendimit se fuqizimi i pushtetit në një organ monokratik për procedura të rëndësishme zgjedhore është një zgjedhje jo e drejtë e bërë nga ana e legjislatorit.

Referuar praktikës së GjEDNj për çështje të cilat lidhen me nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës, në çështjen Podkolzina kundër Letonisë⁵⁸, Gjykata ka rikujtuar se e drejta për t'u paraqitur si kandidat në zgjedhje, e garantuar nga neni 3 i Protokollit nr. 1 dhe e lidhur ngushtë me nocionin e një regjimi demokratik, nuk do të ishte veçse e rremë nëse do t'i mohohet të interesuarit kudoherë e në mënyrë arbitrare. Për pasojë, sado që është e vërtetë se shteteve u libet një hapësirë e madhe vlerësimi për të vendosur kushte zgjedhshmërie in abstracto, parimi i efektivitetit të së drejtave kërkon që vendimet të cilat konstatojnë mosrespektimin e këtyre kushteve në rastin e një kandidati të përputhen me një numër kriteresh që e mundësojnë shmangien e arbitraritetit. Në veçanti, këto vendime duhet të merren nga një organ që paraqet njëfarë minimumi garancish asnjësisë. Po ashtu, fuqia autonome e këtij organi për të bërë vlerësime nuk duhet të jetë e tepruar; ajo duhet të jetë, në një nivel të mjaftueshëm përpikërie, e kufizuar nga dispozitat e së drejtës së brendshme. Së fundi, procedura për shpalljen e pazgjedhshmërisë së një kandidati duhet të garantojë një vendim të paanshëm e objektiv, si edhe të shmangë çdo shpërdorim pushteti nga ana e autoritetit kompetent.

KAS është një organ kolegjial të cilit i është njohur e drejta për të disponuar këto vendime⁵⁹:

- Vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve;
- Shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit;
- Shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ;
- Vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve për çështjet që shqyrton;
- Me kërkesë të Komisionerit, vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim;
- Me kërkesë të Komisionerit, vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

⁵⁸ Podkolzina vs. Latvia, aplikimi nr. 46726/99, 2002, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

⁵⁹ Neni 21 KZ.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Legjislacioni lidhur me organet e ngarkuara me shqyrtimin e ankimit administrativ është i qartë dhe i kuptueshëm?		
Legjislacioni parashikon të drejtën e ankimit?		
Procedurat e ankimit administrativ janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për palët e interesuara ?		
Parashikohen procedura për adresimin e konfliktit të interesit në KAS?		

c. Afatet procedurale që lidhen me ankimin administrativ dhe llogaritja e tyre

Afatet procedurale në kontekstin e ankimit administrativ sipas KZ janë kryesisht afate të shkurtra, të llogaritura në ditë dhe në orë. Kjo buron nga nevoja e shqyrtimit të pretendimeve në një kohë të shpejtë dhe marrjes së një vendimi përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që për shkak të natyrës së posacme të mosmarrëveshjes, vendimi të jetë efektiv për realizimin e të drejtave të palëve.

Kundërshtimi i vendimeve të organeve zgjedhore ka afate ankimi të caktuara në ditë, kryesisht tre⁶⁰ dhe pesë⁶¹ ditore nga data e shpalljes së vendimeve.

Ushtrimi i të drejtave zgjedhore varet nga zbatimi i afateve procedurale, mosrespektimi i të cilave të pengojë vetë ushtrimin e këtyre të drejtave. Pasiguria afatgjatë në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve mund të dëmtojë besimin në sistemin zgjedhor dhe institucionet politike. Si rezultat, standardet ndërkombëtare rekomandojnë afate të shkurtra kohore për paraqitjen dhe vendosjen e ankesave. Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias rekomandon afate kohore nga tre deri në pesë ditë, përkatësisht për paraqitjen dhe për marrjen e vendimeve mbi ankesat. Megjithatë, afatet kohore për marrjen e vendimeve mbi ankesat, në veçanti çështjet komplekse si rezultat i zgjedhjeve, nuk duhet të jenë aq të shkurtra sa t'i mohojnë në mënyrë efektive kërkesit një shqyrtim të plotë të pretendimeve të tij⁶².

Kur afatet llogariten në orë dhe në ditë rezultojnë të jetë ruajtur i njëjti standard me KPC⁶³ dhe KPA⁶⁴, ku përjashtohet nga llogaritja ora dhe data në të cilën është disponuar vendimi. Për afatet të cilat llogariten në orë organi administrativ është i detyruar që të shënojë dhe orën e shpalljes së aktit, në të kundërt afati do të llogaritet duke filluar nga ora 8⁰⁰ në ditën pasardhëse⁶⁵.

Në rast se plotësimi i afateve bie jashtë orarit zyrtar të punës, të përcaktuar në vendimin e KQZ, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse. Në rast se nga KQZ nuk është përcaktuar ndryshe me vendim, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰ dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel⁶⁶. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.

Karakteristikë e llogaritjes së afateve sipas pjesës dhjetë të KZ është se nuk mund të ketë rivendosje në afat për ankimin administrativ. Parashikimi i tillë i ligjvënësit pavarësisht se në lidhje me të drejtat procedurale të palëve mund të jetë kushtëzues, rezultojnë të jetë në përputhje me KPA, i cili parashikon institutin e rivendosjes në afat si të drejtën e çdo pale për ta kërkuar, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv ose kur ndalohet shprehimisht me ligj^{67,68}.

Aspekt tjetër i rëndësishëm është afati për kryerjen e veprimeve hetimore administrative, i cili është i papërcaktuar në ligj apo me anë të akteve të brendshme institucionale dhe përcaktohet rast pas rasti nga KQZ në konsultim me palët⁶⁸. Referuar kësaj dispozite kompetencën për të vendosur afatin e shqyrtimit administrativ e ka organi që shqyrton ankimin administrative, i cili rrjedhimisht mund të jetë KAS ose Komisioneri duke qënë se Rregullatori ka kompetencë të fokusuar në nxjerrjen e akteve normative^{69,70}.

⁶⁰ Nenet 124 pika 1, 124/1 pika 1 dhe 2.

⁶¹ Nenet 124 pika 2 dhe pika 3.

⁶² Council of Europe "Electoral dispute resolution- Toolkit for strengthening electoral jurisprudence", aksesuar në linkun <https://rm.coe.int/electoral-dispute-resolution/16809f0007>, 2020, fq. 12.

⁶³ Neni 148 KPC.

⁶⁴ Neni 56 KPA.

⁶⁵ Neni 125, pika 1 dhe 2 KZ.

⁶⁶ Neni 125, pikat 3, 4 dhe 6 KZ.

⁶⁷ Neni 54, pika 1 KPA.

⁶⁸ Neni 134, pika 3 KZ.

⁶⁹ Neni 20 KZ.

Ky parashikim përbën një kompetencë të rëndësishme të përqëndruar në pushtetin e organit kompetent dhe që mund të përmbajë aspekte cënuese në disa këndvështrime:

Së pari, rezulton në mënyrë të qartë se qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e afateve të shkurtra procedurale ligjore për paraqitjen e ankimeve ka qënë i lidhur me marrjen e një vendimi të shpejtë mbi aktet e kundërshtuara me rëndësi për procesin zgjedhor, të drejtat e palëve të përfshira dhe rezultatin e pritshëm për publikun.

Së dyti, kundërshtimi administrativ i një vendimi sipas parashikimeve të KZ kërkon angazhimin e palës për paraqitjen dhe hartimin e një ankimi cilësor dhe në përputhje me normat ligjore. Afati i lënë në dispozicion të palës është tepër i shkurtër, ndërkohë që për organin shqyrtues ky afat mund të përcaktohet sipas nevojave të tij për hetimin administrativ të çështjes. Nga ana tjetër, ndërkohë që neni 134 pika 3 i KZ përcakton se afatet maksimale për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KQZ-ja në konsultim me palët, nëpërmjet interpretimit sistematik të kësaj dispozite me nenet 131 dhe 143 pika 3 të KZ, rezulton që organi i cili shqyrton ankimin është i detyruar të përfundojë procedurën hetimore dhe të shpallë vendimin brenda afateve të mirë përcaktuara në ligj. Pavarësisht se ligji ka përcaktuar afate maksimale për shpalljen e vendimit përfundimtar, është e nevojshme që të parashikohen afate maksimale edhe për kryerjen e veprimeve hetimore administrative, në mënyrë që të garantohet marrja e provave dhe të mos vendoset në rrezik ose bëhet e pamundur marrja e tyre.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Legjislacioni parashikon afate të shkurtra për shqyrtimin administrativ dhe gjyqësor të mosmarrëveshjeve?		
Legjislacioni parashikon mekanizma për të përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit të marrjes së vendimeve?		
Afatet e ankimeve janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për publikun?		
Legjislacioni parashikon afate maksimale për shpalljen e vendimit përfundimtar?		
Legjislacioni parashikon afate maksimale për kryerjen e veprimeve hetimore?		
Shqyrtimi i ankimit administrativ u zhvillua brenda afateve?		
KQZ njoftoi publikisht datën dhe orën e shqyrtimit të ankimit administrativ?		

d. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ

Legjislacioni zgjedhor parashikon të drejtën e shqyrtimit administrativ dhe zgjidhjes së çështjes në themel në një seancë të vetme, të pandërprerë me përjashtim të rastit kur është e nevojshme marrja e provave tek të tretët⁷⁰. Pavarësisht këtij parashikimi dhe mundësisë së marrjes së një vendimi të shpejtë, KZ parashikon disa procedura formale të cilat duhet të ndiqen në shqyrtimin e çështjes në themel.

Së pari, kërkesa ankimore do duhet të jetë në përputhje me kërkesat formale të ligjit dhe të përmbajë elemente të tillë si; emrin e ankuesit dhe adresën, vendimin që ankimohet, përshkrim të shkëlqes, fakteve dhe bazës ligjore, provat që kërkohen të mbahen në shqyrtim, datën dhe nënshkrimin e palës⁷¹. Mosplotësimi i elementëve formal mund të sjellë si pasojë kthimin e ankimit, në rast mosplotësimit të të metave⁷². Afati ligjor i vendosur në dispozicion të palës për plotësimin e të metave është 24 orë dhe kërkesa kthehet për plotësim të metash vetëm një herë⁷³.

Së dyti, kërkesa ankimore depozitohet në selinë e KQZ dhe regjistrohet në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore. KQZ-ja nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e kërkesave ankimore të subjekteve⁷⁴.

Së treti, KQZ (organi kompetent që shqyrton kërkesën ankimore) duhet të përcaktojë datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike. Vendimi afshohet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij, ndërkohë që seanca e shqyrtimit sipas nenit 134 të KZ zhvillohet jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit⁷⁵.

Duke qënë se pika e mësipërme referon shqyrtimin administrativ është e rëndësishme të marrim në konsideratë interpretimin e nenit 134 të KZ i cili rregullon formalisht këtë procedurë. Në praktikë zbatimi i kësaj dispozite është i pamundur pasi:

⁷⁰ Neni 135, pika 6 KZ.

⁷¹ Neni 126 KZ.

⁷² Neni 129, pika 3, gërma c KZ.

⁷³ Neni 129, pika 4 KZ.

⁷⁴ Neni 127 KZ.

⁷⁵ Neni 131 KZ.

▪ Nocioni i “Kryetarit të KQZ” nuk është më i aplikueshëm sipas ndryshimeve që ligji nr. 101/2020, i cili riorganizoi organet drejtuese të KQZ në Komisioneri, Rregullatori dhe KAS⁷⁶⁸²;

▪ Proçedura e shqyrtimit të ankimeve administrative dhe kërkesave të Komisionerit është e rregulluar me një akt të veçantë i cili detajon si elementët formal të kërkesës, por dhe ato proçedurale të marrjes vendimit nga KAS si organ kolegjal⁷⁷. Ky akt është i një rëndësie të veçantë duke qënë se pasqyron dispozitat e KZ të implementuara me ndryshimet përkatëse ashtu si do duhet të ishin pasqyruar në Kod.

Së katërti, çelja, shqyrtimi i ankimit dhe zgjidhja e çështjes në themel si rregull duhet të bëhet në një seancë të vetme të pandërprerë me përjashtim të rastit kur palët shprehin nevojën për marrjen e provave. Seanca do të zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së palëve⁷⁸.

Së pesti, për provueshmërinë e pretendimeve të paraqitura në ankim dhe llojit të provave që do të administrohen, zbatohen rregullat e parashikuara nga KPC⁷⁹. Pala ka detyrimin që të provojë bazueshmërinë e themelit të kërtimeve ose prapësimeve. Në respektim të parimit të disponibilitetit të provës, janë pikërisht palët në proces atyre të cilave u bie barra e provës për të parashtruar faktet e dobishme të rëndësishme, të domosdoshme, për mosmarrëveshjen, mbi të cilat ato mbështesin kërkimet dhe pretendimet e tyre. Kjo barrë proçedurale që i është vendosur palëve përcakton dhe kufirin që kanë organet administrative dhe gjyqësore, të cilat duhet të vendosin në themel të vendimit të tyre provat e paraqitura nga palët. Palëve u njihet e drejta që nëse kanë pamundësi në paraqitjen e provave, të kërkojnë marrjen e tyre prej organit që shqyrton ankimin duke i vërtetuar këtij të fundit pamundësinë për sigurimin e provës dhe se ajo është e rëndësishme për të provuar pretendimet e tyre⁸⁰.

Së gjashti, koncepti i palës së përfshirë në proces është një tjetër problematikë e KZ. Referuar nenit 133 të Kodit Zgjedhor, palët e përfshira në një procedurë administrative janë ankuesi dhe pala e interesuar. Kjo e fundit për të marrë pjesë në shqyrtimin administrativ do duhet që të depozitojë kërkesë për përfshirjen në procedurën e shqyrtimit administrativ dhe pranimi i saj është në kompetencën e KQZ dhe realizohet në formën e një vendimi. Në këtë mënyrë, pala e interesuar ka detyrimin:

- Të vendoset në dijeni për ankimet e mundshme ndaj saj;
- Të kryejë një analizë të rrethanave të faktit dhe legjislacionit të zbatueshëm;

Të hartojë dhe depozitojë kërkesën për përfshirjen e saj në shqyrtimin administrativ. Jemi të mendimit se pala e interesuar duhet të thirret në proces në mënyrë të detyrueshme dhe përfshirja e saj nuk do duhet të ishte objekt vullnetit të organit që shqyrton mosmarrëveshje, sepse mund të sillte si pasojë cënimin e parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, në bazë të cilave palës që mund t’i cënohen të drejtat nga një vendim duhet t’i garantohet mundësia që të ketë kohë, mundësi dhe mjete të barabarta e të mjaftueshme për ta paraqitur rastin dhe pretendimet e saj para një organi të pavarur⁸¹. Gjykata Kushtetues, në jurisprudencën e saj, e ka shtrirë detyrimin për respektimin e të drejtës për një proces të rregullt sa në proceset gjyqësore aq edhe administrative⁸². Gjykata Kushtetuese ka parasysh edhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ⁸³,

Në analogji me procedurat gjyqësore, do të ishte e pakuptimtë që legjislacioni të përshkruante me detaje garancitë proçedurale që u ofrohen palëve në proces dhe të mos mbronte në radhë të parë atë që bën në të vërtetë të mundur që të përfitohet nga këto garanci dhe që është pjesëmarrja në proces. Kushtetuta dhe legjislacioni proçedural kanë përcaktuar standarde të qarta për pjesëmarrjen dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor⁸⁴.

Një qëndrim të tillë ka mbajtur dhe Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i cili me vendimin nr. 7, datë 05.04.2023 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të KAS për arsye se pala që është ngarkuar me detyrimin administrativ të llojit

⁷⁶ Neni 12, pika 2 KZ.

⁷⁷ Vendimi nr. 3, datë 6.11.2020, ora 10:00 për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” i Komisionit Rregullator.

⁷⁸ Neni 135, pika 4 KZ.

⁷⁹ Neni 136, pika 1, gërma b KZ.

⁸⁰ Neni 136, pika 1, gërma c KZ.

⁸¹ Mioski, B. Avramovski, D. Petrovska, N. “Analizë e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019”, 2019, aksesuar në linkun <https://www.osce.org/files/f/documents/0/9/457006.pdf>, fq. 19.

⁸² Vendim nr. 7 datë 27.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

⁸³ Vendim nr.76, datë 25.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

⁸⁴ Vendimi nr.17, datë 18.07.2005 i Gjykatës Kushtetuese..

gjobë nuk ka qënë palë e thirrur në proces, nuk është dëgjuar dhe nuk ka paraqitur mbrojtjen e saj përpara këtij organi. Sipas Kolegjit Zgjedhor, KAS ka shkelur detyrimet e tij për të njoftuar palën ndaj të cilës është marrë vendimi administrativ, nuk e ka njohur me procedurën dhe nuk e ka dëgjuar⁸⁵.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Legjislacioni garanton të drejtën për tu mbrojtur nëpërmjet pjesëmarrjes në procedimin administrativ?		
Pala e interesuar u përfshi dhe njoftua në procedurën e shqyrtimit administrativ të ankesës?		
KQZ afishoi në shpallje publike datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike?		
Janë organizuar seanca publike për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me ankimet zgjedhore?		
Palës iu caktua afat për plotësimin e të metave të kërkesës?		

Vendimi i organit që shqyrton ankimin

Vendimi i organit që shqyrton ankimin është e kufizuar në pesë mundësi ligjore për të vendosur mbi ankimin pavarësisht se çfarë ka kërkuar ankuesi në kërkimin e tij⁸⁶:

- Pushimin e shqyrtimit;
- Lënien në fuqi të vendimeve të KZAZ;
- Ndryshimin e vendimit të KZAZ;
- Shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore;
- Lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve.

Duke mbajtur në konsideratë që aktualisht KQZ i ushtron funksionet e saj sipas ndarjes në organe drejtuese me të drejta për të marrë vendime, në vijim paraqiten vendimet që mund të disponojë secili prej tyre.

Vendimet që mund të merren nga KAS janë⁸⁷:

- Lënia në fuqi e vendimit të KZAZ / Komisionerit;
- Ndryshimi i vendimit të KZAZ / Komisionerit;
- Lënia në fuqi ose ndryshimi i vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve, sipas nenit 122 ose nenit 123, të KZ.
- Pushimi i shqyrtimit;
- Shpallja e zgjedhjeve të pavlefshme në një, ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore;

Në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve KAS merr vendim përfundimtar jo më vonë se dhjetë ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër vendimet merren jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit⁸⁸.

Në lidhje me vendimin për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve, standardet ndërkombëtare kërkojnë që organi i cili administron ankesat të ketë autoritet mbi çështje të tilla si e drejta e votës, vlefshmëria e kandidaturave, respektimi i duhur i rregullave të fushatës zgjedhore dhe rezultati i zgjedhjeve. Për të garantuar integritetin zgjedhor, ligji zgjedhor duhet të fuqizojë ankimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe organet zgjedhore për të anuluar zgjedhjet, pjesërisht ose plotësisht. Megjithatë, anulimi i zgjedhjeve është një vendim që duhet marrë vetëm për shkelje të rënda që kërcënojnë vetë objektivin e zgjedhjeve: një rezultat që shpreh zgjedhjen e lirë të popullit. Kriteri kryesor për anulimin e zgjedhjeve është nëse parregullsitë, qofshin ato shkelje aktive apo mosveprime, mund të kenë ndikuar në rezultatin zgjedhor⁸⁹⁹⁰.

⁸⁵ Vendimi nr. 7, datë 5.04.2023 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

⁸⁶ Neni 143, pika 1 dhe 2 KZ.

⁸⁷ Vendimi nr. 3, datë 06.11.2020, ora 10:00 për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” i Komisionit Rregullator, neni 30, pika 1 dhe 2.

⁸⁸ Neni 143, pika 3 KZ.

⁸⁹ Council of Europe “Electoral dispute resolution- Toolkit for strengthening electoral jurisprudence”, aksesuar në linkun <https://rm.coe>.

Nga ana tjetër, llojet e vendimeve të cilat merren nga Komisioneri nuk janë parashikuar shprehimisht në akte ligjore dhe nënligjore dhe jemi të mendimit që kjo është një zgjedhje e ligjvënësist në kushtet kur kompetencat e këtij organi nuk janë të kufizuar, por ka hapësirë të gjerë veprimi. Disa prej vendimeve të Komisionerit janë:

- Vendos për shqyrtimin administrativ të denoncimeve dhe i propozon KAS-it marrjen e masave administrative ndaj palëve që kanë kryer shkelje⁹⁰;
- Vendos pushimin e hetimit administrativ⁹¹;
- Vendos për akreditimin e vëzhguesve⁹²;
- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore⁹³;

Përsa i përket aspektit formal të përmbajtjes së vendimit, ai do duhet të pasqyrojë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ, kërkimet e secilës palë, provat e marra në shqyrtim, analizën ligjore, pjesën urdhëruese si dhe do duhet të ketë datën e shpallje, orën, numrin e vendimit, afatin e ankimit në rrugë gjyqësore, të jetë i nënshkruar nga të gjithë anëtarët si dhe të ketë të pasqyruar mendimin e pakicës ose mendimet alternative⁹⁴.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Llojet e vendimeve që mund të merren nga organi publik që shqyrton ankimin janë të qarta për palët e interesuara?		
Diskutimet e zhvilluara para marrjes së vendimit mbi ankimin në organin publik që shqyrton ankimin dokumentohen dhe publikohen?		
Vendimet që shqyrtojnë ankimet janë të arsyetuara ?		
Vendimet e marra nga organi publik që shqyrton ankimin janë me terminologji/ gjuhë të kuptueshme për publikun?		
Organet raportojnë në mënyrë të rregullt mbi numrin dhe statusin e ankesave të trajtuara?		

5.3 E drejta e ankimit në juridiksionin gjyqësor

KZ ka njohur të drejtën e subjekteve për të ju drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre zgjedhore dhe ka krijuar një trup kompetente për shqyrtimin e mosmarrëreshjeve të tilla e cila funksionin pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

a. Subjektet e legjitimuara për ankimin në gjykatë

Në nenin 32/a të KPC si dhe në nenin 17 të ligjit nr. 49 datë 03.05.2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, parashikohen rastet kur subjekteve u lind e drejta për të kundërshtuar aktet ose veprime administrative dhe për të kërkuar kryerjen ose ndalimin e një veprimi të caktuar për shkak të mbrojtjes së të drejtave apo të interesave të paditësit.

Në lidhje me aspektin formal procedural të vlefshmërisë së padisë, padia që të jetë e vlefshme duhet të plotësojë dy kushte themelore:

- interesi i ligjshëm për të ngritur padi, dhe
- legjitimiteti për të vepruar.

Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për ta pranuar ose rrëzuar atë.

- Interesi i ligjshëm për të ngritur padi:

Interesi për të ngritur padi parashikohet qartë në nenin 32 të K.Pr.Civile dhe është një element i së drejtës së padisë që konsiston në interesin për të marrë nga gjykata vendimin e kërkuar. Ai është një interes procedural, i cili lind nga domosdoshmëria për të arritur nga procesi mbrojtjen e një interesi material dhe për këtë arsye pala i

[int/electoral-dispute-resolution/16809f0007](https://www.e-justice.gov.al/int/electoral-dispute-resolution/16809f0007), 2020, fq. 13.

⁹⁰ Vendimi nr. 812, datë 20.10.2023, ora 11:00 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

⁹¹ Vendimi nr. 812, datë 20.10.2023, ora 11:00 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

⁹² Vendimi nr: 000-032, data: 23.09.2023, ora: 11:41 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

⁹³ Vendimi nr: 765, datë 7.9.2023, ora: 17:00 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

⁹⁴ Neni 144 KZ.

drejtohet gjykatës duke kërkuar njohjen e cënimit të një interesi dhe rivendosjen e së drejtës së shkelur⁹⁵.

▪ Legjitimiteti për të vepruar

Legjitimiteti konsiston në përcaktimin e personit të cilit i përket interesi për të ngritur padi, por dhe personit kundrejt të cilit padia duhet të ngrihet. Duke qënë se e drejta për të ngritur padi duhet të ushtrohet kundrejt një pale tjetër, ky i fundit duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë, në mënyrë që vendimi gjyqësor të japë efektet e kërkuara për palën që ka investuar gjykatën me këtë padi.

Pra, në analizë sa më sipër, paditësi ka legjitimitet aktiv atëherë kur ai ka një interes të ligjshëm për të ngritur padinë, që synon angazhimin e gjykatës për të mbrojtur dhe vënë në vend të drejtat dhe interesat e ligjshme të shkelura dhe do të konsiderohet se është plotësuar kushti i dytë për vlefshmërinë e padisë kur është përcaktuar saktë personi të cilit i përket interesi për të ngritur padinë dhe personi kundrejt të cilit padia duhet të ngrihet⁹⁶.

Ndërsa, personi të cilit i drejtohet kërkitimi, duke pretenduar se është ky person që ka shkelur, cënuar apo mohuar të drejtën e paditësit, ka lidhje me atë që në të drejtën procedurale quhet legjitimitet pasiv⁹⁷ i cili është një aspekt i legjitimitetit për të vepruar. Legjitimiteti pasiv vlerësohet si një nga kushtet më të rëndësishme procedurale për faktin se është i lidhur direkt me efektet që do të ketë vendimi gjyqësor i marrë nga gjykata, pra i takon atij kundrejt të cilit vendimi gjyqësor do të ekzekutohet⁹⁸. Legjitimiteti aktiv konsiderohet ndryshe si legjitimiteti për të kërkuar, ndërsa legjitimiteti pasiv, si legjitimiteti për të kundërshtuar⁹⁹.

Sa më sipër është e domosdoshme që këta elementë të verifikohen nga gjykata që në fillim të procesit gjyqësor. Mos ekzistenca e njërit prej këtyre kushteve themelore të përmendura mësipër sjell si pasojë që padia të mos ekzistojë dhe gjykata të marrë vendim për rrëzimin e saj.

Në praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë¹⁰⁰, kjo gjykatë është shprehur se: “Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankimi administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ”.

Në interpretim të nenit 145 KZ ka parashikuar se e drejta për të bërë ankimin ndaj vendimeve të organeve zgjedhore u njihet të gjithë subjekteve të cilët kanë qënë pjesë e procedurës administrative dhe kundërshtojnë¹⁰¹:

- Vendimet që mund të çenojnë interesat e tyre të ligjshme;
- Mos marrjen e vendimeve brenda afateve ligjore;
- Refuzimin e kërkesës për regjistrim si subjekt zgjedhor;
- Refuzimin e kërkesës për akreditimin si vëzhgues.

Nga interpretimi në tërësi i KZ rezulton se ankimi administrativ është një parakusht për të ju drejtuar më pas rrugës gjyqësore. Aspektet që palët kërkojnë të rivendosin ose të zgjidhin i nënshtrohen detyrimisht ankimit administrativ dhe më pas vendimi ose mos marrja e vendimit brenda afateve kohore përbën objekt për shqyrtim nga juridiksioni gjyqësor.

Përsa i përket palës me legjitimitet pasiv, neni 145 i KZ i referohet vendimeve të KQZ dhe në këto raste, bazuar në interpretimin e bërë mësipër në legjitimitetin e subjekteve në ankimin administrativ, pala me legjitimitet pasiv do duhet të jetë njëri prej organeve drejtuese të KQZ me të cilin është ndjekur fillimisht procedura administrative.

⁹⁵ Vendimet nr. 5/2010, nr. 168/2010, nr. 190/2010, nr. 297/2009 të Gjykatës së Lartë.

⁹⁶ Vendimet nr. 5/2010, nr. 168/2010, nr. 190/2010, nr. 297/2009 të Gjykatës së Lartë.

⁹⁷ Vendim nr. 363/2013 i Gjykatës së Lartë.

⁹⁸ Vendim nr. 68/2011 i Gjykatës së Lartë.

⁹⁹ Vendim nr. 363/2013 i Gjykatës së Lartë.

¹⁰⁰ Vendimet nr.1 datë 26.11.2010 dhe nr. 4 datë 30.05.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dhe vendimet nr. 00-2020-17, datë 11.05.2020 dhe nr. 00- 2020 – 19, datë 11.05.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë,

¹⁰¹ Neni 145 i KZ.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Ekzistojnë mekanizma balancimi dhe kontrolli për të mbikëqyrur vendimet e marra nga KQZ?		
Procedurat për paraqitjen e ankimit gjyqësor janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për palët e interesuara?		
Legjislacioni garanton të drejtën për tu mbrojtur nëpërmjet pjesëmarrjes në procedimin gjyqësor?		

b. Shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është krijuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, një trup gjykues e cila funksionon për zgjidhjen vetëm të mosmarrëveshjeve të lindura prej KZ.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor thirret në detyrë sa herë që pranë gjykatës depozitohet ankim ndaj vendimeve të KQZ¹⁰² dhe është i përbërë nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, me përjashtim të atyre që ushtrojnë funksionet pranë Gjykatës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit¹⁰³.

Gjyqtarëve të Kolegjit u është dhënë një lloj “*imuniteti*” prej KZ duke qënë se gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ata nuk mund:

- T’i nënshtrohen hetimit apo procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji;
- Të lëvizen nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe disiplinore ose organizimi gjyqësor;
- Të vlerësohen “i pamjaftueshëm” për aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe etikën/ angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit.

Pavarësisht këtij “*imuniteti*” të dhënë, garancitë procedurale për palët që mund të jenë në konflikt interesi me ndonjë prej gjyqtarëve janë të parashikuar edhe në KZ. Në kuadër të parashikimit të mekanizmave mbrojtës të të drejtave procedurale të palës në proces në shqyrtimin e çështjes gjyqësore KZ referon zbatimin e dispozitave procedurale të KPC¹⁰⁴.

Neni 151 i KZ i njeh palëve të drejtën të kërkojnë përjashtimin e ndonjë prej gjyqtarëve të Kolegjit nëse rezultojnë se gjyqtari ka ndonjë interes për çështjen, ka qënë më parë punëdhënë, punëmarrës, këshilltar, përfaqësues ose avokat i ndonjë palëve, ka lidhje gjinie ose marrëdhënie krushqie të afërt me ndonjë nga palët, ose rezultojnë se ai nuk mund ta kryejë detyrën në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar asnjë prej palëve. Kërkesën për përjashtim paditësi apo pala e interesuar duhet ta depozitojë në sekretarinë e gjykatës pasi është bërë i ditur emri i gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe nëse ajo paraqitet jashtë afateve dhe procedurave të nenit 151 nuk do të merret në shqyrtim. Neni 151 dukshëm e kufizon të drejtën e palës për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit me zbatimin e afatit dhe procedurës sipërcituar. Në këtë rast pala mund duhet të mbajë në konsideratë dhe parashikimet e KPC që ka një trajtim më të zgjeruar lidhur me shkaqet dhe afatin e paraqitjes e kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit. Sipas KCP kërkesa duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen. Paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijeni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijeni¹⁰⁵.

¹⁰² Neni 146, pika 8 KZ.

¹⁰³ Neni 146, pika 1 KZ.

¹⁰⁴ Neni 155, pika 1 KZ.

¹⁰⁵ Neni 74, paragrafi 2 dhe 3 KPC.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Gjyqtarëve të Kolegjit u është garantuar imuniteti gjatë ushtrimit të funksionit të tyre?		
Është caktuar gjyqtari nëpërmjet zbatimit të procedurës së shortit?		
Është zbatuar drejtë procedura për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve?		
Kemi qenë përpara rasteve për përjashtimin e gjyqtarit dhe është pranuar kërkesa?		
Në rast se gjyqtari ka pasur një mandat të caktuar për ushtrimin e funksionit, a ka qenë trupi gjykues brenda afatit të mandatit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen?		
Është zgjatur mandati i gjyqtarit me vendim/ndikimin e pushtetit ekzekutiv në funksion të gjyqimit të çështjeve të caktuara?		

c. Afati i ankimit dhe aspektet formale të paraqitjes së ankimit

Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, mund të paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë¹⁰⁶.

Përsa i përket aspekteve të formës dhe përmbajtjes së ankimit ai duhet të paraqitet në formën e kërkesëpadisë dhe të përmbajë të dhënat e identitetit të paditësit, palën e paditur, palën e interesuar, objektin, bazën ligjore, shkeljen e pretenduar së bashku me pikat e vendimit të KQZ të cilat kundërshtohen, faktet si dhe argumentet ku mbështet ankimi¹⁰⁷.

Pavarësisht se forma e aktit është ankimi, legjislatori në neni 153 të KZ ka parashikuar se paraqitja do duhet të bëhet në formën e kërkesëpadisë. Duke qenë se në këtë nen janë referuar edhe elementët përbërës të ankimit, jemi të mendimit që ai do duhet të përmbajë dhe elementët e tjerë të kërkesëpadisë parashikuar nga neni 154 i KPC duke mos lënë pa përfshirë dhe gjykatën para të cilës paraqitet ankimi, listën e personave që kërkon të thirren në gjykim në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to; provat që kërkohen të merren nga i padituri dhe të tretët, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e këtyre provave; llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjyqimit¹⁰⁸.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Elementet e formës dhe përmbajtjes së ankimit janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për palët e interesuara?		
Shqyrtimi i ankimit administrativ u zhvillua brenda afateve?		
KZ njoftoi publikisht datën dhe orën e shqyrtimit të ankimit administrativ?		
Pala e interesuar u përfshi dhe njoftua në procedurën e shqyrtimit gjyqësor të ankesës?		

d. Provueshmëria në procesin gjyqësor

KZ rezulton se nuk ka parashikime të mirëfillta në lidhje llojet e provave dhe mënyrës së marrjes së tyre, por parashikon vetëm që palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë kanë të gjitha të drejtat procedurale dispozitive të KPC. Gjatë shqyrtimit gjyqësor KQZ ka për detyrë të sjellë në gjykim të gjitha provat e administruara prej saj gjatë shqyrtimit administrativ, pavarësisht nga kërkesat e palëve për to, si dhe çdo provë tjetër që mund të kërkohet nga Kolegji Zgjedhor¹⁰⁹.

Duke qenë se llojet e provave që lidhen me çështjet zgjedhore mund të jenë më komplekse në sigurimin e tyre dhe barra e provës mund të jetë një aspekt penalizues për palën e cila vendos në lëvizje procesin, atëherë jemi të

¹⁰⁶ Neni 152 KZ.

¹⁰⁷ Neni 153 KZ.

¹⁰⁸ Neni 154 KPC.

¹⁰⁹ Neni 156, pika 2 KZ.

mendimit që KZ do duhet të parashikonte rregulla më specifike lidhur këtë çështje. Në këtë mënyrë, sikurse edhe në rastin e procedurave të shqyrtimit të ankimit administrative, pala la ka detyrimin që të provojë bazueshmërinë e themelit të kërtimeve ose prapësimeve.

GJEDNJ-ja në Çështjen Aliyev kundër Azerbajxhanit është shprehur kundër “formalizmit” në gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore:

“As ankimet e mëvonshme të palës kërkuuese nuk u trajtuan në mënyrën e përshtatshme. Në veçanti, të dyja gjykatat u mbështetën në arsye tejet formale për të shmangur shqyrtimin e thelbit të ankesave të palës kërkuuese, duke arritur në përfundimin se ai nuk kishte paraqitur kopje të noterizuar siç duhet të deklaratohej me shkrim të vëzhguesve përkatës dhe se ai nuk i kishte bashkëlidhur padisë së tij në apelim prova shkruese që ai e kishte bërë në fakt kërkesën në KQZ.

Në rrethanat e rastit konkret, sidoqoftë, Gjykata çmon se një qasje kaq e ngurtë dhe tërësisht formale ishte e pajustificueshme në bazë të Konventës. Në këtë aspekt, Gjykata sjell në vëmendje Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, i cili nuk rekomandon formalizmin e tepërt në shqyrtimin e ankimeve zgjedhore, në veçanti kur është fjala për pranueshmërinë e ankimeve¹¹⁰.”

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
KZ rezulton se nuk ka parashikime të mirëfillta në lidhje llojet e provave dhe mënyrës së marrjes së tyre?		
Janë organizuar seanca publike për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me ankimet zgjedhore ?		
KQZ ka sjellë në gjykim të gjitha provat e administruara prej saj gjatë shqyrtimit administrativ, pavarësisht nga kërkesat e palëve për to?		

e. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor

Në varësi të rrethanave të faktit të mosmarrëveshjes në shqyrtim Kolegji mund të vendosë:

- Pushimin e gjykimit;
- Gjykimin e çështjes në themel; ose
- Detyrimin e KQZ për të marrë vendim në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të KZ. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është e formës së prerë dhe i paankimueshëm¹¹¹.

Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga gjyqtarët që e mbështesin atë¹¹².

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Llojet e vendimeve që mund të disponohen nga Kolegji Zgjedhor janë të janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për palët e interesuara?		
Vendimet gjyqësore janë të arsyetuara		
Vendimet e marra nga KZ janë me terminologji/gjuhë të kuptueshme për publikun?		

5.4 Legjitimiteti i subjekteve në GJK

Çështja e legjitimitetit në GJK shtrihet jo vetëm në aspektin e kërkesave të partive politike për të kërkuar shfuqizim të ligjit apo akteve nënligjore, por i referohet edhe vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të cilët mund të jenë objekt për shqyrtim në GJK.

Legjitimiteti i partive politike për të ju drejtuar GJK është parashikuar në nenin 134, pika 1/gj të Kushtetutës dhe është interpretuar dhe në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila është shprehur se:

¹¹⁰ Aliyev v. Azerbajjan, aplikimi nr. 18705/06, 2010, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

¹¹¹ Neni 158 KZ.

¹¹² Neni 159 KZ.

Partitë politike, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, janë subjekte që mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën. Gjithsesi, në gjykime të kësaj natyre, ato, si subjekte të kushtëzuara që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Po kështu, sipas nenit 49, pika 3, shkronja "d" dhe pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, partitë politike mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, duke pasur detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimin e veprimtarisë së tyre. (shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 11, datë 13.03.2015; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se mundësia e partive politike për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues ekziston kur ato kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues, bashkë me të edhe pjesëmarrjen e tyre në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Të tilla mund të jenë aktet që përcaktojnë deklarin e pasurive, financimin e tyre nga shteti ose subjekte të tjera, dhënia e shansit të barabartë të gjitha partive për të marrë pushtetin, mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre politike jo vetëm gjatë zgjedhjeve, por edhe në periudhën midis tyre (shih vendimet nr. 28, datë 09.05.2012 ; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Përsa i përket çështjes së ankimeve ndaj vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, parashikimi ligjor se ato janë vendime të formës së prerë dhe të paankimueshme nuk i kufizon subjekteve të drejtën për të ju drejtuar GJK për aspekte që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

GJK vihet në lëvizje më kërkesën e individëve¹¹³ dhe vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë¹¹⁴.

Referuar ligjit nr. 8577/2000, në nenin 71, pika 1, gërma "a", parashikon se ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga GJK kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet GJK ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion dhe duhet të paraqitet brenda katër muajve nga momenti i konstatimit të cënimit¹¹⁵.

Bazuar në këto dispozita, parashikimi i KZ se vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë dhe i paankimueshëm nuk përjashton mundësinë e subjekteve për t'ju drejtuar GJK bazuar kjo në interpretimin se janë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe nuk ka në dispozicion mjete të tjera juridike për të kërkuar rivendosjen e së drejtës ose konstatimin e cënimit. Ky argumentim bazohet dhe në vetë jurisprudencën e GJK e cila me vendimin nr. 18, datë 30.03.2021 është shprehur se:

Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike, Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Në çështjen konkrete, vendimi i fundit është dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit, i cili, bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (ligji nr. 49/2012) është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë, për pasojë ky vendim gjyqësor ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkueses. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuessa e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, pavarësisht përmbajtjes së dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të

Apelit se ndaj këtij vendimi lejohet rekurs.

Pretendimet e subjekteve duhet të jenë të lidhura detyrimisht me të drejtat dhe liritë të garantuara nga Kushtetuta dhe aspektet e procesit të rregullt ligjor të cilat i janë cënuar gjatë shqyrtimit të çështjes në nivel administrativ dhe/ose gjyqësor. Ky mjet juridik është ekzistues për subjektet pavarësisht kufizimeve ligjore që mund të ekzistojnë në ligje të tjera të posaçme.

¹¹³ Neni 134, pika 1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

¹¹⁴ Neni 131, pika 1, gërma f, Kushtetuta e RSH.

¹¹⁵ Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në fletoren zyrtare nr. 4, datë 13.01.2000, neni 71/a, pika 1, gërma "b".

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Palët e interesuara janë të informuara për të drejtën për të ju drejtuar GJK për aspekte që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë		
Shqyrtimi i ankimit në GJK u realizua brenda afateve ligjore?		

5.5 Shqyrtimi i denoncimeve dhe vendimet që merren në përfundim të tyre

KZ ka parashikuar detyrimin e KQZ për të krijuar dhe mirëmbajtur portalin e saj në internet, me akses të lirë, që kushdo të denoncojë shkeljet e mundshme të këtij ligji nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët në lidhje me financimin e fushatës¹¹⁶. Ky parashikim ligjor është shoqëruar me një rregullim të posaçëm për të gjitha aspektet që lidhen me denoncimet dhe trajtimin e tyre me qëllim garantimin e të drejtave të subjekteve që lidhen me procesin zgjedhor.

Rregullatori pranë KQZ-së ka miratuar vendimin nr. 9 datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”¹¹⁷. Çdo shtetas, person fizik ose juridik mund të njoftojë ose kallëzojë në Portalin e Denoncimeve pranë KQZ ose drejtpërdrejt në KQZ shkeljet e mundshme që lidhen me financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të tyre dhe/ose keqpërdorimin e burimeve publike në mbështetje të tyre në kundërshtim me dispozitat e KZ, ligjin “Për partitë politike” dhe/ose aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre¹¹⁸.

a. Denoncuesi

Sipas përkufizimit të dhënë nga neni 2, pika 2¹¹⁹ i Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, denoncues mund të jetë çdo shtetas, person fizik ose juridik identiteti i të cilit si rregull duhet të jetë i përcaktuar, por përjashtimisht mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe kjo kërkesë do të pranohet vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimit si dhe nëse informacioni dhe të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme¹²⁰.

Në përmbajtje të denoncimit duhet të paraqitet detyrimisht informacioni lidhur me të dhënat që shërbejnë për identifikimin e denoncuesit dhe adresën e tij, objektin e denoncimit dhe një përshkrim të shkurtër, aktin ligjor/nënligjor të shkelur nëse mund ta përcaktohet prej denoncuesit. Denoncimi mund të shoqërohet me të dhëna, dokumente, foto apo informacione të tjera të cilat mund të ngarkohen elektronikisht ose të dërgohen fizikisht në KQZ¹²¹.

b. Organi administrativ i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të denoncimit

KREU III i vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 të Komisionit Rregullator ka parashikuar si organ kompetent për shqyrtimin e denoncimeve Komisionerin i cili ka një afat ligjor të përcaktuar prej 60 ditësh për hetimin administrativ i cili mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit nëse çështja është komplekse¹²². Nga momenti i paraqitjes së denoncimit Komisioneri brenda pesë ditëve duhet të verifikojë kompetencën për shqyrtimin e tij dhe nëse shkelja ka indicie të besueshme për të filluar hetimin administrativ. Në rast se KQZ nuk është kompetente dhe/ose mungojnë indicie të besueshme për të nisur hetimin administrativ Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit. Në të kundërt ai fillon hetimin administrativ¹²³.

Në ndryshim nga procedura administrative e parashikuar në KZ për hetimin dhe shqyrtimin administrativ, vendimi i Rregullatorit e ka ngarkuar Komisionerin me detyrimin për të njoftuar subjektin që i nënshtrohet hetimit administrativ me shkrim dhe i kërkon të paraqesë informacione, të dhëna e prova brenda dhjetë ditëve nga marrja e kërkesës. Po ashtu ai bashkëpunon me denoncuesin për përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes¹²⁴. Në këtë procedurë të hetimit administrativ është parashikuar edhe mundësia e drejtpërdrejtë

¹¹⁶ Neni 92, pika 5 KZ.

¹¹⁷ Vendimi nr. 9, datw 09.03.2021 i Komisionit Rregullator.

¹¹⁸ Vendimi nr. 9, datw 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 1.

¹¹⁹ Vendimi nr. 9, datw 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 2, pika 2.

¹²⁰ Vendimi nr. 9, datw 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 6, pika 4.

¹²¹ Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 6 pika 2 dhe 3.

¹²² Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 7.

¹²³ Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 8.

¹²⁴ Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 10.

e palës dhe Komisionerit për të sqaruar rrethanat dhe fakte nëpërmjet ekspertëve të licencuar të fushës¹²⁵.

c. Përfundimi i hetimit administrativ dhe marrja e vendimit

Administrata e KQZ përgatit relacionin në përfundim të këqyrjes së akteve, provave e të dhënave dhe ja paraqet atë pa vonesë Komisionerit i cili brenda pesë ditëve nga marrja e tij njofton me shkrim subjektin dhe e fton të paraqesë prapësimet brenda pesë ditëve nga marrja e relacionit. Në rastet me ndikim publik ose kur Komisioneri e gjykon të arsyeshme ai organizon seancë dëgjimore publike brenda pesë ditëve nga marrja e relacionit me qëllim që subjekti i hetimit të paraqesë komentet e tij¹²⁶.

Vendimi përfundimtar i njoftohet si subjektit që i është nënshtruar hetimit ashtu edhe denoncuesit. Pavarësisht se në vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 nuk është parashikuar e drejta e ankimit për palët kundër vendimit të Komisionerit, kjo e drejtë buron nga neni 21.1.b i KZ, i cili në kompetencat e KAS *inter alia* i njeh të drejtën të shqyrtojë dhe vendosë në rrugë administrative për ankesat ndaj akteve të Komisionerit.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Portali i denoncimeve në faqen e internetit të KQZ ishte funksional dhe lehtësisht i përdorshëm?		
Shqyrtimi i denoncimeve, përfundimi i hetimit administrativ dhe marrja e vendimit janë realizuar brenda afateve ligjore?		
Subjekti që i nënshtrohet hetimit administrativ është njoftuar dhe i është dhënë mundësia të paraqesë informacione, të dhëna e prova?		
E drejta e palëve për të paraqitur ankimim kundër vendimit të Komisionerit rezulton në të qartë dhe të kuptueshme?		

KREU I GJASHTË

PËRMBLEDHJE PËR GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE TË MISIONEVE TË VËZHGUESVE NDËRKOMBËTAR DHE OPINIONEVE TË KOMISIONIT TË VENECIES

Me 19 qershor 1991, në Mbledhjen e Berlinit, Shqipëri u pranua anëtarë e KSBE-së (OSBE). Si anëtarë e këtij Këshilli, Shqipëria ka firmosur Kartën e Stambollit. Kjo e angazhon qeverinë shqiptare të ftojë, në mënyrë të veçantë, misione të OSBE/ODIHR për të vëzhguar zgjedhjet. Për rezultatet e vëzhgimit të këtyre misionëve, gjykimet dhe vlerësimet e tyre për zgjedhjet që vëzhgojnë dhe rekomandimet që ata japin në Raportin përfundimtar, Shqipëria, si firmëtare e Kartës së Stambollit, ka deklaruar se:

“Ne pranojmë të vëmë menjëherë në jetë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet.” (Karta për Sigurinë Evropiane, Stamboll, Paragrafi 25).

Shqipëria është anëtarësuar në Këshillin e Evropës (KiE) më 13 korrik 1995. Si anëtarë e këtij Këshilli, në përpjekjet që benë për hartimin dhe zhvillimin e legjislacioni dhe në veçanti për legjislacionit zgjedhor, Shqipërisë i ofrohet këshillim i vazhdueshëm nga Komisioni i Venecies.

Gjatë periudhës rreth tridhjetë vjeçare të tranzicionit politik, ekonomik dhe shoqëror që është zhvilluar në Shqipëri, prezenca, mbështetja dhe këshillimi nëpërmjet rekomandimeve ose opinioneve të organizmave ndërkombëtare, në veçanti të OSBE/ODIHR, KiE, Komisionit Evropian, Komisionit të Venecies dhe përfaqësive diplomatike të akredituara në Shqipëri, kanë qënë dhe mbeten ndër faktorët e rëndësishëm që nxitin dhe mundësojnë realizimin e progresit në përpjekjet që bëhen për ndërtimin e një kuadri ligjor të përafëruar me ata të BE-së dhe në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në konventat dhe dokumente të ndryshëm ndërkombëtar.

¹²⁵ Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 12.

¹²⁶ Vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator, neni 15.

6.1 Rekomandime dhe reagim i partive politike dhe ligjvënësive ndër vite

Analiza e gjykrimeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR që kanë vëzhguar proceset zgjedhore në Shqipëri nëperiudhën pas ndryshimeve politike dhe ekonomike të ndodhura në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar dhe, në veçanti zgjedhjeve të zhvilluara pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 28 nëntor 1998, së bashkume analizën e opinioneve të përbashkëta të Komisionit të Venecies me OSBE/ODIHR për legjislacionin dhe praktikatzgjedhore shqiptare, japin mundësinë për të gjykuar objektivisht për ecurinë, veçoritë, karakteristikat, problemet dhe sfidat kryesore që kanë shoqëruar zgjedhjet dhe reformat zgjedhore në Shqipëri.

Refleksioni mbi vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare për ecurinë e praktikave zgjedhore në Shqipëri, për masën e përafrimit të zgjedhjeve shqiptare me standardet për zgjedhje demokratike dhe angazhimet e OSBE-së, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, mënyra se si ka reaguar shoqëria shqiptare në përgjithësi, institucionet dhe partitë politike në veçanti, në angazhimin për zbatimin e këshillave, asistencës teknike dhe rekomandimeve të dhëna prej këtyre institucioneve, janë ndër rrugët dhe mundësitë më efektive, për të gjykuar dhe për të vlerësuar ecurinë e proceseve zgjedhore në Shqipëri si dhe arritjet e shoqërisë shqiptare në përpjekjet për t'u ndërtuar dhe për t'u zhvilluar si një shoqëri demokratike.

Misionet e vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR kanë vëzhguar të gjithë proceset zgjedhore të zhvilluar në Shqipëri, me përjashtim të zgjedhjeve të para pluraliste, 1991, 1992. Në raportet e tyre këto misionet kanë paraqitur gjithsej 338 rekomandime. Në fokus të rekomandimeve janë çështjet e lidhura me:

(i) nevojat për përmirësime në legjislacion, me objektiv hartimin e një legjislacioni zgjedhor që duhet të krijojë bazën e nevojshme ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me parimet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, standarteve për zgjedhje demokratike dhe angazhimeve të OSBE-së,

(ii) ndërhyrjen dhe përmirësimet që duhet të bëhen në legjislacionin shqiptar, zbatimin e të cilit lidhet dhe ndikon edhe në ecurinë e proceseve zgjedhore,

(iii) praktikën e zhvillimit të proceseve zgjedhore, me fokus të dedikuar në përgjegjësitë, punën dhe sjelljen ndaj të drejtave dhe detyrave që parashikon ligji për institucionet dhe aktorët e ndryshëm, pjesëmarrës në një proces zgjedhor, për partitë politike, administratën zgjedhore, institucionet dhe organet qeverisëse në nivel qendror dhe lokal, institucionet ligj zbatuese, zgjedhësit dhe shoqëria civile.

Për çështje që lidhen me legjislacionin dhe praktikatzgjedhor në Shqipëri Komisioni i Venecies ka hartuar katër opinione.

Sipas vlerësimeve të shprehura prej Misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR, proceset zgjedhore në Shqipëri, pavarësisht nga prezenca e një trendi pozitiv, vazhdojnë të klasifikohen në grupin e zgjedhjeve të cilat arrijnë të plotësojnë në nivelin mjaftueshëm standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-se për zgjedhje demokratike.

Analiza e përpjekjeve për realizimin e standardeve për zgjedhje demokratike dhe rezultatet e arritura janë të ndryshme për fazat dhe procedurat e ndryshme nëpër të cilat kalon procesi zgjedhor. Diferenca të ndjeshme identifikohen edhe në nivelin e angazhimit në plotësim të kërkesave të legjislacionit prej institucioneve të ndryshme që kanë detyra në kuadër të proceseve zgjedhore. Në mënyrë të veçantë vëzhguesit ndërkombëtarë vlerësojnë arritjet në përpjekjet shumëvjeçare për:

(i) hartimin e listës së zgjedhësve si një dokument me cilësi, saktësi dhe plotëshmëri, që ju përgjigjet nevojave të legjislacionit shqiptar që rregullon të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë dhe si një produkt që gjenerohet prej Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, i ka të gjitha mundësitë metodike dhe infrastrukturore për t'u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme,

(ii) performancën, me rritje pozitive dhe sjelljen në plotësimin e përgjegjësiave dhe detyrave që kanë në procesin zgjedhor, forcat e ruajtjes së rendit, transparencën në vendimmarrjen në administratën zgjedhore, në KQZ, KZAZ KQV dhe Grupet e numërimit të votave,

(iii) përpjekjet e suksesshme për përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje,

(iv) hartimin e një legjislacioni që synon të zhvillojë përherë dhe më shumë kapacitetet legjislative dhe institucionale për rritjen e transparencës në financimin e fushatave zgjedhore,

(v) përpjekjet për ngushtimin e hapësirave ligjore për interferimin në zgjedhje të botës së krimit dhe personave me rekorde kriminale,

(vi) përmirësimin e standardeve ligjore në shqyrtimin administrativ dhe gjyqësor të ankesave dhe apelineve.

Misionet e vëzhguesve ndërkombëtarë theksojnë se përpjekjet e mëdha të shoqërisë shqiptare, në planin legjislativ, institucionale dhe për formimin e kulturës dhe sjelljes demokratike, të nevojshme për zhvillimin e proceseve zgjedhore që plotësojnë standardet demokratike, në të shumtën e rasteve janë kompromentuar nga mjedisi politik me ngarkesa të larta konfliktualitetit. Zgjedhjet në Shqipëri - theksojnë ndërkombëtarët - më shumë se nga çdo gjë tjetër e kanë pësuar nga sjellja e partive politike ndaj detyrave dhe të drejtave të tyre. Në raportet e tyre, në mënyrë të përsëritur, me shumë se për çdo çështje e problem tjetër, ata nënvizojnë nevojën që partitë politike shqiptare, në zgjedhje duhet të sillen në lartësinë e kërkesave të ligjit dhe detyrës, shumë më tepër se sa në funksion të objektivave elektorale të tyre.

Në raportet e misionit të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR theksohet se legjislacioni zgjedhor shqiptar, në përgjithësi është produkt bipartizan, nëpërmjet të cilit dy partitë kryesore, PS e PD, janë përpjekur të ndërtojnë instrumente ligjor dhe institucional që t'ju shërbejnë interesave të tyre elektorale. Kujdes i përhershëm i tyre ka qënë ndërtimi i mekanizmave për kontroll të ndërsjellë.

Me gjithë rekomandimet e vazhdueshme për zvogëlimin e hapësirës dhe të drejtave që legjislacioni zgjedhor ju ka njohur partive politike për të qënë, praktikisht edhe administratore të proceseve zgjedhore, këto rekomandime nuk janë trajtuar në reformat zgjedhore të kryera. Kodi zgjedhor nuk ka ndryshuar. Edhe në rastet kur në legjislacion ka patur zgjidhje që kanë synuar ndërtimin e një administrate zgjedhore të pandikuar plotësisht nga vullneti i partive politike, rasti i KQZ-se si institucion kushtetues, partitë politike shqiptare kanë përdorur të gjithë mundësitë dhe kapacitetet e tyre, për ta ndryshuar këtë situatë ligjore. Përpjekja e bërë në reformën e fundit elektorale për ndërtimin e një administrate zgjedhore pa përfaqësim politik dështoi. Ndërtimi i KQZ si një institucion me një kompetence autokratike dhe dy struktura kolegjiale, Komisionin Rregullator dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, sipas përcaktimeve në dispozitat kalimtare që partitë politike u dakortësuan për t'i përfshirë në Kodin zgjedhor është argument që tregon se partitë politike nuk janë të gatshme për të ndërtuar një administratë zgjedhore jo partiake.

Partitë politike nuk kanë pranuar, në asnjë rast, të heqin dorë nga e drejta që kanë për të zëvendësuar anëtarë të komisioneve zgjedhore të propozuar prej tyre pa dhënë asnjë arsye ose shpjegim. Kërkesa për abrogimin e kësaj dispozite ligjore është përsëritur, në mënyrë të vazhdueshme, e shprehur në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën këmbëngulje, që në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, 2005 dhe deri në raportin për zgjedhjet e fundit parlamentare, 2021. Klasa politike shqiptare është treguar plotësisht refraktare ndaj këtij rekomandimi. Ky rekomandim është i përsëritur edhe në të katër opinionet e Komisionit të Venecies.

Partitë politike pruan të heqin dorë nga e drejta që kishin për të refuzuar anëtarin e Kolegjit zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, të zgjedhur me short, vetëm me ndryshimet që u bënë në Kodin zgjedhor me ligjin nr. 74/2012, ndërkohë që Rekomandimi për heqjen e kësaj të drejte partive politike është dhënë që në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, 2005. Ai është rekomandim i përsëritur në të katër opinionet e përbashkëta të Komisionit të Venecies & OSBE/ODIHR.

Megjithëse pas rekomandimeve të përsëritura të vëzhguesve ndërkombëtar për heqjen nga Kodi zgjedhor i të drejtës së drejtuesit të partisë për të kandiduar në shumë njësi zgjedhore njëkohësisht, kjo dispozitë u ripërfshi në Kodin zgjedhor duke i dhënë të drejtën kryetarit të partisë, ndryshe nga gjithë kandidatët e tjerë, të kandidojë deri në katër njësi zgjedhore. Misioni i vëzhguesve ndërkombëtar rekomandon rishikimin e kësaj dispozite¹²⁷

Rekomandimet e misioneve të OSBE/ODIHR që kanë vëzhguar zgjedhjet në Shqipëri dhe rekomandimet e dhënë në opinionet e përbashkëta të Komisionit të Venecies dhe OSBE/ODIHR, që trajtojnë çështje të lidhura me:

(i) rregullimin e vazhdueshme e procedurave dhe rregullave që duhet të zbatohet për hartimin e listës së zgjedhëseve,

(ii) rrugë zgjidhjet ligjore për formimin e administratës zgjedhore të cilat të bëjnë të mundur ndërtimin e një administratë me nivel me të lartë besueshmërie dhe zvogëlimin e efekteve negative që sjell interferimi i partive

¹²⁷ Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021. Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.

politike në punën e saj,

(iii) rritjen nivelit të ndikimit të zgjedhësve nëpërmjet zgjedhjes së kandidatëve në formimin e institucioneve që dalin nga zgjedhjet parlamentare ose për këshillat bashkiak,

(iv) mirë rregullimin e rolit të medias në fushatat zgjedhore dhe monitorimin e tyre,

(v) financimin e fushatave zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e shpenzimeve,

(vi) lehtësimin e votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike,

(vii) informimin dhe edukimin zgjedhor qytetar, në veçanti për zgjedhësit që ju përkasin pakicave kombëtare,

(viii) rregullimin me efektiv të të drejtës për ankim dhe procedurat për shqyrtimin administrativ dhe gjykimin e ankesave dhe apeliave, kanë qënë përherë në vëmendjen dhe, në përgjithësi, janë trajtuar nga trupa legjislative shqiptare. Përpjekjet e kësaj trupe për të arritur në zgjidhjet legjislative sa më të mira dhe efektive, në shumë raste janë penguar nga mungesa e vullnetit politik. Në mënyrë të përsëritur reformat zgjedhore nuk janë realizuar dhe, jo rrallë ndryshimet në legjislacionin zgjedhor janë bërë në “minutën e fundit”. Vëzhguesit ndërkombëtar kanë theksuar, në mënyrë të përsëritur nevojën për respektimin e detyrimit që ka Shqipëria për të reflektuar në legjislacionin e saj rekomandimet që jepen prej vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR.

Angazhimi dhe puna për pasqyrimin në legjislacion dhe në praktikën zgjedhore, të rekomandimeve të dhëna prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe Komisionit të Venecias, në asnjë rast nuk është realizuar si një proces efektiv gjithëpërfshirës. Reformat zgjedhore, përherë kanë patur si rezultat një produkt në të cilin është pasqyruar shumë pak dhe, si rregull aspak, mendimi dhe propozimet që janë bërë nga parti të tjera politike veç PS e PD dhe nga organizata të shoqërisë civile. Vendimmarrësit në reformën zgjedhore, PS e PD, kanë treguar kujdes të shtuar për të rregulluar dispozita ligjore në shërbim të interesave të tyre elektorale se sa për të gjetur zgjidhje të cilat do të bënin të mundur arritjen e pritshmërive nga zbatimi i rekomandimeve të dhëna.

Misionet e vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias në raportet dhe opinionet e publikuara për zgjedhjet në Shqipëri, këmbëngulin se, pavarësisht nga zhvillimet dhe arritjet që mund të realizohen në legjislacionin shqiptar, për të mundur zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me parimet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, zgjedhje që do të arrijnë standardet më të larta të zgjedhjeve demokratike, i domosdoshëm është vullneti politik për respektimin dhe zbatimin e ligjit, e rëndësishme është sjellja dhe kultura që orientohet drejtë përgjegjësi për zbatimin rigoroz të ligjit nga të gjithë institucionet dhe aktorët që marrin pjesë në një proces zgjedhor.

6.2 Rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR- zgjedhjet parlamentare, 2021 Zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, 2023 – reagime ndaj tyre.

Në reformën zgjedhore që u zhvillua në 2020, u trajtuan dhe ju dhane zgjidhje një pjesë të rekomandimeve të vëzhguesve ndërkombëtarë të paraqitura prej tyre në raportet përfundimtare për zgjedhjet që janë zhvilluar në 2015, 2017 dhe 2019. Vlerësimet e dhëna prej tyre, të mbështetura në rezultatet e monitorimit dhe vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare që u zhvilluan në 2021 dhe i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, 2023, është materializuar në rekomandimet që ata kanë formuluar dhe publikuar në raportet përfundimtare për këto zgjedhje.

Partitë politike dhe ligjvënësi shqiptar nuk arriti të bente asnjë ndryshim në legjislacionin zgjedhor për të pasqyruar në të rekomandimet e ndërkombëtarëve, të dhëna në Raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, 2021. Ndërkohë duhet të theksohet se shoqëria civile dhe organizata perfaqësuese të saj, gjatë periudhës pas zgjedhjeve parlamentare, 2021 u angazhuan dhe këmbëngulen për zhvillimin e reformës zgjedhore. Ato e konsideronin shumë të rëndësishme dhe të nevojshme përmirësimet që duhet të bëheshin në Kodin zgjedhor me synim që zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore të mos ballafaqoheshin me të njëjtat probleme dhe fenomene që ndikuan negativisht në plotësimin e standardeve në zgjedhjet parlamentare, 2021. Angazhimi dhe presioni i tyre u krye jo vetëm nëpërmjet kërkesave drejtuar partive politike dhe Kuvendit të Shqipërisë për të realizuar reformën zgjedhore si dhe kishin premtuar me ngritjen, që në Shkurt, 2022, të Komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore por edhe duke aktivizuar veprimin qytetar për nismën ligjvënëse dhe propozimin si rezultat i kësaj nisme të një projekt-ligji që trajtonte çështjen e zgjedhjes me lista të hapura të antareve për këshillat bashkiakë. Pavarësisht kësaj, zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes lokale u zhvilluan me të njëjtin Kodi zgjedhor, të pandryshuar si ai që u përdor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 2021.

Për të orientuar organizatat e shoqërisë civile që punën për përgatitjen profesionale dhe organizative të nevojshme për të realizuar objektivat e tyre në pjesëmarrjen dhe kontributin për zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike të vendit tone, në vijim shtjellohet një paraqitje krahasuese e rekomandimeve të dhëna nga misionet e vëzhguesve ndërkombëtarë **që vëzhguan zgjedhjet parlamentare, 2021 dhe zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, 2023**

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime prioritare	
1. Kuadri ligjor ka nevojë për rishikim të mëtejshëm për të adresuar rekomandimet e paadresuara të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias, si dhe një sërë paqartësish dhe mospërputhjes. Ndryshimet në ligj duhet të paraprihen nga një proces i hapur dhe gjithëpërfshirës konsultimi, dhe të miratohen përpara zgjedhjeve të ardhshme. 2. Shteti duhet të garantojë të drejtën për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo dhe si ka votuar duhet të parandalohet. 3. Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të intensifikojnë përpjekjet për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e shitblerjes së votës. Qytetarët duhet të inkurajohen të raportojnë dhe të japin prova të çdo rasti të shitblerjes së votave apo të ushtrimit të presionit. 4. Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Institucionet përkatëse duhet të hetojnë dhe të sanksionojnë plotësisht çdo shkelje që ndikon në besimin e publikut në procesin zgjedhor. 5. Legjislacioni duhet të ndryshohet për t'u siguruar që mediat të jenë në gjendje të mbulojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e subjekteve zgjedhore me qëllim kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së prodhuar nga partitë në lajme.	1. Organet e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, duke përfshirë blerjen e votës, presionin ndaj zgjedhësve dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, në mënyrë tërësore, në kohën e duhur dhe me transparencë. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj pasojave të denoncimit. 2. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e hershëm të blerjes së votës dhe rreziqet që sjell ajo për integritetin e zgjedhjeve. Denoncimi publik i praktikave të tilla para dhe gjatë fushatës nga aktorët kryesorë, duke përfshirë zyrtarët shtetërorë dhe drejtuesit e partive, mund të shërbejë për frenimin e këtij fenomeni. 3. Për të garantuar fshehtësinë e votës dhe për të parandaluar presionin ndaj zgjedhësve, votimin në grup dhe në vend të personave të tjerë, autoritetet duhet të zbatojnë masa mbrojtëse procedurale efektive. 4. Për të garantuar një kuadër zgjedhor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të gjitha subjektet vendimmarrëse, duke përfshirë parlamentin, partitë e tij politike dhe palët e tjera të interesuara zgjedhore, duhet të angazhohen për një reformë zgjedhore kuptimplotë dhe për adresimin e të gjitha rekomandimeve të ODIHR-it. 5. Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t'i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë. 6. Autoritetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të Ligjit për të Drejtën e Informimit, të dekriminalizojnë shpifjen dhe të mbështesin gazetarinë e pavarur. 7. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore, duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të sistemit të emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të administratës zgjedhore të nivelit të ulët. Duhet të merren masa për të ndaluar zëvendësimet arbitrare të anëtarëve të administratës zgjedhore. 8. Përdorimi nga media i materialeve të prodhuara nga partitë ose autoritetet shtetërore në programet e lajmeve dhe informacionit duhet të shmanget ose të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Sa herë që transmetohen materiale të tilla, duhet të identifikohen qartësisht si përmbajtje e prodhuar nga garuesit politikë siç kërkohet me ligj. Për shkeljet që lidhen me kërkesat e ligjit për identifikimin e këtyre materialeve të gatshme duhet të parashikohen sanksione dhe duhet të zbatohen.

Si shihet numri i rekomandimeve prioritare në raportin për zgjedhjet lokale, 2023 është dyfishuar në krahasim

me numrin e këtyre rekomandimeve të dhëna në raportin për zgjedhjet parlamentare, 2021. Midis këtyre dy grup rekomandimesh ka rekomandime që ne përmbajten e tyre dhe objektivin që synohet të arrihet nga zbatimi i tyre nuk kanë diferenca thelbësore. Të dy theksojnë nevojën për rregullimet ligjore që duhet të bëhen dhe për angazhimin për zbatimin e ligjit për të gjithë institucionet dhe aktorët e ndryshëm që marrin pjesë dhe kanë detyra për të kryer në kuader të procesve zgjedhore.

Në krahasim me rekomandimet prioritare të formuluar në Raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, 2021, në raportin për zgjedhjet lokale 2023, rekomandimet që trajtojnë çështje të fenomenit të shitblerjes së votes, përdorimit të aseteve publike, të drejtën e informimit, qëndrueshmërisë së administratës zgjedhore dhe rolit të medias në fushatën zgjedhore janë formuluar në formën që e thekson akoma edhe me shumë rëndësi për ndërhyrjet për ndryshime në legjislacion dhe për kujdesin e vullnetin që duhet të tregohet nga partitë politike, ligjbërësi, institucionet qeverisëse qëndrore e lokale, institucionet ligjzbatuese dhe qytetarët për zbatimin e ligjit.

Duke ju referuar të përbashkëtave dhe dallimeve midis rekomandimeve prioritare të formuluar të publikuara në dy raportet e fundimit të misioneve të vëzhguesve nderkombëtarë të OSBE/ODIHR arrijnë të identifikohen pa vështirësi prioritete që duhet të kenë në punën e tyre organizatat e shoqërisë civile për t'ju përgjigjur me sukses dhe në mënyrë efektive detyrës së tyre si aktorë të rëndësishëm për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në vendin tone. Midis këtyre prioriteteve mund të dallohen si kryesore angazhimi i organizatave të shoqërisë civile në:

-nxitjen dhe mbështetjen e qytetarëve për t'u organizuar në lëvizje qytetare që targetojnë nisma ligjvënëse për mirë rregullimin e legjislacionit zgjedhor, në përputhje edhe me rekomandimet e dhëna në raportet e misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të **OSBE/ODIHR**

-zhvillimin e kapaciteteve për organizimin dhe realizimin e fushateve të perhershme edukuese dhe informuese për qytetarët për t'ju bërë të njohur të drejta dhe detyrat e tyre që rrjedhin nga e drejta kushtetuese e votes.

-zhvillimin e kapaciteteve profesionale për monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore duke i trajtuar në mënyrë të barabartë dhe njelloj të rëndësishme të gjitha fazat e ciklit zgjedhor

- kërkimin e rrugëve dhe ndërtimin e instrumentave që do të shërbejnë për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset zgjedhore

-bashkërendimin e përpjekjeve për parandalimin e fenomenit të shitblerjes së votës, në vecanti duke punuar me zgjedhësit në komunitetet e marginalizuara.

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime të tjera	
Sistemi zgjedhor 6. Për të respektuar parimin e mundësive të barabarta, duhet të rishikohet pragumbarë kombëtar prej 1 përqind për kandidatët e pavarur. Kuadri ligjor 7. Për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin efikas të zgjedhjeve, aktet e detyrueshme nënligjore duhet të jenë në përputhje me legjislacionin primar dhe të miratohen në kohë.	Kuadri ligjor 9. Aktet nënligjore që rregullojnë procesin zgjedhor duhet të miratohen në kohën e duhur për të garantuar siguri juridike, përgatitje efektive dhe njohjen e tyre nga publiku.

Dispozita që përcaktonte pragu kombëtar 1 përqind për kandidatët e pavarur është shfuqizuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim duhet të pasqyrohet me ndryshimet që duhet të bëhen në Kodin zgjedhor.

Rekomandimi në vijim është i përsëritur. Për plotësimin e tij është i nevojshëm angazhimi i Komisionit Regullator, i cili pavarësisht se rekomandimi është pjesë e raportit për zgjedhjet parlamentare, 2021, si pasojë e sjelljes politike të antarëve të tij, nuk është zbatuar.

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime te tjera	
Administrimi zgjedhor 8. Për të forcuar transparencën dhe për të shmangur çdo vonesë në administrimin e zgjedhjeve, KQZ-ja duhet të publikojë një kalendar gjithëpërfshirës zgjedhor me afatet përkatëse, duke përfshirë miratimin e akteve nënligjore, për trajnimin dhe detyrat logjistike. 9. Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, duhet të sigurohet koha dhe burimet e përshtatshme për përgatitjen efektive dhe për mundësi kuptimplota për vëzhgimin publik dhe të pavarur të teknologjive zgjedhore. Në rast të përdorimit të votimit elektronik në shkallë më të gjerë, duhet të merret në konsideratë aplikimi i metodave të verifikimit si auditimet e kufizimit të rrezikut. 10. Për të shmangur zhvlerësimin e qëllimshëm të fletëve të votimit dhe për të rritur besimin në procesin zgjedhor, autoritetet duhet të investojnë në programe të edukimit të votuesve në kohën e duhur dhe të përshtatura sipas kategorive të ndryshme të votuesve. Regjistrimi i zgjedhësve 11. Për të siguruar të drejtën universale të votës dhe trajtimin e barabartë para ligjit, duhet të hiqen kufizimet për shkak të aftësive të kufizuara, kurse detyrimi për regjistrimin e votuesve mbi 100 vjeç duhet t'i takojë shtetit. 12. Autoritetet lokale duhet të sigurohen që të gjithë votuesit të informohen në kohën e duhur për vendin dhe kohën e shqyrtimit të listës së zgjedhësve dhe për vendndodhjen e qendrave të tyre të votimit. Mund të shihet mundësia e zhvendosjes së afateve të njoftimit të zgjedhësve më afër ditës së zgjedhjeve	Administrata zgjedhore 10. Administrata zgjedhore, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të përpiqen t'i përmirësojnë më tej programet për edukimin e zgjedhësve, veçanërisht në nivel qarku. Mund t'i kushtohet vëmendje përshtatjes së iniciativave për nevojat e pakicave kombëtare, veçanërisht romëve dhe egjiptianëve, dhe zgjedhësve me aftësi të kufizuara. 11. Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, burime të mjaftueshme duhet të shpërndahen paraprakisht për të garantuar përgatitje efektive dhe monitorim të pavarur dhe kuptimplotë nga publiku të teknologjive zgjedhore. 12. Autoritetet duhet t'i njohin më mirë zgjedhësit me teknologjitë zgjedhore dhe të ofrojnë akses të barabartë në procesin e votimit. Duhet të merren masa për t'u mundësuar zgjedhësve që përdorin teknologji të reja të votojnë në mënyrë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë. 13. Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet për garantimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor. Regjistrimi i zgjedhësve 14. Për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, kufizimet e bazuara në aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale duhet të hiqen. 15. Autoritetet duhet t'i informojnë të gjithë zgjedhësit për vendndodhjen e qendrave të tyre përkatëse të votimit dhe t'i afishojnë vazhdimisht listat e zgjedhësve në të gjitha bashkitë. Duhet të merret parasysh zhvendosja e afatit për njoftimin e zgjedhësve më afër ditës së zgjedhjeve. 16. Mund t'i kushtohet vëmendje rekrutimit dhe trajnimit të operatorëve teknikë përgjegjës për identifikimin elektronik të zgjedhësve në kohën e duhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të shohë mundësinë e kryerjes së një auditimi të pavarur të pajisjeve dhe softuerit përpara ditës së zgjedhjeve.

Analiza krahasuese e këtyre rekomandimeve evidenton faktin se, në thelbin e tyre ka të përbashkëta lehtësisht të identifikueshme. Kjo është pasojë e faktit se zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, 2023, u zhvilluan me po të njëjtin Kod zgjedhor që u zhvilluan zgjedhjet parardhëse për Kuvendin e Shqipërisë. Ky fakt nënvizon nevojën dhe vlerën që ka realizimi i reformës zgjedhore për pasqyrimin në legjislacionin zgjedhor të rekomandimeve që japin vëzhguesit ndërkombëtar të OSBE/ODIHR.

Veç sa më sipër, duke qënë se në një pjesë të konsiderueshme, këto rekomandime, në mënyrë të përsëritur, nënvizojnë nevojën e angazhimit të shoqërisë civile për të kontribuar në parandalimin e fenomeneve që janë objekt i këtyre rekomandimeve, tregon se edhe shoqëria civile, organizatat që në punën e tyre targetojnë çështje dhe probleme që lidhen me të drejtën e votës dhe me proceset zgjedhore, nuk kanë arritur të jenë në nivelin e detyrës dhe përgjegjësisë që deklarojnë se marrin përsipër. Për pasojë, prioritet aktual për organizatat e shoqërisë

civile duhet të jetë formulimi i metodologjisë së punës, ndertimi i instrumentave dhe zhvillimi i kapaciteteve të tyre, me objektiv angazhimin sa më efektiv në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve që lidhen me të drejtën e zgjedhjes dhe për t'u zgjedhur, si dhe për zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike. Prioritet për këto organizata duhet të jetë monitorimi, vëzhgimi dhe vlerësimi i të gjitha fazave të ciklit zgjedhor dhe jo vetëm fushata zgjedhore, dita e zgjedhjeve dhe nxjerrja e rezultatit.

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime të tjera	
Regjistrimi i kandidatëve 13. Mundësia e kandidimit të liderëve të partive politike në disa zona zgjedhore duhet të rishikohet për të ruajtur parimin e barazisë. 14. Duhet të hiqen kufizimet e së drejtës së kandidimit të personave të deportuar dhe objekt të një urdhri arresti, fajësia e të cilëve nuk është vërtetuar me vendim gjykatë. 15. Për të garantuar sigurinë juridike, mund të shihet mundësia e rishikimit të dispozitave në lidhje me numrin maksimal të kandidatëve në lista dhe renditjen e kandidatëve të gjinive të ndryshme.	Regjistrimi i kandidatëve 17. Duhet të hiqen kufizimet e të drejtës së kandidimit të personave, fajësia e të cilëve për kryerjen e një veprë penale nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. 18. Duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të pragut për mbështetjen e zgjedhësve për të garantuar të njëjtat kushte të zbatueshme për kandidatët e pavarur dhe atyre të propozuar nga partitë. 19. Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë zgjedhjet për kryebashkiakë, autoritetet në të gjitha nivelet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse ligjore, institucionale dhe edukative për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Partitë politike duhet të identifikojnë dhe kufizojnë çdo pengesë të mundshme me bazë gjinore për kandidatet gra, duke përfshirë rishikimin e praktikave aktuale brenda partive që e pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave partiake dhe si kandidate.

Ndër këto rekomandime bie në sy rekomandimi në raportin për zgjedhjet 2021, që trajton nevojën për zbatimin e parimit të barazisë në kandidim. Ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, në reformën e fundit zgjedhore, Qershor 2020, i dhanë të drejtën vetëm kryetarëve të partive që të jenë kandidatë në listat shumëemërore deri në katër njësi zgjedhore. E drejta e kryetarëve për të kandiduar në disa njësi zgjedhore ka qenë e parashikuar në Kodin zgjedhor. Në zbatim të rekomandimeve të përsëritura të vëzhguesëve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias kjo e drejtë u hoq nga Kodi zgjedhor. Ndryshimet e bëra në Qershor 2020 e rifutën këtë dispozitë me ndryshim se e drejta e kandidimit kufizohet vetëm në deri katër njësi zgjedhore. Ky është një argument që tregon qartë se sjellja e partive politike, dukshëm synon të realizojë një legjislacion zgjedhor që të jete sa më shumë dhe sa më mirë në shërbim të interesave të tyre dhe jo si mundësi për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe në shërbim të qytetarëve e mirëqeverisjes së vendit.

Rekomandimet e tjera në të dy raportet, në lidhje me çështjet e regjistrimit të kandidatëve, synojnë që në Kodin Zgjedhor e drejta për të kandiduar të trajtohet në përputhje me parimin e barazisë për t'u zgjedhur si parashikohet edhe në Kushtetutën e Republikës. Si reagimi ndaj këtyre rekomandimeve mund të përmendet vetëm vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar kërkesën për prapësim kombëtar 1 për qind që Kodi zgjedhor parashikon edhe për kandidatët e pavarur.

Ndër këto rekomandime tërheq vëmendjen rekomandimi që trajton problemin e kandidimit të grave e vajzave. Mënyra se si vëzhguesit ndërkombëtar rekomandojnë që të trajtohet ky problem, mund të shërbejë si baza mbi të cilën organizata e shoqërisë civile mund të ndërtojnë aksionin e tyre për veprim në plotësim të objektivës që synon të arrijë ky rekomandim.

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime te tjera	
Fushata zgjedhore 16. Organet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, përfshirë shpërdorimin e burimeve shtetërore, në mënyrë të plotë, në kohë dhe në mënyrë transparente. Votuesit duhet të informohen sistematikisht në lidhje me mekanizmat e zbatueshëm për të raportuar çdo rast presioni dhe të jenë të sigurt se nuk do të përballen me pasoja negative. Financimi i fushates 17. Autoritetet duhet të marrin në konsideratë ndryshimet ligjore për të zgjeruar rregulloret dhe kufijtë e dhurimeve dhe shpenzimeve, siç janë caktuar për partitë politike, që ato të aplikohen edhe për palët e treta. 18. Në mënyrë që të rritet përgjegjësia e partive politike dhe transparencja e përgjithshme e procesit zgjedhor, duhet të merret në konsideratë që t'u kërkohej garuesve të zbulojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre të fushatës para ditës së zgjedhjeve. 19. Duhet të zhvillohet aftësia e KQZ-së për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat ligjore në lidhje me mbikëqyrjen e financimit të fushatës. Media 20. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'u garantuar mundësi të barabarta aksesit në media të gjitha palëve garuese, duke përfshirë edhe hapësirën për reklamim. Konsiderata shtesë mund të jepen për alokimin e një sasive të caktuar të kohës së transmetimit falas në mënyrë të barabartë për të gjithë garuesit gjatë fushatës. Pjesëmarrja e pakicave kombëtare 21. KQZ-ja dhe palët e tjera të interesuara duhet të vazhdojnë programet e edukimit të zgjedhësve të përshtatura për nevojat e pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane. Mund të bëhen përpjekje shtesë nga autoritetet për të lehtësuar aplikimin ose rinovimin e kartave të identitetit nga votuesit në nevojë.	Financimi i fushatës 20. Vendimet për ndarjen dhe transferimin e fondeve publike për partitë politike përfituese duhet të merren në kohën e duhur për të garantuar akses efektiv në këto fonde për qëllime të fushatës. Mund t'i kushtohet vëmendje zgjerimit të financimit publik të fushatës për kandidatët e pavarur. 21. Për të rritur transparencën, duhet të ketë publikime periodike të kontributeve financiare dhe shpenzimeve për fushatë përpara ditës së zgjedhjeve. Media 22. Autoritetet shtetërore duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe vërtet të larmishëm, pa ndikime nga politika dhe biznesi. Parlamenti duhet ta ndryshojë Ligjin për mediat audiovizive për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së mediave në sektorin e transmetimit dhe të paraqesë masa për të parandaluar ndikimin e padrejtë të pronarëve të mediave mbi politikën editoriale. 23. Rregullat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese. 24. Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të pajiset me burime të mjaftueshme materiale dhe teknike për të rritur kapacitetin e tij monitorues dhe raportues të medias.

Rekomandimet e dhëna në të dy raportet për fushatën zgjedhore dhe financimin e saj janë reflektim i ndërkombëtarëve ndaj fenomeneve që kanë vëzhguar për këto dy çështje të cilat kanë efekte thelbësore në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Duke ju referuar Rekomandimeve prioritare të dhëna prej tyre, mund të pohojmë se nëpërmjet rekomandimeve të formuluar për fushatën zgjedhore, financimin e saj dhe rolin e mediave, ndërkombëtarët kanë propozuar elementet përbërës thelbësor të një plani veprimi që duhet të zhvillojë dhe të realizojnë trupa legjislativë shqiptarë dhe institucionet e tjera publike dhe të shoqërisë civile. Këto rekomandime, aktualisht kanë orientuar punën që paraprin formulimin dhe miratimin e ndryshimeve që duhet të bëhen në legjislacionin shqiptar, Kodin zgjedhor, Ligjin për partitë politike dhe në kuadrin tjetër ligjor që ka prerje me çështje të financimit të partive politike. Pjesë aktive e këtij procesi kanë qënë dhe janë edhe organizatat e shoqërisë civile.

Angazhimi i tyre në tryeza diskutimi për gjetjen e rrugëzgjdhjeve më efektive për zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe rekomandimeve të tjera të formulara prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR për fushatën zgjedhore dhe financimin e saj, nuk kanë munguar. Ndërkohë në situatën kur reagimi i trupës legislative dhe i partive politike për realizimin e ndryshimeve që kërkohen në legjislacion zgjedhor dhe në kuadrin tjetër rregullues nuk ka arritur të materializohet, është e nevojshme që reagimit të organizatave të shoqërisë civile t'i shtohet një komponent që gjeneron presion si pasojë e veprimit sinergjik qytetar. Një ndër rrugët që mund të përdoren prej tyre është organizimi dhe veprimi qytetar që mbështetet në të drejten kushtetuese për nisma qytetare ligjvënese.

Zgjedhjet parlamentare, 2021	Zgjedhjet vendore, 2023
Rekomandime të tjera	
Ankesat dhe apelimet 22. Mund të shihet mundësia e rishikimit të ligjit në mënyrë që të qartësohet përgjegjësia për ankesat kundër vendimeve të KQV-ve dhe ato që lidhen me shkëljet e fushatës, si dhe për të eliminuar kufizimet e padrejta të legjitimitetit për ankim. 23. Siç përshkruhet nga Kodi Zgjedhor, të gjitha vendimet përkatëse të lidhura me zgjedhjet, përfshirë ato në lidhje me sanksionet, duhet të rishikohen nga Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve dhe nga Kolegji Zgjedhor	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore 25. Për të garantuar sigurinë juridike dhe një zgjidhje juridike efektive, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve duhet të sigurojë një vendimmarrje uniforme, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme. 26. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe ankimet në kohën e duhur dhe të jetë i përgatitur siç duhet dhe të ketë burimet për ta bërë këtë. Për të garantuar transparencë, të gjitha vendimet për mosmarrëveshjet zgjedhore duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

Rekomandimet për rregullimet që duhet të bëhen në Kodin zgjedhor në lidhje me ankesa dhe apelimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore tregojnë se, në përgjithësi legjislacioni i trajton këto çështje në përputhje dhe sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare. Ndërkohë është e rëndësishme të theksohet se, në praktikë zbatimi i këtij legjislacioni është perballuar me situata që nuk janë pasojë e mënyres se si ky legjislacion i trajton këto çështje. Në një masë të konsiderueshme të tyre, këto situata kanë qënë rrjedhojë e efektit të preferencës politike të antarëve të trupave që shqyrtojnë dhe gjykojnë ankesat dhe që legjislacioni i thërret për të zgjidhur mosmarrëveshjet zgjedhore. Kjo e bën të domosdoshme angazhimin e organizatave të shoqërisë civile për monitorimin dhe vlerësimin e procesve të shqyrtimit dhe gjykimit të ankesave dhe mosmarrëveshjeve zgjedhore. Natyrisht në këtë proces duhet të përfshihen vetëm organizatat që zotërojnë performanca profesionale dhe kanë ekspertizë të formuar për vlerësimin e mënyrës dhe cilësisë së trajtimit të këtyre çështjeve.

6.3 Prëmbledhje e Rekomandimeve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet 2021 dhe 2023 dhe statusi i implementimit të tyre.

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR ZGJEDHJET VENDORE, 2023	Tipologjia	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
1	Rishikimi i legjislacionit zgjedhor për të shmangur 'gabimet' e bëra gjatë zgjedhjeve parlamentare 2021	Prioritet	Progres i pamjaftueshëm	Kuvendi nuk arriti të realizonte rishikimin e legjislacionit zgjedhor, veprimtaria e Komisionit Ad hoc për reformën zgjedhore nuk arriti të jepte rezultatet e kërkuara nga OSBE/ODIHR. Kuvendi miratoi vetëm ndryshime në Kodin Zgjedhor që kushtëzoheshin prej vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me votimin nga jashtë territorit të vendit dhe shfuqizimin e herësit për shpërndarjen e mandateve midis kandidatëve të subjektit zgjedhor të kushtëzuar nga votat parapëlqyese.
2	Organet e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, duke përfshirë blerjen e votës, presionin ndaj zgjedhësve dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, në mënyrë tërësore, në kohën e duhur dhe me transparencë. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj pasojave të denoncimit.	Prioritar	Progres i pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon angazhimin për: <i>Ndryshime në kuadrin ligjor:</i> <i>Kuvendi i Shqipërië</i> nuk bëri asnjë ndryshim në Kodin Zgjedhor ose në Kodin Penal. Në legjislacionin që trajton çështje të detyrave dhe funksionimit të institucioneve ligjzbatuese për parandalimin, identifikimin dhe dënimin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet nuk është bërë asnjë ndryshim. Nuk janë bërë ndryshimet ligjore për të rritur transparencën e burimeve të financimit të partive politike. Nuk janë bërë ndryshime ose plotësime në legjislacion për të rritur efektivitetin në zbatimin e mekanizmave që mund të përdoren për parandalimin e këtyre fenomeneve dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve. <i>Informim, edukim dhe sensibilizim</i> <i>KQZ-Komisioneri shtetëror</i> dhe organizata të Shoqërisë civile janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve për informimin, edukimin zgjedhor dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për nevojën e veprimit aktiv ndaj fenomeneve të shkeljes së legjislacionit për zgjedhje.

3	Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e hershëm të blerjes së votës dhe rreziket që sjell ajo për integritetin e zgjedhjeve. Denoncimi publik i praktikave të tilla para dhe gjatë fushatës nga aktorët kryesorë, duke përfshirë zyrtarët shtetërorë dhe drejtuesit e partive, mund të shërbejë për frenimin e këtij fenomeni.	Prioritar	Progres i Moderuar	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk kërkon të bëhen ndryshime në legjislacion. Për të zvogëluar këtë fenomen është e nevojshme angazhimi i KQZ dhe shoqërisë civile. KQZ ka organizuar dhe zhvillon aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin të zgjedhësve për qëndrim dhe reagim ndaj fenomenit të shitblerjes së votës. Shoqëria civile është e angazhuar në denoncimin e fenomeneve të shitblerjes së votës, edukimin e zgjedhësve dhe nxitjen e institucioneve ligjzbatuese për dënimin e personave që konsumojnë veprën penale të shitblerjes së votës. Reagimi i institucioneve ligjzbatuese ndaj këtij fenomeni nuk ka arritur t'i përgjigjet intensitetit të shtuar të tij. Perceptimet për punën dhe efektin e këtyre institucioneve si instrumenta thelbësor në luftën kundër këtij fenomeni është larg pritshmërive.
4	Për të garantuar fshehtësinë e votës dhe për të parandaluar presionin ndaj zgjedhësve, votimin në grup dhe në vend të personave të tjerë, autoritetet duhet të zbatojnë masa mbrojtëse procedurale efektive.	Prioritar	Progres i Moderuar	<i>KQZ-Komisioni rregullator</i> ka arritur të hartojë një set rregullash dhe procedurash që duhet të zbatohen me synim rritjen e garantimit të fshehtësisë së votës. Zbatimi, si i projekteve pilot për identifikimin biometrik të zgjedhësve dhe votimi elektronik janë mudësi të reja që ndikojnë në plotësimin e standardit për fshehtësinë e votës, votimin me dokumenta identitetit të personave të tjerë dhe zvogëlimin e fenomenit të votimit familjar.
5	Për të garantuar një kuadër zgjedhor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të gjitha subjektet vendimmarrëse, duke përfshirë parlamentin, partitë e tij politike dhe palët e tjera të interesuara zgjedhore, duhet të angazhohen për një reformë zgjedhore kuptimplotë dhe për adresimin e të gjitha rekomandimeve të ODIHR-it.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Megjithë deklaratimet e përsëritura të partive politike për angazhimin e tyre për të realizuar reformën zgjedhor, objekt i të cilës janë rekomandimet e dhëna në raportet e misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR, aktualisht një reformë e tillë nuk është kryer.

6	Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t'i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Aktualisht nuk është bërë asnjë ndërhyrje legislative për të rregulluar më mirë dhe për t'i bërë me efektive dispozitat e parashikuara në Kodin zgjedhor për financimin e fushatës dhe përdorimit të aseteve publike. Nuk ka nisma të trupës legislative për ndryshime në legjislacion, Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike dhe për financimin e tyre. Nuk janë bërë rregullimet e kërkuar ligjore për të krijuar kushte për rritjen e transparencës në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Efekt pozitiv në përpjekjet që synojnë zvogëlimin e hapsirave për keqpërdorimin e aseteve publike ka sjellë puna e bërë nga Komisioneri shtetror dhe angazhimi efektiv dhe intensiv i organizatave të shoqërisë civile për denoncimin dhe dënimin e këtij fenomeni. Në vijim është e domosdoshme që të realizohen ndryshimet e kërkuara në legjislacionin që trajton çështje të financimit të partive politike dhe fushatave të tyre zgjedhore. Duhet të theksohet se aktualisht, për këtë çështje të rëndësishme, shoqëria civile ka qënë e angazhuar në mënyrë intensive dhe ka hartuar dhe paraqitur propozime konkrete. Me vlerë janë edhe rezultatet e arritura në aktivitetet që ka organizuar KQZ për problemet e financimit të partive politike.
7	Autoritetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të Ligjit për të Drejtën e Informimit, të dekriminalizojnë shpifjen dhe të mbështesin gazetarinë e pavarur.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon angazhim për rregullime në legjislacion dhe për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësim qytetar. Rregullimet dhe amendimet në legjislacion duhet të synojnë zvogëlimin e hapsirave për përdorimin e shpifjes në funksion të garës elektorale dhe për të mbështetur gazetarinë e pavarur. Është e nevojshme që Komisioneri për të Drejtën e Informimit, në bashkëpunim edhe me KQZ të angazhohet në mënyrë me efektive për të ndërtuar instrumenta dhe rrugë për rritjen e cilësisë në informimin e publikut. Angazhimit dhe kontributit të Shoqërisë civile duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

8	Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore, duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të sistemit të emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të administratës zgjedhore të nivelit të ulët. Duhet të merren masa për të ndaluar zëvendësimet arbitrare të anëtarëve të administratës zgjedhore.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Përpijekja e parë për të ndryshuar parimin dhe rregullat sipas të cilit formohen komisionet zgjedhore janë ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, në 2020, për strukturën dhe mënyrën e zgjedhjes së antarëve të KQZ. Megjithë këtë, është e rëndësishme të theksohet se edhe këto ndryshime, të cilat krijojnë kushte për të depolitizuar këtë institucion, nuk u zbatuan, sepse partitë politike ranë dakort që formimi i i KQZ të bëhej duke zbatuar, për këtë qëllim dispozitat kalimtare të përfshira në Kodin zgjedhor. Shfuqizimi i nenit 183, me ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, Korrik, 2024 e përforcuan akoma edhe më shumë qëndrimin refraktar të partive politike ndaj këtij rekomandimi të OSBE/ODIHR. Partitë politike, PS e PD nuk kanë shprehur asnjë angazhim ose vullnet për të ndryshuar parimin dhe rregullat sipas të cilave ndërtohen aktualisht komisionet e nivelit të dytë e të tretë dhe grupet e numërimit të votave. Të gjithë antarët e kësaj administrate caktohen mbi bazën e propozimeve të partive politike. Për ndërtimin e tyre përdoret parimi i përfaqësimit dhe balancimit politik. Pavaresisht nga kërkesa e përsëritur e vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR për rishikimin e të drejtës së partive politike për të shkarkuar, pa dhënë asnjë arsye, kur të duan, antarë të komisioneve zgjedhore, neni 32. pika 2(d), kjo dispozitë vazhdon të mbetet në fuqi. Partitë politike janë të vendosura dhe këmbëngulëse për të mos e ndryshuar këtë dispozitë.
---	---	-----------	--------------------------------	---

9	Përdorimi nga media i materialeve të prodhuara nga partitë ose autoritetet shtetërore në programet e lajmeve dhe informacionit duhet të shmanget ose të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Sa herë që transmetohen materiale të tilla, duhet të identifikohen qartësisht si përmbajtje e prodhuar nga garuesit politikë siç kërkohet me ligj. Për shkeljet që lidhen me kërkesat e ligjit për identifikimin e këtyre materialeve të gatshme duhet të parashikohen sanksione dhe duhet të zbatohen.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Kodi zgjedhor aktual përmban dispozita që lejojnë radio televizionin publik dhe ato private të transmetojnë, në programet e lajmeve, materiale të prodhuara nga partitë, pa vendosur kushte që arrijnë të minimizojnë përdorimin e këtyre materialeve. I vetmi kusht që Kodi zgjedhor parashikon është detyrimi që materialet të shoqërohen me informacionin për subjektin që e ka prodhuar. Vëzhguesit ndërkombëtar e kanë përfshirë këtë ndër rekomandimet prioritare sepse sipas vlerësimit të tyre, parashikimi i kësaj të drejte për partitë politike bie ndesh me të drejtën dhe misionin e medias për të informuar, në mënyre objektive publikun. Kodi Zgjedhor ngarkon Autoritetin e Mediave Audivizive për të monitoruar pasqyrimin fushatës zgjedhore në median audiovizive dhe KQZ-në për të shqyrtuar dhe miratuar raportet periodike të këtij autoriteti dhe për të vendosur sanksionet përkatëse në rastet e shkeljeve që ky autoritet konstaton. Ky rekomandim rritet qendrimin e përsëritur të OSBE/ODIHR.
10	Aktet nënligjore që rregullojnë procesin zgjedhor duhet të miratohen në kohën e duhur për të garantuar siguri juridike, përgatitje efektive dhe njohjen e tyre nga publiku.	Të tjera	Progres i Munguar	Ky është një rekomandim i përsëritur që ju adresohet partive politike dhe Kuvendit, i cili si rregull nuk është zbatuar. Pavarsisht se pas zgjedhjeve lokale, 2023 Kuvendi ngriti menjëherë Komisionin për Reformën zgjedhore, ky Komision nuk realizoi asnjë produkt. Mundësitë për të bërë ndryshime në Kodin Zgjedhor për pasqyrimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR zvogëlohen përherë e më shumë sepse dita e zgjedhjeve po afron. Ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor në korrik, 2024 kanë trajtuar vetëm çështje të votimit nga jashtë territorit të vendit dhe votimin me votë parapëlqyese. Koha kur u bënë këto ndryshime i bënë ato realisht të zbatueshme duke plotësuar edhe kërkesat që lidhen me këtë rekomandim të OSBE/ODIHR.

11	Administrata zgjedhore, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të përpiqen t'i përmirësojnë më tej programet për edukimin e zgjedhësve, veçanërisht në nivel qarku. Mund t'i kushtohet vëmendje përshtatjes së iniciativave për nevojat e pakicave kombëtare, veçanërisht romëve dhe egjiptianëve, dhe zgjedhësve me aftësi të kufizuara.	Të tjera	Progres i Kënaqshëm	Aktualisht KQZ, me mbështetjen financiare të donatorëve të huaj është angazhuar në një proces intensiv informimi dhe edukimi të zgjedhësve. Zyra e prezencës së OSBE në Tiranë ka nxitur angazhimin e donatorëve për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Ka nisma nga ambasada të vendeve të ndryshme, ambasada angleze, holandeze, suedeze etj.. për të mbështetur projekte që targetojnë çështje të pjesmarrjes në zgjedhje të pakicave kombëtare, votuesve që ju përkasin grupeve të marginalizura, zgjedhësve me aftësi ndryshe. Është e domosdoshme që të rritet cilësia e punës dhe niveli i organizimit dhe bashkëveprimit midis organizatave të ndryshme, të shtrihen aktivitetet për informimin, edukimin dhe nxitjen e qytetarve në zonat rurale për pjesmarrje në zgjedhje. Është e domosdoshme diversifikimi i mbështetjes nga donatorët për organizatat e shoqërisë civile.
12	Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, burime të mjaftueshme duhet të shpërndahen paraprakisht për të garantuar përgatitje efektive dhe monitorim të pavarur dhe kuptimplotë nga publiku të teknologjive zgjedhore	Të tjera	Progres i Munguar	Aktualisht nuk ka asnjë nismë për mbështetjen e monitorimit dhe vëzhgimit të procesit për përgatitjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në zgjedhje. Është e nevojshme që donatorë të huaj ose edhe KQZ të mbështesin nisma të organizatave të shoqërisë civile, por jo vetëm, që kanë ekspertizë në zbatimin e teknologjise së informacionit për të monitoruar dhe vlerësuar këtë proces.
13	Autoritetet duhet t'i njohin më mirë zgjedhësit me teknologjitë zgjedhore dhe të ofrojnë akses të barabartë në procesin e votimit. Duhet të merren masa për t'u mundësuar zgjedhësve që përdorin teknologji të reja të votojnë në mënyrë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.	Të tjera	Progres i Moderuar	Në planin e punës së KQZ për zbatimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje janë parashikuar aktivitete për informimin e zgjedhësve. Pjesë e këtij procesi informimi duhet të jenë edhe organizatat e shoqërisë civile. Informimi është i nevojshëm të bëhet për: -Përdorimin e teknologjise së informacionit për identifikimin biometrik të zgjedhësve – Kjo mënyrë identifikimi do të zbatohet në të gjithë territorin e vendit. -Përdorimi i teknologjise së informacionit për votimin elektronik në qendrën e votimit – Ky votim do të zbatohet vetëm në qarkun e Elbasanit dhe Durrësit.

14	Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet për garantimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.	Të tjera	Progres i Moderuar	KQZ si edhe në zgjedhjet të mëparshme, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore angazhohet për të krijuar kushte në qendrat e votimit që do të bëjnë të mundur aksesueshmërinë për të votuar për personat me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në lëvizje. Është i nevojshëm organizimi i procesit të monitorimit dhe vëzhgimit të përgatitjeve për plotësimin e kësaj kërkesë nga organizata të interesuara përpara ditës së zgjedhjeve. Monitorimi i listës së zgjedhësve me aftësi ndryshe që hartohet nga Komisioni i qendrës së votimit është proces që duhet të shoqërojë realizimin e këtij rekomandimi të Misionit të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR.
15	Për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, kufizimet e bazuara në aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale duhet të hiqen.	Të tjera	Progres i Munguar	Mos realizimi i reformës zgjedhore e bënë të pazbatueshëm këtë rekomandim.
16	Autoritetet duhet t'i informojnë të gjithë zgjedhësit për vendndodhjen e qendrave të tyre përkatëse të votimit dhe t'i afishojnë vazhdimisht listat e zgjedhësve në të gjitha bashkitë. Duhet të merret parasysh zhvendosja e afatit për njoftimin e zgjedhësve më afër ditës së zgjedhjeve.	Të tjera	Progres i Pamjaftueshëm	Megjithëse në Kodin zgjedhor parashikohet detyrimi për organet e qeverisjes vendore për informimin me shkrim, derë më derë, të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit të tyre dhe numrin e tij rendor në listen e zgjedhësve, neni 52 "Njoftimi me shkrim mi zgjedhësit" ky detyrim, në përgjithësi nuk realizohet. Rekomandimi i OSBE/ODIHR për këtë çështje është i përsëritur.
17	Mund t'i kushtohet vëmendje rekrutimit dhe trajnimit të operatorëve teknikë përgjegjës për identifikimin elektronik të zgjedhësve në kohën e duhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të shoh mundësinë e kryerjes së një auditimi të pavarur të pajisjeve dhe softuerit përpara ditës së zgjedhjeve.	Të tjera	Progres i Pamjaftueshëm	Ky është një proces që realizohet nën përgjegjësinë e KQZ. Për të kryer një audit të pavarur duhet që KQZ të miratojë një akt-Udhëzim të veçantë, i cili duhet të shoqërohet edhe me koston financiare.

18	Duhet të hiqen kufizimet e të drejtës së kandidimit të personave, fajësia e të cilëve për kryerjen e një veprë penale nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të pragut për mbështetjen e zgjedhësve për të garantuar të njëjtat kushte të zbatueshme për kandidatët e pavarur dhe atyre të propozuar nga partitë.	Të tjera	Progres i Moderuar	Nuk ka kufizim për të drejtën e kandidimit për personat fajësia e të cilëve nuk është provuar me një vendim të formës së prerë. Duhet të ulet numri i mbështetësve prej max 3000 zgjedhës për kandidatin e pavarur në zonën zgjedhore përkatëse. Ndërkohë për kandidatët e listës së subjekteve zgjedhor parti politike kërkohet që kjo listë të ketë jo më pak se 5000 zgjedhës në shkallë kombëtare dhe për koalicionet jo më pak se 7000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Kodi aktual nuk parashikon kushte propocionale për kandidatët e pavarur dhe kandidatët e propozuar nga partitë politike.
19	Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë zgjedhjet për kryebashkiakë, autoritetet në të gjitha nivelet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse ligjore, institucionale dhe edukative për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Partitë politike duhet të identifikojnë dhe kufizojnë çdo pengesë të mundshme me bazë gjinore për kandidatet gra, duke përfshirë rishikimin e praktikave aktuale brenda partive që pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave partiake dhe si candidate.	Të tjera	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i kuotave gjinore vetëm për listat e kandidateve, 1 në 3 kandidatë për zgjedhjet parlamentare dhe 1 në 2 kandidatë për këshillat bashkiak nuk mjafton për mbështetjen e grave për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike. Aktualisht nuk ka asnjë propozim për mënyrën se si duhet të trajtohet ky problem në rastin e zgjedhjes së kryetarit të bashkisë. Organizata të shoqërisë civile kanë propozuar zgjidhje që rregullojnë, në mënyrë propocionale mbështetjen financiare dhe aksesin në media të grave /vajzave për zhvillimin e fushatës së tyre zgjedhore. Këto nuk janë pasqyruar në Kodin zgjedhor. Partitë politike nuk kanë miratuar ndryshime në statutin e tyre për të mirë rregulluar përfaqësimin e grave në strukturat e tyre partiake.
20	Vendimet për ndarjen dhe transferimin e fondeve publike për partitë politike përfituese duhet të merren në kohën e duhur për të garantuar akses efektiv në këto fonde për qëllime të fushatës. Mund t'i kushtohet vëmendje zgjerimit të financimit publik të fushatës për kandidatët e pavarur.	Të tjera	Progres i Munguar	Plotësimi i këtij rekomandimi mund të bëhet vetëm me ndryshime dhe shtesa përkatëse në Kodin Zgjedhor.

21	Për të rritur transparencën, duhet të ketë publikime periodike të kontributeve financiare dhe shpenzimeve për fushatë përpara ditës së zgjedhjeve.	Të tjera	Progres i Munguar	Plotësimi i këtij rekomandimi mund të bëhet me ndryshime dhe shtesa përkatëse në Kodin Zgjedhor. Megjithëse objektivi që synon ky rekomandim mund të realizohet edhe duke miratuar KQZ-ja një akt normativ, një udhëzim të veçantë.
22	Autoritetet shtetërore duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe vërtet të larmishëm, pa ndikime nga politika dhe biznesi. Parlamenti duhet të ndryshojë Ligjin për mediat audiovizive për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së mediave në sektorin e transmetimit dhe të paraqesë masa për të parandaluar ndikimin e padrejtë të pronarëve të mediave mbi politikën editoriale.	Të tjerat	Progres i Munguar	Ndryshime dhe shtesa në ligjin për mediat audiovizive private janë një rrugë që mund të ndiqet. Efekt të ndjeshëm mund të japin ndryshimet dhe shtesat që mund të bëhen në Kodin zgjedhor në dispozitat që trajtojnë të drejtën e partive politike për të pasqyruar fushatën e tyre elektorale ose për të dhënë mesazhe për zgjedhësit nëpërmjet transmetimit të kasetave të përgatitura prej tyre. Legjislacioni mund të parashikojë ashpërsim të penaliteteteve për pronarët e mediave në rastet e shkeljeve që identifikon AMA.
23	Rregullat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese.	Të tjera	Progres i Munguar	Zgjidhja në Kodin Zgjedhor e problemit që adreson ky rekomandim është rezultat i përvojave të mëparshme legjislative, të hartuara në përpunje me parimin e proporcionalitetit. Ndryshimet dhe zhvillimet intensive në median audiovizive, në veçanti median private dhe median sociale duhet të reflektohen në zgjidhjet që duhet të përfshihen në legjislacionin e ndryshuar i cili do të bëjë të mundur një ndarje më të drejtë të kohës në media të partive politike garuese në procesin zgjedhor.
24	Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të pajiset me burime të mjaftueshme materiale dhe teknike për të rritur kapacitetin e tij monitorues dhe raportues të medias.	Të tjera	Progres i Munguar	Nuk ka projekte për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknike e profesionale të AMA të nxitura nga nevoja për monitorimin më efektiv të pasqyrimin të fushatës zgjedhore në median audiovizive
25	Mund të shihet mundësia e rishikimit të ligjit në mënyrë që të qartësohet përgjegjësia për ankesat kundër vendimeve të KQV-ve dhe ato që lidhen me shkeljet e fushatës, si dhe për të eliminuar kufizimet e padrejta të legjitimitetit për ankim	Të tjera	Progres i Munguar	

26	Siç përshkruhet nga Kodi Zgjedhor, të gjitha vendimet përkatëse të lidhura me zgjedhjet, përfshirë ato në lidhje me sanksionet, duhet të rishikohen nga Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve dhe nga Kolegji Zgjedhor	Të tjera	Progres i Munguar	Kodi Zgjedhor parashikon vënien në funksion të KAS vetëm me kërkesë nga të interesuar dhe të prekur prej vendimmarrjes së Komisionerit shtetëror dhe Rregullatorit. Nuk ka asnjë nismë ligjore për të mundësuar aktivizimin e KAS kryesisht.
27	Për të garantuar sigurinë juridike dhe një zgjidhje juridike efektive, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet të sigurojë një vendimmarrje uniforme, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme.	Të tjera	Progres i Munguar	Zgjedhja e antarëve të KAS duke zbatuar dispozitat kalimtare të përfshira në Kodin Zgjedhor në reformën e zhvilluar në prag të zgjedhjeve palamentare, 2021 dhe ndryshimi i bërë në Kodin Zgjedhor në Korrik 2024, kanë krijuar hapsira për vendimmarrje në këtë komision të ndikuara nga preferencat politike të antarëve të tij, shfaqen e pasigurise juridike dhe arsyetime ligjore të paqëndrueshme.
28	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe ankimimet në kohën e duhur dhe të jetë i përgatitur siç duhet dhe të ketë burimet për ta bërë këtë. Për të garantuar transparencë, të gjitha vendimet për mosmarrëveshjet zgjedhore duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.	Të tjera	Progres i Kenaqshëm	KQZ është angazhuar për realizimin e këtij rekomandimi. Aktualisht mbledhjet e këtij institucioni dhe organeve përbërëse të tij janë të hapura për publikun, vendimet publikohen online dhe janë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit.

Nr	Rekomandimi OSBE / ODIHR ZGJEDHJET PARLAMENTARE, 2021	Tipologjia	Statusi i implementimit	Komente dhe shënime të tjera
1	Kuadri ligjor ka nevojë për rishikim të mëtejshëm për të adresuar rekomandimet e paadresuara të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias, si dhe një sërë paqartësish dhe mospërputhjes. Ndryshimet në ligj duhet të paraprihen nga një proces i hapur dhe gjithëpërfshirës konsultimi, dhe të miratohen përpara zgjedhjeve të ardhshme.	Prioritar	Progres i Munguar	Reforma e fundit zgjedhore u realizua përpara zgjedhjeve parlamentare, 2021. Detyruar nga situata politike e kohës, ndryshimet e bera në Kodin Zgjedhor ishin propozime të miratuara në Këshillin politik. Në këto ndryshime u pasqyruan një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të dhëna në Raportet e Misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e zhvilluara në periudhën 2013-2019. Ky rekomandim i përsëritur është trajtuar në mënyrë formale nga partit kryesore politike dhe Kuvendi i Shqipërisë.
2	Shteti duhet të garantojë të drejtën për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo dhe si ka votuar duhet të parandalohet.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Në Kodin Zgjedhor, të miratuar në Korrik dhe Tetor, 2020 janë bërë shtesa dhe ndryshime që lidhen me përmbajtjen e këtij rekomandimi të përsëritur edhe në raporte të mëparshme të vëzhguesve të OSBE/ODIHR. Pamjaftueshmëria e këtyre ndryshimeve kushtëzon nevojën për rregullime të mëtejshme në Kodin Zgjedhor dhe të ligjeve të tjera që trajtojnë çështje që lidhen me zgjedhjet si Ligji për partitë politike. Kodi Penal, ligjet organike të institucioneve ligjzbatuese.
3	Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të intensifikojnë përpjekjet për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e shitblerjes së votës. Qytetarët duhet të inkurajohen të raportojnë dhe të japin prova të çdo rasti të shitblerjes së votave apo të ushtrimit të presionit.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk kushtëzon zhvillimin e një procesi legjislativ. Zbatimi i tij kërkon forcimin dhe rritjen e kapaciteteve për funksionimin e shtetit ligjor, rritjen e kulturës për zbatimin e ligjit dhe për sjelljen e qytetarëve ndaj kërkesave të shtetit ligjor.

4	Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Institucionet përkatëse duhet të hetojnë dhe të sanksionojnë plotësisht çdo shkelje që ndikon në besimin e publikut në procesin zgjedhor.	Prioritar	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk kushtëzon zhvillimin e një procesi legjislativ. Mund të trajtohen vetëm aspekte ligjore që lidhen me penalitete që duhet të zbatohen në rastet e cënimit të sigurisë të të dhënave personale të qytetarëve. Proçesi për zbatimin e këtij rekomandimi duhet të zhvillohet si një proces i vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe në infrastrukturë të institucioneve.
5	Legjislacioni duhet të ndryshohet për t'u siguruar që mediat të jenë në gjendje të mbulojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e subjekteve zgjedhore me qëllim kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së prodhuar nga partitë në lajme.	Të tjera	Progres i Munguar	
6	Për të respektuar parimin e mundësive të barabarta, duhet të rishikohet pragu mbarëkombëtar prej 1 përqind për kandidatët e pavarur.	Të tjera	Realizuar	Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, e ka shfuqizuar dispozitën përkatëse. Ky vendim është pasqyruar edhe në Kodin Zgjedhor.
7	Për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin efikas të zgjedhjeve, aktet e detyrueshme nënligjore duhet të jenë në përputhje me legjislacionin primar dhe të miratohen në kohë.	Të tjera	Progres i Pamjaftueshëm	Rekomandimi i përsëritur për plotësimin e të cilit është e nevojshme që angazhimi i Komisionit Rregullator dhe vendimarrjet e tij të mos të jenë të ndikuara nga përkatësia politike e antarve të këtij komisioni.
8	Për të forcuar transparencën dhe për të shmangur çdo vonesë në administrimin e zgjedhjeve, KQZ-ja duhet të publikojë një kalendar gjithëpërfshirës zgjedhor me afatet përkatëse, duke përfshirë miratimin e akteve nënligjore, për trajnimin dhe detyrat logjistike.	Të tjera	Realizuar	Komisioneri shtetror i zgjedhjeve e bën publik kalendarin e punës. KQZ në mënyrë të vazhdueshme e paraprin procesin e diskutimit dhe vendimarrjen nga të gjithë strukturat e tij, Komisioneri shtetror, Rregullator dhe KAS, me informimin e publikut. Faqja e ëeb e KQZ është e aksesueshme për këdo dhe jep informacion për gjithë punët dhe vendimet që merren prej strukturave të KQZ-së.

9	Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, duhet të sigurohet koha dhe burimet e përshtatshme për përgatitjen efektive dhe për mundësi kuptimplota për vëzhgimin publik dhe të pavarur të teknologjive zgjedhore. Në rast të përdorimit të votimit elektronik në shkallë më të gjerë, duhet të merret në konsideratë aplikimi i metodave të verifikimit si auditimet e kufizimit të rrezikut.	Të tjera	Progres Kënaqshëm	Teknologjia e informacionit përdoret për: -Identifikimin biometrik të zgjedhësve në të gjithë qendrat e votimit. -Votimin elektronik si projekt pilot Sigurimi i transparencës për rritjen e besimit tek publiku aktualisht realizohet nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit prej KQZ të seancave demonstruese. Është e udhës të trajtohet mundësia për monitorimin dhe vlersimin paraprak të funksionimit të teknologjisë së informacionit në zgjedhje duke aktivizuar për këtë qëllim agjensit ose organizata të pavarura dhe të specializuara.
10	Për të shmangur zhvlerësimin e qëllimshëm të fletëve të votimit dhe për të rritur besimin në procesin zgjedhor, autoritetet duhet të investojnë në programe të edukimit të votuesve në kohën e duhur dhe të përshtatura sipas kategorive të ndryshme të votuesve.	Të tjera	Realizuar	KQZ por edhe organizata të pavarura të shoqërisë civile kanë organizuar dhe zhvilluar programe informimi dhe edukimi për zgjedhësit.
11	Për të siguruar të drejtën universale të votës dhe trajtimin e barabartë para ligjit, duhet të hiqen kufizimet për shkak të aftësive të kufizuara, kurse detyrimi për regjistrimin e votuesve mbi 100 vjeç duhet t'i takojë shtetit.	Të tjera	Realizuar	Në Kodin Zgjedhor nuk permbahen dispozita që vendosin kufizime për të drejtën e votës të lidhura me aftësitë e kufizuara si dhe për përjashtimin nga lista e zgjedhësve të shtetasve të moshës mbi 100 vjeç.
12	Autoritetet lokale duhet të sigurohen që të gjithë votuesit të informohen në kohën e duhur për vendin dhe kohën e shqyrtimit të listës së zgjedhësve dhe për vendndodhjen e qendrave të tyre të votimit. Mund të shihet mundësia e zhvendosjes së afateve të njoftimit të zgjedhësve më afër ditës së zgjedhjeve.	Të tjera	Progres Munguar	Ky është një rekomandim i përsëritur. Megjithëse Kodi Zgjedhor parashikon detyrimin e organeve të qeverisjes vendore për njoftimin me shkrim të Zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit dhe numrin në listën e zgjedhësve, në përgjithësi ky detyrim ligjor nuk zbatohet. Është e nevojshme që në Kodin Zgjedhor të parashikohen sanksione për moszbatuesit e kësaj dispozite.

13	Mundësia e kandidimit të liderëve të partive politike në disa zona zgjedhore duhet të rishikohet për të ruajtur parimin e barazisë.	Të tjera	Realizuar	Ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor me ligjin nr. 81/2024, datë 26.7.2024 e kanë abroguar të drejtën e kryetarëve të partive për të kandiduar njëkohësisht në disa zona zgjedhore.
14	Duhet të hiqen kufizimet e së drejtës së kandidimit të personave të deportuar dhe objekt të një urdhri arresti, fajësia e të cilëve nuk është vërtetuar me vendim gjykatë.	Të tjera	Realizuar	Kodi zgjedhor dhe ligji për dekriminalizimin përcakton se kufizimi në të drejtën për kandidim zbatohet vetëm ndaj personave që janë shpallur fajtor me një vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare.
15	Për të garantuar sigurinë juridike, mund të shihet mundësia e rishikimit të dispozitave në lidhje me numrin maksimal të kandidatëve në lista dhe renditjen e kandidatëve të gjinive të ndryshme.	Të tjera	Realizuar	Ndryshimet në Kodin zgjedhor me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020 dhe ligjin nr. 81/2024, datë 26.7.2024 kanë mundësuar zbatimin e këtij rekomandimi.
16	Organet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, përfshirë shpërdorimin e burimeve shtetërore, në mënyrë të plotë, në kohë dhe në mënyrë transparente. Votuesit duhet të informohen sistematikisht në lidhje me mekanizmat e zbatueshëm për të raportuar çdo rast presioni dhe të jenë të sigurt se nuk do të përballen me pasoja negative.	Të tjera	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk kërkon ndryshime ose shtesa në Kodin zgjedhor. Zbatimi i tij është një proces i vazhdueshëm që lidhet me nevojën për rritjen e kapaciteteve dhe kulturës për zbatimin e ligjit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe shtetit ligjor.
17	Autoritetet duhet të marrin në konsideratë ndryshimet ligjore për të zgjeruar rregulloret dhe kufijtë e dhurimeve dhe shpenzimeve, siç janë caktuar për partitë politike, që ato të aplikohen dhe për palët e treta.	Të tjera	Progres i Munguar	Pavarësisht diskutimeve të shumta, mendimeve, opinioneve dhe propozimeve që janë bërë për mirë rregullimin ligjor të çështjeve që lidhen me financimin e partive politike, aktualisht nuk ka asnjë nismë ligjore për të bërë shtesa ose ndryshime në legjislacionin që trajton probleme të financimit të partive politike.

18	Në mënyrë që të rritet përgjegjësia e partive politike dhe transparencë përgjithshme e procesit zgjedhor, duhet të merret në konsideratë që t'u kërkohej garuesve të zbulojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre të fushatës para ditës së zgjedhjeve.	Të tjera	Progres i Munguar	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk ka patur dhe nuk ka asnjë angazhim nga partitë politike dhe Kuvendi i Shqipërisë.
19	Duhet të zhvillohet aftësia e KQZ-së për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat ligjore në lidhje me mbikëqyrjen e financimit të fushatës.	Të tjera	Progres i Munguar	Megjithë kërkesat në vazhdim të artikuluar nga organizata të shoqërisë civile, kërkesa që konvergjojnë me këtë rekomandim të OSBE/ODIHR aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë mbështetëse për zhvillimin e kapaciteteve të KQZ për mbikëqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore. Shtesat e bëra në Kodin Zgjedhor në të cilat trajtohet problemi i monitorimit, në kohë reale, i shpenzimeve të partive politike për fushatën zgjedhore, duke mos u shoqëruar edhe me mbështetjen për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme që duhet të ketë KQZ-ja kanë rezultuar jo efektive.
20	Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'u garantuar mundësi të barabarta aksesit në media të gjitha palëve garuese, duke përfshirë edhe hapësirën për reklamim. Konsiderata shtesë mund të jepen për alokimin e një sasive të caktuar të kohës së transmetimit falas në mënyrë të barabartë për të gjithë garuesit gjatë fushatës.	Të tjera	Progres i Munguar	Pas ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor në prag të zgjedhjeve parlamentare, 2021 nuk është realizuar asnjë ndryshim tjetër që do të mundësonte zbatimin e këtij rekomandimi.
21	KQZ-ja dhe palët e tjera të interesuara duhet të vazhdojnë programet e edukimit të zgjedhësve të përshtatura për nevojat e pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane. Mund të bëhen përpjekje shtesë nga autoritetet për të lehtësuar aplikimin ose rinovimin e kartave të identitetit nga votuesit në nevojë.	Të tjera	Progres i Kënaqshëm	KQZ-ja është angazhuar në një proces intensiv për zbatimin e një programi kombëtar për edukimin e zgjedhësve. Ndryshe nga programet e mëparshme të zbatuara nga KQZ-ja, ky program nuk është i kufizuar për t'u realizuar vetëm në periudhën zgjedhore. Target të këtij programi edukimi janë të rinjtë, gra e vajza, grupet e marginalizuara, zgjedhësit me aftësi ndryshe dhe pakicat kombëtare.

KREU I SHTATË
MONITORIMI DHE VËZHGIMI I PROCESEVE ZGJEDHORE NGA
VËZHGUESIT VENDOR
INDIKATORËT PËR VLERËSIMIN E INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE

7.1 Vështrim i shkurtër historik i procesit të zhvillimit të kapaciteteve të shoqërisë civile për monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve

Zhvillimi i zgjedhjeve pluraliste, pas ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri në dhjetorin e vitit 1990, shënon edhe fillimin e procesit të pjesëmarrjes dhe vëzhgimit të proceseve zgjedhore, si një përgjegjësi, detyrim dhe e drejtë për shoqërinë civile. Ndër vite ky proces është karakterizuar nga një trend i dukshëm zhvillimi pozitiv, sasior e cilësor. Fillimet e tij, nisin me krijimin e Shoqatës për Kulture Demokratike. Kjo shoqatë u themelua në 2 shkurt 1992, në prag të zgjedhjeve parlamentare që u zhvilluan në 22 mars 1992 dhe që, kanë hyrë në historinë e Shqipërisë si zgjedhjet e para pluraliste që kurorëzuan ndryshimin e madh politik.

Në periudhën 1991- 2023, duke përjashtuar proceset e pjesshme, në Shqipëri janë zhvilluar 21 procese zgjedhore, nga të cilët 9 kanë qënë zgjedhje për Parlamentin e Shqipërisë, 9 kanë qënë zgjedhje për organet e pushtetit vendor dhe 3 referendume. Të gjithë këto procese janë vëzhguar prej OSHC- ve të ndryshme, ndër të cilat si më kryesore mund të përmenden Shoqata për Kulturë Demokratike, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Institutin Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, Këshilli Rinor Shqiptar, Organizata Mjaftë, Instituti i Studimeve Politike, KRIIK, etj.

Procesi i zhvillimit të kapaciteteve të shoqërisë civile shqiptare për vëzhgimin dhe monitorimin e proceseve zgjedhore, ka qënë dhe është pjesë e procesit kompleks të zhvillimit të kulturës demokratike në shoqërinë shqiptare post komuniste. Në tërësinë e tij ai është karakterizuar nga veprimi i faktorëve të natyrave të ndryshme, social, ekonomik, psikologjik, politik e të traditës. Duke hedhur një vështrim të shpejtë historik në këtë zhvillim, mund të evidentohet lehtë karakteri kompleks dhe dinamika intensive që e ka karakterizuar këtë proces. Rezultate të tij janë produktet e rëndësishme që shoqëria civile ka realizuar ndër vite dhe që i ka komunikuar në raportet e saj për proceset zgjedhore të vëzhguara. Në këto raporte gjenden gjykime dhe qëndrime të larmishme, herë profesionale e herë me nivel të dukshëm politik e subjektiv, herë të referueshem dhe herë me impakt të larg pritshmërisë. Me gjithë këtë dhe pavarësisht nga këto, është e rëndësishme të theksohet se nëpërmjet angazhimit në këtë proces shoqëria civile në Shqipëri ka arritur të ndërtojë kapacitete që bëjnë të mundur realizimin e efekteve pozitive të veprimit të saj në zhvillimet demokratike. Është e rëndësishme të theksohet se në të gjithë procesin për formimin dhe zhvillimin e kapaciteteve për vëzhgimin, monitorimin e zgjedhjeve dhe për pjesëmarrjen e saj në proceset e reformave zgjedhore, shoqëria civile shqiptare është asistuar dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme prej institucioneve dhe organizmave të specializuara ndërkombëtare, në veçanti OSBE/ODIHR dhe donatorëve të ndryshëm.

I filluar si një proces diskret, që konsiderohej si detyrim statutor i vetëm disa prej OSHC-ve që operonin në fushën e të drejtave të njeriut, hap pas hapi, procesi i vëzhgimit të zgjedhjeve dhe, nëpërmjet tij edhe ai i pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në proceset zgjedhore, është zhvilluar si një e drejtë dhe përgjegjësi e të gjithë shoqërisë. Në këtë zhvillim, ndihmesë të konsiderueshme ka dhënë përafrimi i legjislacionit zgjedhor shqiptar me standardet demokratike. Ligjvënësi shqiptar duke ju referuar pesë parimeve bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane (zgjedhje universale, të barabarta, të lira, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejta), në punë për hartimin e legjislacionit zgjedhor i ka kushtuar vëmendjen dhe vendin e duhur edhe çështjeve që lidhen me të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve të pavarur vendor. Krahas saj, konsulenca e ofruar prej institucioneve të specializuara, asistenca e ekspertëve të OSBE / ODIHR, mbështetja për pjesëmarrjen në seminare kualifikimi të përfaqësuesve të OJF shqiptare, shkëmbimi i përvojave ndërmjet vëzhguesve vendor të vendeve të ndryshme të rajonit etj... kanë qënë dhe mbeten faktorë shumë të rëndësishëm jo vetëm në krijimin e kapaciteteve të vëzhguesve vendor shqiptarë por edhe në zhvillimin e forcimit të vazhdueshëm të këtyre kapaciteteve.

Në procesin e krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të shoqërisë civile shqiptare për të vëzhguar proceset zgjedhore, mund të dallohen dy faza kryesore :

Faza e parë, 1991 - 2001 – krijimi i kapaciteteve dhe përvojave të para në OJF të veçanta për vëzhgimin e proceseve zgjedhore.

Kjo fazë karakterizohet nga:

- i. vëzhgimin i zgjedhjeve prej një numri të kufizuar prej rreth 2-3 OJF-ve,
- ii. aktivizimin i një numri të vogël vëzhguesish,
- iii. vëzhgim i pjesshëm i procesit zgjedhor, me përqëndrim më të madh në ditën e zgjedhjeve dhe në rajonet urbane të vendit,
- iv. nivel i ulët profesional i vëzhguesve,
- v. mungesa, shpesh të dukshme, të pavarësisë politike në gjykimin e procesit zgjedhor
- vi. nivel jo i mirë i transparencës në punën e vëzhguesve.

Faza e dytë, 2001 – në vazhdim – forcimi i kapaciteteve të vëzhguesve vendor shqiptar

Fillimi i kësaj faze mund të konsiderohet marrëveshja e parë që bënë 4 OJF, që u angazhuan të vëzhgonin procesin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, Qershor 2001. Në bazë të kësaj marrëveshje vëzhguesit e Shoqatës për Kulture Demokratike, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut dhe Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, do të vëzhgonin procesin zgjedhor, gjatë ditës së zgjedhjeve, sipas të njëjtës metodologji. Shoqatat ranë dakord që të respektonin një plan të përbashkët shpërndarje të vëzhguesve në qendra e votimit dhe të shkëmbenin informacion midis tyre. Me gjithë këtë, secila prej këtyre organizatave ruajti të drejtën për të shprehur gjykimet e saj për procesin zgjedhor në një raport të veçantë.

Për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, Tetor 2003, me mbështetjen e Zyrës së Prezencës së OSCE, në Tiranë, duke patur si udhërrëfyese përvojat e mëparshme të krijuara, Kodin e Etikës dhe atë Profesional për vëzhguesit e zgjedhjeve, të hartuar prej OSCE /ODHIR, si dhe rekomandimet e dhëna në Forumin Evropian të Vëzhguesve Vendor, të mbajtur në Zagreb, në qershor, 2003, 18 OJF shqiptare u deklaruan dhe formuan Forumin e Vëzhguesve Vendor Shqiptar. Ky Forumi hartoi Kodin e Etikës dhe atë Profesional për Vëzhguesit Vendor shqiptare dhe realizoi 120 seminare për trajnimin e 2200 vëzhguesve, që u aktivizuan nga organizatat pjesëmarrëse në të. Për rezultatin e arritur nga ky Forum, mund të citojmë pjesë nga Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhguesve Ndërkombëtar OSCE/ODIHR, në të cilin shprehet: “Konsiderojmë si një zhvillim pozitiv faktin që një grup prej 18 organizatash të shoqërisë civile, të mbështetura prej Zyrës së Prezencës së OSBE-së, realizuan një vëzhgim më të suksesshëm se ata të mëparshmit, duke aktivizuar 2200 vëzhgues, të cilët ishin prezent në rreth 40% të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit ndërkombëtar. Për herë të parë, pjesa më e madhe e këtyre organizatave, bashkëpunuan nën ombrellën e Forumit të Vëzhguesve Vendorë, i cili udhëhiqej nga ish Kryetari i KQZ. Ky grupim i kushtoi vëmendje të veçantë problemeve që lidhen me pjesëmarrjen në proceset zgjedhore të grave dhe votuesve me aftësi të kufizuara fizike. Një ditë pas zgjedhjeve të 12 tetorit, Forumi zhvilloi një Konferencë shtypi, në të cilën paraqiti një raport të përmbledhur të rezultateve të vëzhgimit, i cili, në linjat kryesore të tij ishte i njëjtë me atë të Misionit të Vëzhguesve Ndërkombëtar.”¹²⁸

Përvoja e fituar, u zhvillua më tej gjatë vëzhgimit të proceseve zgjedhore që pasuan. Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 3 korrik 2005, u vëzhguan nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Koalicioni i Vëzhguesve Vendor etj.. Në zbatim dhe në përputhje me standardet e OSBE/ODIHR për vëzhguesit vendorë, vëzhguesit e Koalicionit gjatë të gjithë aktivitetit të tyre, respektuan parimet bazë të Etikës për Vëzhguesit vendor, në veçanti, sjelljen jo partizane, qëndrimin dhe gjykimin objektiv, profesional dhe transparent.

Monitorimi prej vëzhguesve vendorë i të gjithë proceseve zgjedhore që vijuan është karakterizuar nga rritja e nivelit profesional të këtyre vëzhguesve dhe nga forcimi i karakterit jo politik të sjelljes se tyre në plotësim të detyrës.

Përvojat e realizuara prej Koalicioneve, Forumeve ose nga Dhoma e Situatës zgjedhore në institucionalizimin, organizimin dhe zhvillimin e vëzhgimit të përbashkët të disa OFJ, sipas një metodologjie të unifikuar është një ndër arritje e rëndësishme të shoqërisë civile shqiptare në plotësim të detyrimit të saj për pjesëmarrje dhe kontribut në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.

Moment i rëndësishëm në zhvillimin e përgjegjësisë që ka shoqëria civile për funksionimin efektiv të demokracisë përfaqësues është edhe angazhimi i saj në proceset ligjberëse. Pas zgjedhjeve për Kuvendin, 2005, 14 OFJ që kishin vëzhguar këto zgjedhje u organizuan në siglën “Aksionit Qytetar për Reformën Zgjedhore” me objektiv pjesëmarrjen dhe dhënien e kontributit në procesin e reformës zgjedhore. Rezultatet dhe përvoja e fituar në

¹²⁸ Local Government Elections, 12 October 2003 – 25 January 2004 Page: 19, Republic of Albania, OSCE/ODIHR Final Report. https://www.osce.org/odihr/elections/albania/oms/local_2003

kuadër të këtij angazhimi të përbashkët shërbyen si baze për zhvillimin e vazhdueshëm të kësaj kompetence të rëndësishme të përgjegjësisë dhe punës që kryen shoqëria civile si pjesëmarrëse aktive në procesin e reformës zgjedhore.

7.2 Qasje metodike e shoqërisë civile për monitorimin/vëzhgimin e zgjedhjeve dhe reformave në legjislacionin zgjedhor

Në plotësim të misionit të tyre si institucione të rëndësishme jo politike në një shoqëri demokratike, organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë përherë aktive dhe pjesëmarrëse në proceset zgjedhore. Këtë mision ato arrijnë ta realizojnë nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes në proceset për reformimin e legjislacionit zgjedhor dhe të kuadrit tjetër legjislativ në të cilin trajtohen edhe çështje që lidhen me zgjedhjet.

7.2.1 Monitorimi/vëzhgimi i zgjedhjeve

Analiza e përvojave të derisotme të realizuara nga shoqëria civile për monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve tregon se, për zhvillimin e kësaj përgjegjësie, organizatat e shoqërisë civile, pavarësisht nga zgjedhja organizative – të zhvillojnë këtë proces vetëm ose si pjesë e një bashkim vullnetar me organizatat të tjera, duhet që në çdo rast ta programojnë dhe realizojnë punë sipas algoritmit në vijim:

1. *Hartim i planit të vëzhgimit*, në të cilin duhet të përcaktohet:
 - (i) koha e aktivizimit të organizatës në këtë proces,
 - (ii) çështjet dhe/ose fazat e procesit zgjedhor që do të jenë objekt i monitorimit/ vëzhgimit,
 - (iii) koha e përzgjedhjes dhe akreditimit të vëzhguesve,
 - (iv) koha dhe mënyra e organizimit të trajnimit vëzhgueseve,
 - (v) hartimi i planit të shpërndarjes në territor i vëzhguesve që do të aktivizohen,
 - (vi) përcaktimi i rrugëve dhe instrumenteve që do të përdoren për komunikimin on line ose në mënyrë periodike i gjetjeve nga procesi i monitorimit/ vëzhgimit,
 - (vii) hartimi dhe publikimi i raportit paraprak dhe përfundimtar,
 - (viii) hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
2. *Hartimi i dokumentacionit* që do të shërbejë për zhvillimin e procesit të monitorimit / vëzhgimit:
 - (i) Hartimi Kodit të Etikës për vëzhguesit.
 - (ii) Ndërtimi i pyetësorëve që do të përdoren nga vëzhguesit.
 - (iii) Hartimi Manualit të vëzhgimit.
3. *Trajnimi i vëzhguesve*
4. *Ndërtimi i skemës së monitorimit/vëzhgimit* të çështjes / fazës së procesit zgjedhor si janë fushata zgjedhore, dita e zgjedhjeve, procesi i numërimit, tabelimi i rezultateve, monitorimi i procesit të trajtimit të ankimeve etj...
5. *Hartimi Raportit paraprak* dhe raportit përfundimtar.
6. *Hartimi i planit të veprimit* për zbatimin e rekomandimeve.

7.2.2 Vlerësimi i integritetit të zgjedhjeve

Përpykja e parë për vlerësimin e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve është realizuar në kuadër të angazhimit në “Dhomën e Situatës Zgjedhore” të pesë OFJ që vëzhguan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 2015. Përvoja në këtë përpjekje tregoi se vlerësimi i këtij indeksi është e vështirë që të realizohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Metodologjisë të hartuar prej Pippa, N. et al. (2013), në rast kur ky vlerësim bëhet pjesë dhe mbështetet në informacionin që grumbullohet gjatë procesit të monitorimit / vëzhgimit të zgjedhjeve. Indeksi për Integritetin e zgjedhjeve duhet të organizohet dhe të zhvillohet si një punë e mirëfilltë kërkimore, që mund të kryhet nga një institucion i specializuar i cili aktivizon për këtë qëllim një grup ekspertesh të kualifikuar.

Në përputhje me Metodologjinë (Pippa, N. et al 2013) Indeksi i integritetit të zgjedhjeve (PEI) është një vlerësim sasior, në vlerën e të cilit sjellin kontributin e tyre 11 indikatorë (Figura 4). Për vlerësimin e çdo indikator përdoren vlerat e përfituara nga perceptimi sasior për treguesit (çështjet) e ndryshëm të tij. Pippa, N. ka përcaktuar gjithsej 49 tregues.




Figura 4. Modeli konceptual për vlerësimin e Indeksit të integritetit të zgjedhjeve (PEI)

Ndërkohë, duhet të theksohet se Metodologjia nuk e përjashton mundësinë, që lista e tregueseve të jetë më e madhe. Vendimi për hartimin e kësaj liste dhe për përmbajtje të treguesve që mund të përfshihen në të, varet nga karakteristikat dhe veçoritë e vendit dhe procesit zgjedhor që zhvillohet.

Indeksi i Integritetit të Zgjedhjeve, i vlerësuar sipas kësaj Metodologjie është realizuar prej INSIZ, për zgjedhjet për Kuvendin, 2021 dhe zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes lokale, 2023.

Për të realizuar zgjedhje me integritet është e nevojshme që vendi të hartojë një kuadër ligjor dhe të ndërtojë një sistem institucional, të cilët të nxitin dhe të mbështetnin zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta e demokratike. Zgjedhjet me integritet arrihen vetëm kur zbatimi i legjislacionit dhe sjellja e të gjithë aktoreve pjesëmarrës në procesin zgjedhor, partitë politike, administrata zgjedhore, institucionet ligj zbatuese dhe deri zgjedhësit, karakterizohen nga vullneti dhe angazhimi i tyre për të realizuar zgjedhje bazuar në standardet demokratike, trashëgiminë zgjedhore evropiane, angazhimet e OSBE-se dhe praktikën e mira zgjedhore.

Vlerësimi i Integritetit të zgjedhjeve është një proces që shoqëria civile duhet ta zhvillojë duke patur parasysh, duke pranuar dhe duke u angazhuar që zgjedhjet të realizohen në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga parimet që karakterizojnë zgjedhjet demokratike. Duke ju referuar Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet zgjedhore dhe trashëgimisë zgjedhore evropiane. Ndër to mund të renditen:

- *Respektimi i parimeve të demokracisë zgjedhore:*

- (i) të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta për të marrë pjesë në zgjedhje si votues dhe/ose kandidatë;
 - (ii) të gjithë qytetarët duhet të kenë të drejtë të barabartë për votim;
 - (iii) për të gjithë duhet të sigurohet sekreti i votës;
 - (iv) votuesit duhet të kenë mundësi dhe akses të barabartë me informacionin zgjedhor dhe fushatën;
 - (v) administrimi i zgjedhjeve duhet të kryhet në mënyrë të drejtë, bazuar në ligj dhe jo partiakë
 - (vi) zgjedhjet duhet të zhvillohen rregullisht në periudha kohe të përcaktuara;
 - (vii) rezultatet e zgjedhjeve duhet të vendosen nga votat e hedhura lirisht nga qytetarët.
- *Zgjedhje të lira*, ku: qytetarëve, komuniteteve dhe ose grupimet e tyre në parti politike ju sigurohet liria e fjalës, e mbledhjes, e organizimit, lëvizja e lirë dhe mungesa e frikës dhe e presionit.
 - *Zgjedhje të ndershme*, kur:
 - (i) procesi zgjedhor është transparent,

- (ii) legjislacioni, rregulloret dhe rregullat e ndryshme zgjedhore janë të barabarta për të gjithë,
- (iii) të gjithë kanë mundësi të barabarta për të marr pjesë në proces, si votues, administrator, vëzhgues ose kandidat,
- (iv) procesi zgjedhor administrohet nga komisione të pavarur dhe të paanshëm;
- (v) zgjedhësi nuk intimidohet,
- (vi) procedurat zbatohen nga të gjithë,
- (vii) respektohen rregullat dhe kufizimet që parashikon kuadri legjislativ ligjor e nënligjor,
- (viii) rezultati i shpallur është pasqyrim real i vullnetit të zgjedhësve të shprehur me vote,
- (ix) rezultati pranohet.

- *Sjellje etike*

Integriteti në zgjedhje varet nga sjellja etike e administratorëve të zgjedhjeve, zyrtarëve të zgjedhjeve, kandidatëve, partitë dhe të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Kjo nënkupton që të gjithë duhet të sillen në një mënyrë që promovon një proces të lirë dhe të ndershmë dhe që dekurajon sjelljet që i kundërvihen ligjit dhe që rrezikojnë integritetin e procesit

- *Profesionalizmi, saktësia dhe korrektesia në zbatimin e ligjit*

Kjo kërkon, në radhë të parë që administrata zgjedhore të jetë profesionalisht e përgatitur, korrekte dhe me integritet në vendimmarrje. Sjelljet me ngjyrimë politike ose që krijojnë perceptimin se favorizojnë kandidatë ose subjekte të caktuara në garën elektorale, dëmtojnë, në mënyrë të ndjeshme integritetin e procesit zgjedhor.

- *Angazhime profesionale të institucioneve*

Zbatimi i kërkesave të ligjit nga institucionet ligj zbatuese që kanë detyra në kuadër të procesit zgjedhor dhe respektimi i detyrimeve dhe kushtëzimeve ligjor për institucionet që përcaktohen në ligjin zgjedhor, janë faktorë të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve.

- *Mbikëqyrja dhe zbatimi*

Në legjislacion parashikohen kërkesat për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve zgjedhore nga administrata zgjedhore. Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit, nëpërmjet aktivizimit të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm, ndihmon në zbulimin e problemeve në sistem dhe identifikimin e grupeve ose individëve përgjegjës. Aktivizimi i vazhdueshëm dhe përherë e më shumë efektiv i këtij procesi mbikëqyrje është një përparësi e rëndësishme për çrrënjosjen e korrupsionit nga procesi zgjedhor, për vendosjen e përgjegjësve para drejtësisë dhe realizimin e ndjenjës së besimit në sistem.

- *Transparenca dhe përgjegjësi.*

Transparenca i bën strukturat institucionale dhe veprimet / vendimet që ata marrin gjerësisht të arritshme dhe të kuptuara më mirë. Pjesëmarrësit në një zgjedhje zakonisht do të kenë më shumë besim nëse kanë qasje në informacionin e detajuar procedural dhe kur mund të kuptojnë se si funksionon procesi zgjedhor. Transparenca, së bashku me vëzhgimin publik, zakonisht sigurojnë motivime shtesë për administratorët zgjedhorë dhe zyrtarët e zgjedhjeve që të veprojnë në përputhje me rregullat dhe të jenë të përgatitur që të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

7.3 Indikatorët për vlerësimin e integritetit të zgjedhjeve

Për të vlerësuar integritetin e një procesi zgjedhor është e domosdoshme që në analizë të merren të gjithë fazat e zhvillimit të tij dhe të gjithë çështjet që duhet të trajtohet dhe problemet që duhet të zgjidhen në secilën prej këtyre fazave. E rëndësishme është të theksohet se ky proces vlerësimin duhet të zhvillohet duke pranuar dhe duke i trajtuar të gjitha fazat, çështjet dhe problemet, si të barasvlershme në efektin që ato kanë në zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me standardet e gjithë pranuar për zgjedhjet demokratike. Në rastin kur për vlerësimin e

Integritetit të zgjedhjeve do të përdoret një metodologji, nëpërmjet të cilës do të synohet që integriteti i zgjedhjeve të shprehet në mënyrë sasiore, rezultati duhet të jetë një numër, vlera e të cilit është rezultat i kontributeve të të gjithë indikatorëve që pasqyrojnë, në mënyrë sasiore ecurinë e fazave të ndryshme të procesit zgjedhor. Vlerësimi sasior i kontributit të çdo indikatorit në Integritetin e zgjedhjeve nuk është një proces matjeje për realizimin e të cilit do të përdoret një instrument matës. Ai është një proces në bazën e të cilit qëndron perceptimi, i shprehur me numër, për treguesin përkatës përbërës të indikatorit, i cili deklarohet nga vëzhguesi/monitoruesi i trajnuar dhe angazhuar në këtë detyrë.

Duke ju referuar Metodologjisë të hartuar nga Pippa, N. et al (2013)¹²⁹, indikatorët që mund të përdoren për të vlerësuar Integritetin e një procesi zgjedhor, në mënyrë të përmbledhur janë shtjelluar në vijim. Për secilin prej indikatorëve janë formuluar, në trajtën e një pohimit afirmues, çështje të ndryshme që lidhen me indikatorin përkatës dhe për të cilat vëzhguesi/monitoruesi duhet të japë përgjigjen si një vlerësim me pike: 1 (Aspak dakord) deri në 5 (Shumë dakord).

Indikator 1. Legjislacioni

Ligji zgjedhor duhet të gëzojë mbështetje sa më të gjerë nga subjektet e interesuara në proces, partitë politike, kandidatët dhe zgjedhësit. Për këtë arsye ai duhet të jetë produkt i një procesi legjislativ gjithëpërfshirës. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhet të bëhen, të paktën, gjatë muaj përpara ditës së zgjedhjeve. Vlerësimi i këtij indikator do të bëhet duke u mbështetur në përgjigjet që do të merren për secilin prej pohimeve të mëposhtme

1.1 Reforma zgjedhore është konsensuale

1.2 Ndryshimet në Kodin zgjedhor pasqyruan rekomandimet e OSBE/ODIHR

1.3 Ndryshimet në Kodin zgjedhor u bënë në plotësim të kërkesave të vëzhguesve vendor dhe qytetarëve

1.4 Kodi zgjedhor nuk diskriminon partitë e vogla

1.5 Kodi zgjedhor nuk diskriminon kandidatët e pavarur

1.6 Kodi zgjedhor nuk i diskriminon pakicat kombëtare

1.7 Kodi zgjedhor është i qartë dhe nuk mund të keq interpretohet.

1.8 Kodi zgjedhor nuk favorizon partinë ose partitë qeverisëse

1.9 Kodi zgjedhor e respekton barazinë gjinore

1.10 Kodi zgjedhor i plotëson standardet ndërkombëtare dhe siguron në mënyrë adekuate respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

1.11 Udhëzimet e KQZ pasqyrojnë kërkesat e Kodit zgjedhor

1.12 Kodi zgjedhor jep garanci të mjaftueshme për respektimin e të drejtave civile dhe politike

1.13 Proçedurat e ankimit janë të qarta, publike dhe të kuptueshme për publikun

1.14 Në legjislacion janë të parashikuara mekanizma kontrolli dhe balancimi për të mbikëqyrur vendimet e marra nga KQZ

Indikator 2. Proçedurat elektorale

Për të gjykuar në lidhje me nivelin e integritetit në zbatimin e proçedurave elektorale mund të përdoren treguesit në vijim:

¹²⁹ Pippa Norris, Richard W. Frank, Ferran Martínez Coma (2013) Assessing the Quality of Elections. October 2013 Journal of Democracy 24(4):124-135. https://www.researchgate.net/publication/259694368_Assessing_the_Quality_of_Elections

- 2.1 Zgjedhësit u informuan për qëndrën e votimit
- 2.2 KAS mori vendime në përputhje me Kodin
- 2.3 Kolegji zgjedhor mori vendime në përputhje me Kodin
- 2.4 Zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me ligjin
- 2.5 Subjektet zgjedhore respektuan ligjin
- 2.6 KQV zbatuan gjithmonë Kodin zgjedhor
- 2.7 Zgjedhësit u informuan për pasojat që sjell shkelja e Kodi zgjedhor dhe shitblerja e votës
- 2.8 Partitë politike nuk ushtruan presion ndaj komisionerve
- 2.9 Forcat e rendit e respektuan Kodin Zgjedhor
- 2.10 Komisioni rregullator mori vendime në përputhje me Kodin
- 2.11 Zgjedhësit u informuan rregullisht për procedurat e votimit
- 2.12 Komisioneri shtetëror mori vendime në përputhje me Kodin
- 2.13 KZAZ zbatuan gjithmonë Kodin zgjedhor
- 2.14 Zgjedhësit e pakicave kombëtare u informuan në gjuhën e tyre amtare

Indikatori 3. Ndarja e zonave zgjedhore

3.1 Ndarja administrativo-territoriale nuk ndikon në cilësinë e përfaqësimit të komuniteteve të ndryshme në organet e pushtetit vendor që zgjidhen direkt nga populli

- 3.2 Partitë e vogla dhe partitë e reja nuk diskriminohen nga ndarja administrativo-territoriale
- 3.3 Ndarja administrativo-territoriale nuk i diskriminon partitë politike në garën e tyre elektorale

Indikatori 4. Lista e zgjedhësve

- 4.1 Organet e qeverisjes vendore i njoftuan zgjedhësit për qëndrën e votimit
- 4.2 Ndryshimi i qëndrës së votimit nuk solli shqetësim të zgjedhësit
- 4.3 Kuadri ligjor për regjistrimin në listën e zgjedhësve me një vendim gjyqi është i qartë dhe i lehtë për t'u përdorur nga qytetaret
- 4.4 Korrigjimi i gabimeve dhe pasaktësive në listë është plotësisht i mundshëm nga qytetaret
- 4.5 Lista e zgjedhësve është publike dhe lehtësisht e aksesueshme
- 4.6 Kuadri ligjor për regjistrimin e votuesve mundëson hartimin e një listë të saktë
- 4.7 Partitë politike kishin akses të plotë me procesin e hartimit të listës së zgjedhësve

Indikatori 5. Regjistrimi i subjekteve zgjedhore

5.1 Renditja në listën shumëmerore e kandidatëve krijonte mundësinë për përfaqësimin proporcional të komuniteteve të ndryshme në këshillin bashkiak

5.2 Partitë politike janë kujdesur që në listën e kandidatëve të përfaqësohen komunitetet e marginalizuar

5.3 Partitë politike i përcaktuan kandidatet për këshillat bashkiakë nëpërmjet një procesi të hapur dhe konsultimi me qytetarët

5.4 Partitë politike nuk i kontestuan vendimet për regjistrimin si subjekte zgjedhor

5.5 Listat e kandidatëve për këshillat bashkiak u hartuan në përputhje me kërkesat e përfaqësimit proporcional të komuniteteve që bashkëjetojnë në një njësi vendore

5.6 Vendimet për regjistrimin e subjekteve zgjedhore nuk u ndikuan nga situatat politike në të cilat u zhvilluan zgjedhjet.

5.7 Përmbajta e fletës së votimit u dakortësua nga partitë politike

5.8 Qytetarët janë të informuar për procesin e hartimit të listës së kandidatëve nga partitë politike.

5.9 Partitë politike i përcaktuan kandidatët nëpërmjet një procesi të hapur dhe konsultimi me qytetarët

5.10 Regjistrimi i subjekteve zgjedhore u bë në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor.

5.11 Ligj nuk përmban dispozita diskriminuese për regjistrimin e partive të reja dhe kandidatëve të pavarur

5.12 Partitë politike janë kujdesur që në listën e kandidatëve të përfaqësohen të rinjtë.

5.13 Legjislacioni u krijon mundësi të barabarta me të tjerët, pakicave kombëtare, për të konkurruar në zgjedhjet

5.14 Partitë politike e mbajtën parasysh ligjin për dekriminalizimin gjatë procesit të hartimit të listës së kandidatëve

5.15 KQZ zbatoi kërkesat e ligjit për pastërtinë e figurës së kandidatëve.

5.16 Legjislacioni zgjedhor krijon kushte të favorshme për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje si kandidate dhe administratore të procesit

5.17 KQZ-ja dhe Kolegji zgjedhor zbatuan kërkesën e Kodit zgjedhor për listën shumë emërore të kandidatëve

5.18 Partitë dhe kandidatët respektuan afatet kohore për regjistrim si subjekte zgjedhore dhe për regjistrimin e listave të kandidatëve.

Indikatori 6. Media dhe fushata zgjedhore

6.1 Debatet elektorale në median audiovizive u përdorën për të paraqitur programet qeverisëse lokale

6.2 Kandidatët për këshillat bashkiak/kuvendin paraqitën programet e tyre

6.3 Lideshipi i partive politike nuk e mbizotëroi fushatën zgjedhore

6.4 Kandidatët e partive politike ose të pavarur kishin akses të mjaftueshëm në media për t'u prezantuar me zgjedhësit dhe shpalosur idetë dhe programin e tyre.

6.5 Kandidatët gra/vajza patën mundësi të barabarta për akses në median audiovizive.

6.6 Partitë politike e bazuan fushatën zgjedhore në paraqitjen e programeve për qeverisjen qendrore/vendore

6.7 Gazetarët e lajmeve u lejuan të ndiqnin lirisht aktivitetet e fushatës zgjedhore

6.8 Informimi i publikut për kandidatët për deputet/kryetar bashkie/për këshillat bashkiak ishte i mjaftueshëm, objektiv dhe i balancuar

6.9 Fushata negative nuk ishte mbizotëruese

6.10 Gazetarët e lajmeve mbuluan fushatën zgjedhore pa presion

6.11 Media sociale nuk u keqpërdor

6.12 Media private i respektoi kërkesat e Kodit Zgjedhor për transmetimin e reklamave elektorale të partive politike

6.13 Privat radiot dhe televizionet mbuluan fushatën zgjedhore vetëm gjatë edicionit të lajmeve dhe rubrikave speciale.

6.14 Media audiovizive e shmangu fushatën dhe mesazhet negative

6.15 Partitë politike kishin akses në media audiovizive në përputhje me përcaktimet në Kodin zgjedhor

6.16 Mediat pasqyruan në mënyrë reale mesazhet e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve

6.17 Mediat sociale nuk ndikuan tek votuesit

6.18 Radio dhe Televizioni Publik zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhor në lidhje me kohën e transmetimit të aktiviteteve të subjekteve zgjedhore

6.19 Radio dhe Televizioni Publik mbuloi fushatën elektorale përmes lajmeve ose programeve informuese në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin zgjedhor

6.20 KQZ dhe AMA e monitoruan media në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor, në mënyrë transparente dhe paanshmëri

Indikatori 7. Financimi i fushatës zgjedhore

7.1 Partitë respektuan Kodin zgjedhor për përdorimin e aseteve publike

7.2 Partia në pushtet nuk e përdori administratën publike për qëllime elektorale

7.3 Vendimet e KQZ ndikuan në uljen e frekuencës së shfaqjes së fenomenit të përdorimit të aseteve publike për qëllime elektorale

7.4 Partitë / kandidatët kishin qasje proporcionale në fondet private

7.5 Monitorimi nga KQZ-ja, në kohë reale, i shpenzimeve të partive për fushatën zgjedhore ishte efektiv dhe e rriti transparencën e këtyre shpenzimeve

7.6 Fenomeni i shitblerjes së votës nuk ishte i shpeshtë

7.7 Denoncimi i shkeljeve në përdorimin e aseteve publike uli shpeshtësinë e këtij fenomeni

7.8 Partitë politike nuk përdoren instrumente dhe metodat për intimidimin e zgjedhëseve

7.9 Ndryshimet në Kodin zgjedhor dhe Kodin penal ndikuan në zvogëlimin e fenomenit të shitblerjes së votës

7.10 Prokuroria dhe SPAK reagues në mënyrë efektive ndaj denoncimeve për shitblerjen e votës dhe/ose shkeljeve të ligjit zgjedhor

7.11 Partitë politike dhe kandidatët i bënë transparente burimet e financimit me fonde private

7.12 Institucionet ligj zbatuese ndikuan në zhvillimin e një fushate zgjedhore pa probleme të rendit dhe për parandalimin e intimidimit të zgjedhësve

7.13 Partitë politike nuk ndikuan në rritjen e tensionit politik gjatë fushatës zgjedhore

7.14 Partitë / kandidatët kishin qasje proporcionale në fondet publike

7.15 Partitë/kandidatët i bënë transparente burimet e financimit në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor.

7.16 Kërkesat e Kodit zgjedhor për financimet me fonde private u zbatuan nga subjektet politike dhe kandidatët

7.17 Rregullat për financimin e fushatës të përcaktuara në Kodin zgjedhor janë të qarta dhe të plota

Indikatori 8. Procesi i votimit

8.1 Persona të paaautorizuar nuk ndërhyjnë në procesin e votimit në qendrën e votimit

8.2 Komisioni i qendrës së votimit zbatoi procedurat ligjore për votimin me prokurë për votuesit me aftësi të kufizuara

8.3 Pajisjet për identifikimin biometrik të zgjedhësve funksionuan normalisht

8.4 Procesi i votimit filloi normalisht sipas përcaktimeve në Kodin zgjedhor

8.5 Komisioni i qendrës së votimi zbatoi procedurat ligjore për votimin e fshehtë dhe moslejimin e votimit familjarë

8.6 Votuesit ishin informuar paraprakisht për qendrën e votimit

8.7 Qendra e votimit ishte e përshtatur për të mundësuar votimin për personat me aftësi të kufizuara

8.8 Boja për shënim në gisht të zgjedhësit ishte efektive

8.9 Ndaj votuesve nuk u ushtrua presion për të votuar një subjekt/kandidat të caktuar

8.10 Policia e rendit zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhor

8.11 Komisioni i qendrës së votimi zbatoi procedurat ligjore për identifikimin biometrik të zgjedhësve

8.12 Procesi i votimit u zhvillua i qetë dhe pa probleme të rendit

8.13 Votuesit i njihnin procedurat e votimit

8.14 Komisioni i QV zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhore për hapjen e qendrës së votimit

8.15 Materialet për informimin e zgjedhësve për procedurat e votimit ishin afishuar në përputhje me Kodin zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së

8.16 Qendra e votimit u mbyll në përputhje me ligjin

8.17 Pas mbylljes në qendrën e votimit qëndruan vetëm personat e autorizuar

8.18 Materialet zgjedhore u administruan në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor

8.19 Kutitë me materialet zgjedhore dhe fletët e votimit u nisen për VN në përputhje me procedurat e përcaktuara

Indikatori 9. Vlerësimi dhe numërimi i votave

9.1 Vëzhguesit patën akses me procesin e numërimit të votave si parashikohet në Kodin zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ-se

9.2 Vëzhguesit e subjekteve elektorale dhe kandidateve kishin mundësi të monitoronin dhe vëzhgonin, sipas ligjit vlerësimin dhe numërimin e votave

9.3 Vëzhguesit kishin mundësi të vëzhgonin procesin e marrjes në dorëzim të kutive me materiale dhe fletët e votimit

9.4 Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave për subjektet dhe votat parapëlqyese për kandidatët u zhvillua normalisht dhe pa incidente

9.5 Grupi i numërimit të votave zbatoi kërkesat e ligjit për vlerësimin dhe numërimin e votave

9.6 Tabelimi i rezultateve u krye në përputhje me ligjin

9.7 Dorëzimi i materialeve dhe kutive të votimit u zhvillua i qetë dhe pa probleme

9.8 KZAZ zbatoi kërkesat e ligjit për vlerësimin dhe numërimin e votave

9.9 Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave nga NGV u krye në përputhje me procedurat e parashikuara

9.10 KZAZ transmetoi, në kohe reale dhe sipas udhëzimit të KQZ, tabelat e rezultateve në KQZ.

9.11 Media ishte e pranishme gjatë të gjithë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave

9.12 KZAZ zbatoi kërkesat e ligjit për marrjen në dorëzim të kutive me materialet e votimit dhe fletët e votimit

Indikatori 10. Ankime/gjykime

10.1 KQZ ofron akses të lirë dhe të lehtë në informacionin mbi proceset zgjedhore dhe ankesat e lidhura me to

10.2 Qytetarët dhe palët e interesuara mundën të marrin informacion publik në lidhje me ankesat dhe vendimet e marra

10.3 Vendimet e marra nga organi publik janë me terminologji/gjuhë të kuptueshme për publikun

10.4 Vendimet administrative janë të arsyetuara

10.5 Subjektet e interesuara janë të informuara për të drejtat e tyre për të paraqitur ankime dhe procedurat e nevojshme që duhet të ndiqen

10.6 Janë organizuar seanca publike për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me ankimet zgjed-

hore

10.7 Organet raportojnë në mënyrë të rregullt mbi numrin dhe statusin e ankesave të trajtuara

10.8 Raportimet mbi numrin dhe llojet e ankesave janë të kuptueshme për publikun

10.9 Komisioneri raporton për vendimet e tij dhe procedurën e ndjekur

10.10 Diskutimet e zhvilluara para marrjes së vendimit mbi ankimin administrativ në KAS dokumentohen dhe publikohen

10.11 Parashikohen procedura për adresimin e konfliktit të interesit në KAS

10.12 Pala e interesuar u përfshi dhe u njoftua në procedurën e shqyrtimit administrativ të ankesës

10.13 KQZ njoftoi publikisht datën dhe orën e shqyrtimit të ankimit administrativ

10.14 Shqyrtimi i ankimit administrativ u zhvillua brenda afateve

10.15 Portali i denoncimeve në faqen e internetit të KQZ ishte funksional dhe lehtësisht i përdorshëm

10.16 Palët e interesuara ishin të kënaqura për nivelin e informacionit publik në lidhje me ankesat dhe vendimet e marra

10.17 Palët e interesuara ishin të kënaqura për qartësinë, publikimin dhe kuptueshmërinë e procedurave të ankimit

10.18 Palët e interesuara ishin të kënaqura me cilësinë e vendim marrjes së KQZ

10.19 Palët e interesuara ishin të kënaqura me cilësinë e vendim marrjes së Kolegjit Zgjedhor

10.20 Përdoruesit e portalit të denoncimeve ishin të kënaqur

10.21 Avokatët/gazetarët ishin të kënaqur me mundësitë e aksesit nga KQZ për informacionin për mos-marrëveshjet zgjedhore

10.22 Avokatët/gazetarët ishin të kënaqur me mundësitë e aksesit nga gjykata të informacionit për mos-marrëveshjet zgjedhore

10.23 Në vendimmarrjen e KAS për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve në njësi të ndryshme vendore nuk ndikoi përkatësia politike e anëtarëve të tij

10.24 Partitë e pranuan rezultatin e zgjedhjeve

10.25 Sanksionet për shkeljet e Kodit zgjedhor u zbatuan në përputhje me ligjin dhe patën efekte pozitive në pranimin e rezultatit të zgjedhjeve

10.26 Kandidatët e pranuan rezultatin

10.27 Kolegji gjyqësor i shqyrtoi paditë për vendimet e KAS rezultatin në mënyrë objektive

10.28 Rezultati i zgjedhjeve nuk shkaktoi incidente të rënda, prishje të rendit dhe protesta të dhunshme

10.29 Proçedurat e ankimeve për rezultatin u bënë në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor

Indikatori 11. Autoritetet zgjedhore

11.1 Përkatësia politike e anëtarëve të komisioneve zgjedhore nuk ndikoi në zbatimin e ligjit prej tyre

11.2 KQZ monitoroi, në kohë reale, të shpenzimeve për fushatën zgjedhore.

11.3 KQZ zbatoi, sipas kërkesave të ligjit, detyrimin për parandalimin e përdorimit të aseteve publike për fushatë zgjedhore.

11.4 Votuesit për herë të parë janë të informuar dhe ndërgjegjësuar për procedurën e regjistrimit në listën e zgjedhësve dhe për votim.

11.5 KQZ u angazhua plotësisht për përdorimin e teknologjisë së informacionit.

11.6 Vendimet në komisionet zgjedhore kanë qënë konsensuale.

11.7 KQZ zhvilloi një proces intensiv trajnimi për komisionerët.

11.8 Partitë politike nuk ushtruan presion mbi komisionerët.

11.9 KQZ nuk ka marr vendime sipas linjave partiake.

11.10 Midis komisionerëve dhe autoriteteve vendore kishte bashkëpunim dhe koordinim efektiv

11.11 Komisionet kanë qënë bashkëpunues me median.

11.12 Komisionet zgjedhore e administruan mirë procesin zgjedhor

11.13 KQZ informoi, sensibilizoi dhe edukoi zgjedhësit e pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare.

11.14 KZAZ kanë qënë transparente në vendimmarrje.

11.15 KQZ ka bërë fushatë efektive për informimin dhe edukimin e zgjedhësve

11.16 Puna e KQZ ishte transparente

Indikator 12. Shoqëria civile

12.1 OJF janë akredituar si vëzhgues në përputhje me ligjin

12.2 Vëzhguesit kanë realizuar të drejtat e tyre ligjore pa pengesa, kërcënime apo shantazhe

12.3 Stafi i OJF janë trajnuar për procedurat e monitorimit të zgjedhjeve

12.4 OJF ka pasur një plan të detajuar për monitorimin e zgjedhjeve përpara fillimit të procesit zgjedhor

12.5 OJF ka ndjekur procedurat ligjore për denoncimin e rasteve të parregullsive zgjedhore pa pengesa, kërcënime apo shantazhe

12.6 Janë marrë masa mbrojtëse për të siguruar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin fizik vëzhguesve dhe përfaqësuesve të organizatës

12.7 KQZ ishte bashkëpunuese me OJF të angazhuar në monitorimin e zgjedhjeve

12.8 KQZ ka reflektuar në veprimtarinë e saj rekomandimet e paraqitura nga OJF të bazuara në raporte monitorimi

PËRFUNDIME

Hartimi i Studimit, si një dokument në të cilin trajtohen elementët dhe momentet teorike që lidhen me të drejtën

e votës dhe zgjedhjet dhe ku shtjellohen parimet, rregullat, kërkesat dhe qasjet metodike që duhet të merren parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të veprimit të vëzhguesve të pavarur vendor dhe organizatave të shoqërisë civile që angazhohen në monitorimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e procesve zgjedhore është i rëndësishëm për të mbështetur proceset që synojnë zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe organizative të këtyre organizatave.

Në një shoqëri demokratike në të cilën proceset zgjedhore dhe vota e lirë, e drejtpërdrejt dhe e fshehtë, janë guri i themelit për ndërtimin dhe zhvillimin e të gjithë institucionet drejtuese dhe qeverisëse të saj, hartimi i një legjislacioni zgjedhor në të cilin duhet të pasqyrohet parimet dhe standardet e përcaktuara në konventat dhe dokumentet ndërkombëtar që trajtojnë çështje të të drejtave themelore të njeriut është detyrë themelore.

Shqipëria si vend anëtar i OSBE që ka firmosur edhe Kartën e Stambollit, në të cilën është shprehur dakordësia që proceset zgjedhore të vëzhgohen dhe të vlerësohen prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR, është deklaruar botërisht se në proceset legjislative për hartimin e legjislacioni, në zbatim të të cilit duhet të zhvillohen proces zgjedhore në Shqipëri, do të marr gjithmonë në konsideratë rekomandimet që jepen në Raportet për vëzhgimin e zgjedhjeve të hartuara prej Misionit të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR.

Shqipëria si vend anëtar i KiE dhe OSBE ka pranuar Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të hartuar dhe miratuar nga Komisioni i Venecies, angazhimet e OSBE për standardet që duhet të plotësojnë proceset zgjedhore dhe pesë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore Evropiane si dokument bazë udhërrëfyes në punën ligjëbërëse për hartimin e legjislacionit zgjedhor.

Krahas hartimit të një legjislacioni për proceset zgjedhore sa më efektiv dhe të përafuar me standardet dhe legjislacionin e BE-se, gjatë periudhës tridhjetë vjeçare të tranzicionit politik, ekonomik e shoqëror në Shqipëri janë bërë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin efektiv të demokracisë përfaqësuese.

Hartimi i Legjislacionit shqiptar për zgjedhje, në veçanti pas miratimit të Kushtetutës me referendum të përgjithshëm në Nëntor, 1998 ka qënë një proces kompleks dhe i ndikuar, në mënyrë të dukshme nga faktorët politik, partitë politike parlamentare, në veçanti dy partitë kryesore, PS e PD.

Reformat zgjedhore janë zhvilluar përherë si procese bipartizane, PS e PD, në të cilët roli dhe efektet e partive të tjera politike dhe i shoqërisë civile kanë qënë pothuajse të papërfillshëm. Karakteri gjithëpërfshirës i këtyre reformave, i kërkuar në mënyrë të përsëritur edhe për OSBE/ODIHR, eksperteve, organizmave dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare akoma nuk ka arritur të formësohet.

Legjislacioni zgjedhor shqiptar dhe gjithë kuadri tjetër ligjor në të cilin trajtohen çështje që lidhen me zgjedhjet, në linjat kryesore janë të përafuar me standardet dhe kërkesat e konventave dhe dokumenteve. Analiza krahasuese e Kodit zgjedhor me Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore dhe referencat tek vlerësimet dhe konsideratat e shprehura në Raportet e vëzhguesve ndërkombëtar dhe në opinionet e Komisionit të Venecies evidentojnë faktin se Kodi zgjedhor shqiptar është një produkt legjislativ i cili garanton kushtet e nevojshme për zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike.

Analiza e vlerësimeve dhe rekomandimeve të shprehura në raportet për zgjedhjet, të hartuara prej misionëve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR tregon se efekti i sjelljeve politike në procesin ligjëbërës është një ndër faktorët me efekt negativ të ndjeshëm në zhvillimin e kapaciteteve legjislative të nevojshme për proceset zgjedhore demokratike. Kjo analize evidenton raste të shpeshta të ndërhyrjeve dhe ndryshimeve të bëra në legjislacioni, deri në Kushtetutën e Republikës, të nxituar vetëm prej interesit politik dhe dukshëm të shmangur nga interesi qytetar.

Proceset që targetojnë përpjekjet e shoqërisë shqiptare për t'u zhvilluar si një shoqëri demokratike kanë si bashkëshoqërues të tyre përpjekjet e shoqërisë civile për t'u angazhuar dhe për të marr pjesë në proceset zgjedhore, në hartimin dhe rregullimet që duhet të bëhen në legjislacion, në veçanti në Kodin zgjedhor dhe në ligjin për partitë politike dhe në vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve. Zhvillimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për pjesëmarrje në proceset ligjëbërëse për zgjedhjet dhe për vëzhgimin e monitorimin e zgjedhjeve, ka si produkte kryesore të tij arritje të ndjeshme në zhvillimin e kapaciteteve organizative të shoqërisë civile dhe në përgatitjen profesionale të vëzhguesve e monitoruesve që OSHC angazhojnë. Përvetësimi dhe zbatimi prej organizatave të shoqërisë civile i Metodologjive bashkëkohore për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore, formimi i kulturës për zbatimin e Kodit të Etikës dhe Sjelljes për vëzhguesit vendor, zbatimi në praktiken e angazhimit në procese zgjedhore, i parimeve dhe rregullave të hartuara dhe të rekomanduara prej OSBE/ODIHR për vëzhguesit vendor, identifikohen si ndër rritjet e rëndësishme të shoqërisë civile shqiptare.

Analiza e përvojave e realizuar nga përpjekjet, arritjet dhe dështimet që kanë shoqëruar angazhimin e shoqërisë civile për pjesëmarrje në reformat legjislative zgjedhore dhe për vëzhgimin dhe monitorimin e zgjedhjeve, tregon se procesi i zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të saj aktualisht ballafaqohet e nevojën për të kaluar në një

nivel të ri, cilësisht me të lartë, të qasjes dhe sjelljes se saj ndaj detyrës dhe përgjegjësisë që ajo ka si pjesëtarë në përpjekjet e shoqërisë shqiptare për zhvillimin e demokracisë përfaqësues dhe me pjesëmarrje të qytetareve.

Ndërtimi i një Platforme për bashkëpunim dhe kontribut nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare në procesin për vlerësimin e integritetit të zgjedhjeve, duke përdorur për këtë qëllim vlerësimet për indikatorët që pasqyrojnë zhvillimin, në kohë dhe në hapësirë, të proceseve zgjedhore, është një ndër objektivat që synohet të realizohen si kontribut i shoqërisë civil në realizimin e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, që do të zhvillohen në vitin 2025. Realizimi i kësaj objekteve do të jetë konsolidimi i mëtejshme i kapaciteteve profesionale dhe organizative të shoqërisë civile shqiptare për pjesëmarrje dhe monitorim të zgjedhjeve në Shqipëri.